

UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE
УНИВЕРЗИТЕТ НА ЈУГОИСТОЧНА ЕВРОПА
SOUTH EAST EUROPEAN UNIVERSITY



FAKULTETI I DREJTËSISË
ПРАВЕН ФАКУЛТЕТ
FACULTY OF LAW

Studime pasdiplomike – Cikli i Dytë

Teza:

Legalizimi i marihuanës një sfidë e re për Maqedoninë e Veriut

Kandidati :

Nadire Zhaku

Mentori:

Prof.Dr.Ismail Zejneli

Tetovë, Qershor,2021

Falënderim

Zot, Përrulësisht, Faleminderit.

Për këtë arritje, falënderime dhe mirënjohje të pafundëshme i shpreh mentorit tim Prof. Dr. Ismail Zejneli i cili pati besim tek unë nga fillimi i këtij rrugëtimi dhe deri në përfundimin e tij. E çmoj dhe e falënderoj për të gjitha ligjeratat, për punën e tij të palodhshme, për ndihmën dhe këshillat shumë të vlefshme të tij, të cilat do të ruaj me shumë kujdes gjatë gjithë jetës. Për mua kjo diplomë gjithmonë do të mbart me vete figurën tuaj, faleminderit.

Falënderim të posaçëm, shpreh për të gjithë mësimëdhënësit e mi në këto dy vite, të cilët me anë të ligjeratave të çmuara i dhanë një qasje të re dijes sime. Në mënyrë të veçantë, falënderoj për ndarjen e njohurive të tyre dhe udhëzimet e çmuara Prof. Dr. Besa Arifi, Prof. Dr. Vedije Ratkoceri dhe Prof. Dr. Blerta Arifin, të cilat do të jenë një shembull i artë në rrugën time të mëtutjeshme.

Gjithashtu, falënderoj Prof. Ariz Dautin, mësues i Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe, i cili realizoi lektyrimin e temës së magistraturës.

Falënderoj Prof. Dr. Arben Oda dhe Prof. Dr. Hyjnor Kica për këshillat e tyre të vyer të cilat me ndihmuan që ky punim të jetë sa më profesional. Falënderoj kolegët e mi të punës, Eugen Murtishin i cili pati mirëkuptimin në tërësi këtë periudhë të rëndësishme të jetës time. Falënderoj Agni Nezirin i cili ishte shtytësi i këtij rrugëtimi.

Me shumë zemër, falënderoj në mënyrë të pafundme, prindërit e mij Menduije dhe Ramazan Zhaku të cilët janë pasuria më e shenjtë që unë kam në këtë botë, përfshirë edhe motrat e mija për mbështetjen, gjithashtu nipin tim Olti dhe mbesat Diona dhe Inara.

Titulli punues i temës:

Legalizimi i marihuanës një sfidë e re për Maqedoninë e Veriut.

Përkthimi i titullit punues në maqedonisht:

Легализацијата на марихуаната нов предизвик за Северна Република е Македонија

Përkthimi i titullit punues në anglisht:

Legalization of Marijuana is a new challenge for the Republic of North Macedonia.

1.Lënda e hulumtimit

Kanabisi i referohet një grupi prej tre bimësh me veti psikoaktive, të njohura si Kanabis Stativa, Kanabis Indikta dhe Kanabis Ruderalis. Me tharjen e gjetheve dhe luleve të kanabisit përfitojmë barishten që ndryshe njihet edhe si Marihuana. Sipas studimeve të fundit shkencore Marihuana paraqet një bimë me veti shëruese. Në fund të vitit 2020 Komisioni për droga narkotike (CND) me propozimin e OBSH-së hoqi kanabisin nga lista e barnave të rrezikshme dhe e vendosi atë në listën e barërave shëruese e cila mund të përdoret për arsye medicinale për shërimin e disa sëmundjeve.

Prandaj legalizimi i marihuanës në rajon kohëve të fundit ka marrë një jehonë të madhe. Disa shtete të fuqishme botërore i kanë dhënë përparësi legalizimit të marihuanës disa të tjera janë ende në diskutim e sipër dhe nuk kanë të njëjtin mendim për legalizimin e plotë të marihuanës.

Në vitin 2016 Maqedonia e Veriut e miratoi ligjin për legalizimin e marihuanës për qëllime medicinale përkatësisht prodhimin e vajit të kanabisit për përfitime farmaceutike. Ky ligj u arsyetua nga qeveria e atëhershme se: legalizimi i marihuanës do ti sillte tregut të Maqedonisë së Veriut përfitime të majme dhe do të tërhiqte vëmendjen nga vepra penale me rëndësi më të vogël siç është ajo e përdoruesve të marihuanës në vepra penale me serioze. Nga viti 2016 dhe deri më sot në regjistrin tregtar (të Maqedonise sëVeriut) janë të regjistruara gjithsej 23 kompani prodhuese të marihuanes për qëllime farmaceutike , nga te cilat 2 prej tyre janë të licencuara për përpunimin e vajit te kanabisit.

Sipas Kodit penal të Maqedonisë së Veriut përdorimi I marihuanës paraqet veper penale si për përdoruesit ashtu edhe për prodhuesit dhe shpërndarësit. Me ndryshimet efundit ligjore, Maqedonia e Veriut në fund të vitit 2020 hap debatin publik për derkriminalizimin e marihuanës në këtë shtet.

2. Qëllimet e hulumtimit

Një ndër temat më të përfolura nga ngjarjet e fundit në R.M.V. është edhe legalizimi i marihuanës për përdorim farmaceutik dhe synimi i shtetit për dekriminalizimin e marihuanës. R.Maqedonisë së Veriut është ivetmi vend në rajon që ka bërë hapin e pare me legalizimin e marihuanës për përdorimin për arsye farmaceutike. Të dhënat statistikore tregojnë se në R. Maqedonisë së Veriut numri i përdoruesve të drogave dhe sidomos të të miturve në përgjithsi ka një rritje të vazhdueshme, ajo përballët gjithashtu edhe me mungesën e qendrave për mjekimin e personave të varur nga drogat. Nga ana tjetër shteti me legalizimin e marihuanës synon që të zvogëloj numrin e përdoruesve të drogave dhe një rritje ekonomike në vend nga tregu i marihuanës.

Si qëllim kryesor i hulumtimit është të analizohen se:

- Çka paraqesin drogat në aspektin penal
- A janë të përgatitura institucionet e Maqedonisë së Veriut për ndyshime në Kodin Penal në lidhje me legalizimin e marihuanës për përdorime farmaceutike.
- Cilat instrumete do të përdoren për të pasur në kontroll prodhimin dhe për cilin treg përgatitet Maqedonia e Veriut.
- Si do të kontrollohen pikat kufitare gjatë transportimit të mallit të përgatitur për tregjet jashtë kufijve të Maqedonisë së Veriut.

Duke pasur parasysh të gjitha këto që u përmenden me sipër na shtyjnë të bëjmë një analizë të mirëfilltë, nëse ligji për legalizimin e marihuanës për përdorime farmaceutike do ti sillte vertet rritje ekonomike R. Maqedonisë së Veriut, nëse ka vendi kapacitet të mjaftueshëm për të pasur kontrollin absolut te kompanitë e licencuara dhe si do të shpërndahet prodhimi dhe tregu i kësaj lënde narkotike. Analiza nëse është mometi i duhur për derkriminalizimin e marihuanës dhe a do të sillte zvogëlim të veprave penale në praktikë ose një rritje të pakontrolluar, do të interpretohet në bazë të dhënave të përpunuara në teren mbi të cilat do të japim sugjerimet përkatëse.

3. Hipotezat

Hulumtimi shkencor do të nisë me pohimin e hipotezës së përgjithshme, edhe atë:

“legalizimi i marihuanës do t’i sillte tregut të R. Maqedonisë së Veriut përfitime të majme dhe do të tërhiqte vëmendjen nga vepra penale me rëndësi më të vogël siç është ajo e përdoruesve të marihuanës në vepra penale me serioze.”

Gjatë hulumtimi shkencor do të paraqesim edhe disa hipoteza ndihmëse, të cilat do të jenë në funksion të hipotezës së përgjithshme.

Hipotezat ndihmëse në punimit janë:

- Supozohet se Republika e Maqedonisë së Veriut ka kapacitet për të mbajtur nën kontroll kompanitë e licencuara të prodhimit të marihuanës,
- Supozohet se organet përkatëse shtetërore janë të afta të kontrollojnë tregun e errët dhe përdoruesit,
- Supozohet se do të ketë sanksione adekuate ndaj keqpërdoruesve të marihuanës në treg.
- Supozohet se përdorimi legal i marihuanës do të zvogëlojë veprat penale nga përdoruesit dhe sidomos nga të miturit.
- Supozohet se R.M.V. do të ketë bashkëpunim rajonal dhe më gjërë në shpërndarjen e marihuanës.

Sipas kësaj, që të vërtetojmë hipotezat e caktuara në hulumtim,do të përshkruhen dhe maten varijablat (ndryshoret) e mëposhtme:

Varijabla e varur:

Përfitimet ekonomike dhe sociale në Republikën e Maqedonisë së Veriut

Varijabla e pavarur:

Implementimi i ligjit për legalizim të marihuanës

4. Metodologjia e hulumtimit

Metoda shkencore e përdorur në hulumtim do të jetë ajo kërkimore shkencore, ku do të parashtrijmë një sërë pyetjesh hulumtuese rreth problemit të hulumtimit që na preokupon. Qëllimi i këtij hulumtimi është që të përdoren të dhënat historike, aktuale dhe të bëhet një studim empirik duke analizuar ndikimet sociale, politike dhe ekonomike në shoqëri si pasojë e sjelljes së ligjit për legalizim të marihuanës. Gjithashtu do bëjmë krahasimin e të dhënave me vende të ndryshme të rajonit dhe të botës, në përpjekje për të pohuar apo mohuar hipotezat e parashtruara në punim.

Për realizimin e qëllimeve që vendosëm gjatë konceptimit të lëndës së hulumtimit, do të përdoret metoda dogmatike juridike (nomotetike), metoda deskriptive, metoda kauzale, metoda krahasimore, metoda historike, metoda matematikore, metoda statistikore, metoda induktive dhe deduktive, metoda e gjeneralizimit dhe specializimit dhe metoda e analizës dhe sintezës.

Hulumtimi i punimit do të bazohet kryesisht në përdorimin e qasjes së kabinetit, duke shfrytëzuar të dhënat empirike dhe njohuritë që njeh literatura profesionale. Hulumtime të caktuara në teren do të kryhen duke përdorur internetin si medium i cili përmban një numër të madh të të dhënave primare dhe sekondare. Të dhënat mbi përvojat dhe eksperiencat e organeve përkatëse mbi problemin e hulumtimit, do të realizohet nëpërmjet intervistave në disa gjykata në R. Maqedonisë së Veriut, me një mostrë të përzgjedhur paraprakisht me kuotë, në mënyrë që të jemi sa më të saktë në mbledhjen e informacionit.

Përpunimi statistikor i të dhënave, do të kryhet duke përdorur llogarinë e përqindjeve të shprehur në mënyrë numerike dhe tabelare.

5.Rëndësia e punimit

Legalizimi i marihuanës ka nxit debate të mëdha në botë por edhe në vendin tonë. Në njëerën anë kemi ekspertë të fushave të ndryshme që përkrahin ligjin për legalizim të marihuanës, ndërsa në anën tjetër, kemi grupin që është po aq këmbëngulës kundër ligjit në fjalë. Për R. Maqedonisë së Veriut ky synim i ri do të jetë një sfidë në vete si për institucionet shtetërore të cilat do të përballen me risi të pa praktikuara më parë, ashtu edhe për përdoruesit dhe rrethin shoqëror. Analizat e ndryshme shkencore,do t'i japin një drejtim të ri dhe një qartësim më të madh Maqedonisë së Veriut,nëse do të ishte moment i duhur për dekriminalizimin e plotë të marihuanës.

Sipas statistikave vendore dhe botërore, numri i përdoruesëve të marihuanës është në rritje dhe mungesa e qendrave për rehabilitim është një problem në vete. Nga ana tjetër kjo mund të jetë një shtysë për themelimin e qendrave rehabilituese – shëruese nga drogat.

Republika e Maqedonisë së Veriutpërgatitet për një treg të ri botëror me legalizimin e marihuanës cilat instrumente do ti përdor shteti në pikat kufitare për kontrollin e prodhimit dhe destinacionin në të cilin drejtohet prodhimi. Çdo analizë dhe mendim shkencor në fushën juridike,ashtu sikurse synohet edhe me këtë punim, do të jenë shumë të rëndësishme për vendimarrjen e mëtutjeshme të R. Maqedonisë së Veriut në lidhje me legalizimin e marihuanës.

6.Përfundimi

Ky punim shkencor ka për synim të trajtojë një temë delikate e cila po bën shumë zhurmë kohëve të fundit në shtetin tonë. Në këtë hulumtim së pari do të përqendrohemi në atë se çka paraqesin drogat e veçanërisht marihuana në aspektin penal, duke vijuar me analizim se sajanë të përgatitura institucionet e Maqedonisë së Veriut për ndryshime në Kodin Penal, duke ditur se përdorimi dhe prodhimi i lëndëve narkotike,ku bën pjesë edhe marihuana ose kanabisi paraqet vepër penale, si do të përballet Maqedonia me ndryshime të tilla të cilat janë krejtësisht të panjohura dhe të papraktikuara me parë. Gjithashtu do të elaborojmë se cilat instrumente juridike do ti përdorë për të pasur në kontroll prodhimin dhe për cilin treg përgatitet Maqedonia e Veriut, si do të kontrollohen pikat kufitare dhe analiza të tjera.

Gjithashtu,gjatë,studimit do të ofroj të dhëna statistikore mbi veprat penale të përdorimit të marihuanes,gjatë periudhës kohore 2010-2020, se cilat lloje të sanksioneve penale shqiptohen më së shumti, si dhe analizim sa janë të perfshirë të miturit në keto vepra penale.

Përmbajtja

1.Lënda e hulumtimit	IV
2. Qëllimet e hulumtimit	V
3. Hipotezat	VI
4. Metodologjia e hulumtimit.....	VII
5.Rëndësia e punimit.....	VIII
6.Përfundimi	IX

Kapitulli i I-rë	3
-------------------------------	----------

Kontrabanda dhe llojet e saj.....	3
--	----------

1. Nocioni i narkotikëve	3
2. Vështrim historik mbi lëndët narkotike.....	4
3. Klasifikimi i disa drogave drogave	6
3.2 Kokaina.....	10
3.3 Heroina	11
4. Keqpërdorimi i narkotikëve	13
5. Indikatorët e kontrabandës me narkotik.....	15
8. Përfitimet financiare nga legalizimi i kanabisit	23

Kapitulli i II-të	27
--------------------------------	-----------

Përkufizime lidhur me narkotikët.....	27
--	-----------

1. Bima	27
3. Bar narkotik.....	34
4. Prodhimi.....	35
5. Përcaktimi i nevojave vjetore për barna narkotike	38
6. Licenca e operimit me narkotik.....	39

7. Licenca e eksportit dhe importit te prodhimit.....	42
Kapitulli III-të.....	45
Rregullimi i veprimtarive me barna narkotik.....	45
1. Veprimtaria në institucionet shëndetësore.....	45
2. Veprimtaria për qëllime të hulumtimeve mjekësore dhe shkencore	47
3. Evidentimi i narkotikëve	49
4. Raportimi mbi veprimtarinë me narkotik	52
5. Mbikëqyrja e narkotikëve	54
Kapitulli i IV-të.....	60
Parandalimi i kontrabandës me narkotikë	60
1. Autoritetet kompetente	60
1.1 Funksionet dhe raportimet	60
2. Ministria e Shëndetësisë.....	61
3. Ministria e Drejtësisë.....	66
4. Ministria e Punëve të Brendshme	69
5. Ministria e Bujqësisë	72
6. Doganat e RMV-së.....	73
Përfundime.....	75
Rekomandime	79
Bibliografia	82

Hyrje

Kanabisi i referohet një grupi prej tre bimësh me veti psikoaktive, të njohura si Kanabis Sativa, Kanabis Indikta dhe Kanabis Ruderalis. Me tharjen e gjetheve dhe luleve të kanabisit përfitojmë barishten që ndryshe njihet edhe si Marihuana. Sipas studimeve të fundit shkencore Marihuana paraqet një bimë me veti shëruese. Lufta për legalizimin e marihuanës sidomos për qëllime mjekësore është një luftë shumë e gjatë, e pasuar nga shekujt më parë.

Në fund të vitit 2020 Komisioni për droga narkotike (CND) me propozimin e OBSH-së hoqi kanabisin nga lista e barnave të rrezikshme dhe e vendosi atë në listën e barërave shëruese, e cila mund të përdoret për arsye medicinale për shërimin e disa sëmundjeve.

Legalizimi i kanabisit, është një nga temat më të vjetra dhe me aktuale në botë, për vite me rradhë ende nuk i është dhënë një përgjigje përfundimtare nga Komisioni Ndërkombëtar për Kontrollin e Drogave, nëse bima e kanabisit mund të legalizohet siç kërkojnë një grup shtetesh ose mbetet në listën e drogave të rrezikshme. Në vitin 2016 Maqedonia e Veriut iu bashkohet vendeve evropiane në legalizimin e kanabisit për qëllime mjekësore duke u bërë kështu vendi i 14-të në Evropë.

Objekt studimi i këtij hulumtimi shkencor është analizimi i legalizimit të marihuanës në Republikën e Maqedonisë së Veriut, të cilit i është kushtuar me delikatete një rëndësi e veçantë, duke analizuar dhe krahasuar legjislacionet ndërkombëtare me legjislacionin e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Në pjesën e parë të këtij hulumtimi, është dhënë njëkoncept i përgjithshëm rreth nocionit të narkotikëve, klasifikimit të drogave, duke iu përkushtuar legalizimit të kanabisit dhe përfitimeve financiare nga ai.

Në pjesën e dytë, hulumtimi shkencor përqëndrohet në licencimin e personave juridik, në kultivimin e kanabisit, cilat kushte duhet të plotësohen për të marrë licencën për kultivimin e marihuanës në Republikën e Maqedonisë së Veriut, duke e krahasuar me legjislacione të tjera ndërkombëtare.

Në pjesën e tretë dhe të katër, të hulumtimit, pasqyrohet veprimtaria e institucioneve shtetërore në lidhje me kontrollin dhe mbikqyrjen e narkotikëve, evidentimin e narkotikëve, raportimin mbi narkotikët, autoritetet kompetente dhe funksionet e tyre.

Kapitulli i I-rë

Kontrabanda dhe llojet e saj

1. Nocioni i narkotikëve

Përkufizimin e narkotikëve e gjejmë në mënyra të ndryshme por të gjitha përmbledhen në një kuptim të unifikuar, që ka domethënien e nxjerrjes së ndonjë ekstrakti apo lënde nga ndonjë bimë që shkakton ndryshime në sistemin nervor, ose devijon sjelljet e njeriut. Teknikisht ,drogat janë lëndë natyrale, të cilat kanë aftësi që të ndryshojnë funksionin e sistemit nervor dhe shumë organeve të tjera duke shkaktuar kështu dëme të pakthyeshme për organizmin tonë.¹ Origjina e fjalës „DROGË„ nuk është e përcaktuar saktësisht, por kondiserohet se vjen nga fjala arabe (DAVA) që dmth substancë shëruese.²

Ndërsa e drejta penale narkotikët i përkufizon si lëndë të paligjshme prodhimi , trafikimi dhe shpërndarja e të cilave përbën veper penale dhe të cilat sanksionohen me ligje te vecanta. Kodi Penal i Republikës së Maqedonisë së Veriut ndalon „prodhimin e pautorizuar dhe lëshimin në qarkullimin e drogave narkotike ,substancave psikotrope dhe prekursorëve³ „ me nenin 215 dhe 216 të Kodit Penal.

Organizata Botërore e Shëndetësisë me narkotikë nënkupton lëndët dehëse të paligjshme, të cilat rrezikojnë shëndetin e njerëzve⁴. OBSH-ja ka përpiluar një listë të lëndëve narkotike duke i rradhitur ato nga më të butat drejt atyre më të fortave, sipas shkaktimit të dëmit në organizmin e njeriut. E drejta penale, bën selektimin e lëndëve narkotike me anë të lartësisë së dënimeve, duke pasur parasysh dëmin që i shkaktohet përdoruesit dhe sigurisht rrethit shoqëror. Si droga të lehta konsiderohen kafeina, alkooli, nikotina të cilat janë të lejuara me ligj. Diferencim bën alkooli, përdorimi i të cilit rregullohet me ligj. Ndërsa drogat e tjera

¹ N. Elezi, Mjekësi Sociale Botimi II Tetovë 2020 fq.84/85

² Q. Avziu, A. Osmani, Droga dhe llojet e drogave, Centrum 13 - 2020, UDC:37.014:321.7(497.7) 37.014:316.72(497.7) , <http://centrum.mk/wp-content/uploads/2020/10/PJESA-19.pdf>.

³ A. Osmani, Kodi Penal I Republikës së Maqedonisë së Veriut viti 2015, SHB "FURKAN ISM" Shkup

⁴ <https://www.who.int/>.

dallohen nga efektet e tyre që i shkaktojnë sistemit nervor të njeriut dhe si të tilla janë të ndaluara me ligj.

2. Vështrim historik mbi lëndët narkotike

Njohuritë e para mbi përdorimin e lëndëve narkotike datojnë që nga kohët e lashta parahistorike. Farat e kanabisit janë përdorur si ushqim në Kinë rreth 6 mijë vjet para erës sonë.⁵Gjurmë të përdorimit të lëndëve narkotike i gjejmë edhe në ritet fetare, sidomos murgjit e lashtë të cilët i përdornin si pije kundër gjumit, me qëllim për të zgjatur lutjet e tyre. Lëndët narkotike, kanë një përdorim të hershëm edhe në Lindjen e Mesme dhe në shume vende të tjera të botës.Shumë nga shkrimet e lashta vërtetojnë ekzistencën e lëndëve narkotike edhe në kohën e Hipokratit, i cili i përdorte këto bimë për shërimin e sëmundjeve të ndryshme. Disa të dhëna tjera historike verifikojnë përdorimin e tyre në Amerikën Jugore, në Ande, ku rritet bima Erytrocion Coca, prej mijëra vitesh kjo bimë gjenë përdorim tek punëtorët dhe skllëverit, që punonin punë të rënda, ato përtypnin gjethet e kësaj bime për të përballuar mundimet e rënda fizike, urinë, etjen dhe përgjithësisht për të përballuar vështirësit e jetës.⁶ Historikisht bimët narkotike janë kultivuar në të gjithë botën, zbulimi i të cilave ka ndodhur në periudha të ndryshme. Në Persinë e lashtë përdorimi i narkotikëve ka qenë shumë normal dhe është përdorur si në mjeksi, ashtu edhe nga mbretërit dhe njerëzit e privilegjuar.Gjithashtu kontinenti amerikan ka qenë i mbingarkuar me bimë narkotike, përdorimi i të cilave është bërë në mënyrë shumë normale, madje fiset indiane e kanë përdorur për lidhjen e tyre me Zotin.Ekzistojnë shumë fakte, të cilët vërtetojnë rritjen dhe kultivimin e bimëve narkotike, të cilat me kalimin e kohës dallohen nga mënyra e përdorimit të tyre.Disa lloje më të lehta të tyre, pranohen shumë normalisht nga shoqëria siç janë : alkooli, nikotina dhe kafeina.Përdorimi i narkotikëve për një kohë të gjatë ka qenë legal dhe shumë i përhapur nëpër të gjithë botën.Madje edhe në rajonin tone, përdorimi i hashashit ka qenë mjaft i përhapur në një kohë bukur të gjatë, ku sipas disa të dhënave popullore, hashashi është përdorur për fëmijët e vegjël për ti vënë në gjumë për një kohë të gjatë dhe për qetësimin e dhimbjeve të ndryshme.

⁵ S.Kodra,Droga dhe efektet e saj fq.98

⁶L.Sokoli, "DROGA" Onufri, Tiranë,1999

Nga të dhëna më të vonshme, në Angli shpërndarja e narkotikëve bëhej në mënyrë krejt normale nëpër farmacit e atëhershme në formë të ilaceve. Këto substanca duke vepruar në jetën psikike të njerëzve, u renditen në një listë recetash dhe u emëruan me fjalën „DROGA„ term ky që në mesjete tregonte produkte me efekte dëmprurëse⁷. Në Amerikë lëndët narkotike filluan të përdoren nëpër dhoma të veçanta në formë të bareve dhe kazonove, të cilat ishin risi aziatike e në veçanti të kinezëve, të cilat filluan të frekuentoheshin nga pasanikët amerikanë, dhe për një kohë të shkurtër u bënë qendër e vëmendjes së qeverisë amerikane për lëndën e panjohur, e cila sillte përfitime të pashpjegueshme për kinezët. Si çdo risi tjetër, edhe drogat, qofshin edhe ato më të lehtat, në fillimet e tyre ishin privilegje vetëm të shoqërisë së lartë. Gjatë kalimit të viteve përdorimi i disa lëndëve narkotike u bë mjaft ibujshëm dhe sillte përfitime të mëdha në tregjet botërore. Amerikës nuk i konvenonte ngritja ekonomike aq e shpejt e Kinës, e sidomos kur përdoruesit e parë të kësaj lënde ishin qytetarët amerikanë dhe këtu qeveria e asaj kohe filloj të ndërmerre veprime për kontrollimin e tregut dhe ndalimin e përdorimit të këtyre lëndëve.

Në fillimin e viteve 1800, shkenctarët zbuluan se si mund të prodhohej kimikisht morfina, një qetësues i fortë anesteziq nga opiumi⁸. Opiumi dhe morfiumi, hyn shumë shpejt në fushën e mjeksisë si dozat kryesore si anestezi gjatë operacioneve të ndryshme sidomos atyre të zemrës. Për shkak të një rritje të befasishme të përdorimit të heroinës pas tregtimit fillestar të drogës, Akti i Harrison i Shteteve të Bashkuara i vitit 1914 kërkonte që të gjithë narkotikët të jepeshin me rekomandime të mjekut⁹, duke u pasuar edhe me ligje të tjera. Në vitin 1947 Këshilli Kombëtar i Kërkimeve krijon një organ pasardhës, Komitetin për varësinë e drogës dhe narkotikëve¹⁰. Tregjet e konsiderueshme për kanabis, heroinë dhe amphetaminë kanë ekzistuar në shumë vende evropiane që nga vitet 1970 dhe 1980.¹¹ Duke pasur parasysh efektet dhe pasojat që po linin këto substanca në sjelljet njerëzore dhe sigurisht edhe interesi për kontrollin

⁷ V. Latifi, Kriminalistika, Prishtinë 2014

⁸ S. Kodra, Droga dhe efektet e saj, fq. 84

⁹ Po aty

¹⁰ David F. Musto, Drug Abuse Research in Historical Perspective, <https://www.ncbi.nlm.nih.gov/books/NBK232965/>

¹¹ Raporti Evropian për Drogën, trendet dhe zhvillimet, 2017, fq. 19

https://www.emcdda.europa.eu/system/files/publications/4541/TI_PUBPDF_TDAT17001SQN_PDFWEB_20171128162141.pdf

e tregut nga përfitimet e majme, qeveritë e asaj kohe vazhdimisht përpiqeshin të vendojnë një rregull ligjore e cila do të detyronte të gjitha shtete për të ndaluar trafikimin e lëndëve narkotike. Fjala „Luftë kundër drogës,, u përdor për herë të parë nga presidenti i Amerikës Richard Nixon në konferencën për shtyp me 17 qershor 1971, të cilën e cilësoi si armiku i shoqërisë dhe e cilësoi përdorimin e saj si të paligjshëm¹². Në vitin 1961 u miratua Konventa mbi drogat narkotike e ndryshuar nga Protokollin 1972, nënshkruese e së cilës ishte edhe ish-Jugosllavia. Duke pasur parasysh rrezikun dhe mirëqënien e njerëzve Organizata Botërore e Shëndetësisë krijoi Fondin e Kombeve të Bashkuara për Kontrollimin e Drogave ,më në kryeorganin ndërkombëtar Komisionin e Këshillit për narkotikët në vitin 1971 miratoi Konventën mbi substancat psikotrope, të cilës i caktoi një liste të ndarë për substancat narkotike dhe substancat psikotrope.

3. Klasifikimi i disa drogave drogave

Drogat klasifikohen në disa mënyra të ndryshme ,duke filluar nga klasifikimi i përgjithshëm siç është: droga të ligjshme dhe droga të paligjshme. Si droga të ligjshme konsiderohet Kafeina e cila gjendet në kafe dhe në koka kolë, nikotina në cigare. Gjithashtu edhe barnat që shitën në farmaci janë droga të ligjshme, efekti dhe qëllimi i të cilave është mjekimi i sëmundjeve. Droga të paligjshme janë droga të cilat janë shumë të dëmshme dhe të gjitha vendet në botë mundohen ti mbajnë nën kontroll¹³. Të gjitha drogat dehëse ose pijet narkotike ,për kah origjina mund të jenë :natyrore dhe sintetike ¹⁴. Sipas Organizatës Botërore të Shëndetësisë drogat ndahen në:

-Stimuluese

- Depresive

- Halucinogjene

Stimulantët janë droga stimuluese, të cilat detyrojnë organizmin e njeriut të pësojë ndryshime në rritjen e temperaturës, rritjen e rrahjeve të zemrës, rritjen e tensionit të gjakut etj, ndryshe

¹²<https://drugpolicy.org/issues/brief-history-drug-war>

¹³ N.Elezi, Mjekësia Sociale Botimi i II, Tetovë 2020 fq.85

¹⁴ R.Halili, Kriminologjia Prishtinë 2008 fq.308

njihen edhe si droga eksituese. Si droga stimuluese llogariten kokaina dhe amfetamina duke përfshirë edhe një grup drogash të tjera në vete por që grupin e stimulantëve e kryesojnë këto të dyja, të cilat njihen ndryshe si droga të Andeve, për shkak të origjinës së tyre nga Amerika Jugore. **Kokaina** është bërë nga Erythroxylon cocoa, një bimë me gjethe të shëndetshme. Ka dy forma të ndryshme të kokainës :

- Kokaina hidrokloride
- Kokaina copë¹⁵

Substancat depressive janë droga me efekte qetësuese, të cilat japin qetësi dhe gjumë dhe pikërisht për këtë shkak, këto substanca janë përdorur shumë dhe në mjeksi për ndërhyrje të shumta kirurgjikale dhe sidomos për qetësim të dhimbjeve. Shumica e barërave qetësuese, edhe sot e kësaj dite përmbajnë sasi të substancave depressive, të cilat janë të kontrolluara nga Organizata Botërore e Shëndetësisë. Në grupin e substancave depressive bëjnë pjesë: Opiumi, Morfina, Heroina.

Opiumi është një nga drogat më të përdorura të shekujve të kaluar sidomos nga shtresat e larta. Ai përgatitet nga lëngu i lulëkuqes, i cili pas tharjes, shëndrrohet në një narkotik tepër të fuqishëm e gjatë ekspozimit të tij me ajrin ai merr ngjyrën e zezë. Opiumi ndryshe njihet si një specialitet kinez që hyri në treg nga kinezët nëpër lokalet e kumarit si një shoqërues i cili merret në formë të cigares – tymosjes. Deri në shekullin e 20 – të ai ishte tejet legal. Sipas Zyrës për OKB-së për drogat dhe luftimin e tyre, Afganistani mbetet një ndër vendet e para të prodhimit të Opiumit në botë.

Morfina përgatitet nga Opiumi, i cili prodhohet nga qumështi i frutave të papjekura të bimës së hashashit.¹⁶ Është një qetsues i fuqishëm që heq dhimbjet e mëdha efekti i së cilës zgjat nga 5 deri 6 orë. Viteve të fundit po bëhet një tentim për përdorimin e morfinës për përdorim si një qetësues në rastet e rënda me kancer. Marrja e së cilës bëhet nëpërmjet venave të gjakut pra me injektim.

¹⁵ S. Kodra, Droga dhe efektet e saj fq 65/66

¹⁶ N. Elezi, Mjekësi Sociale Botimi II, Tetovë 2020 fq.86

Heroina është derivat i morfiunit dhe bën pjesë në drogat helmuese ose toksikomane, ose në toksikomani të rëndë¹⁷ Është një nga drogat më të kërkuara, trafikimi i së cilës është shumë i madh dhe çmimet e saj janë shumë të larta. Ajo u zbulua rastësisht nga shkencitari gjerman Dreser dhe shpejt hyri në grupin e drogave më të kërkuara për shkak të efektit të saj qetësues.

Halucinogjenet – quhen kështu drogat psikedelike, sepse kur merren në doza të caktuara shkaktojnë halucinacione, dmth përceptime në mungesë të objektit që përceptohet¹⁸, imagjinata se mund të prekin gjëra që me sy ose në relaitet nuk ekzistojnë. Si halucinogjen më i përhapur dhe më i njohur në mbarë botën, sidomos në shekullin e kaluar është LSD, një nga drogat më të përdorura nga studentet, dhe një nga drogat të cilat i gjejmë nëpër biografite të fytyrave më të njohura publike mbarë botërore. Një ndër ta është edhe Stiv Jobs. Në grupin e halucinacioneve bën pjesë edhe marihuana e cila përmban doza të vogla të THC, ndërsa hashishi është me një THC shumë më të lartë dhe të madh se marihuana. Të dy kanë të njetën prejardhje nga *Canabis Sativa*.

3.1 Kanabisi është bimë e cila bën pjesë në grupin e drogave halucinogjene, për nga pamje është e ngjajshme me formën e shkurreve e cila rritet nga 2 deri në 3 meta gjatësi, u përshtatet shumë lehtë kushteve të ndryshme atmosferike dhe pothuajse rritet në të gjithë botën. Është droga më e përdorur dhe më e kërkuar me tregun më të gjerë në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Rruga kryesore e kanabisit dhe derivateve të tij është nga Shqipëria, përmes pjesës veri-perëndimore në pjesën jug-lindore të vendit drejt Greqisë dhe Bullgarisë¹⁹ Përdoruesit e saj kryesisht janë fëmijë nga moshë 14 vjeç e sipër. **Kanabisi** mund të përpunohet dhe të përdoret në tre forma të ndryshme, ato janë: marihuana hashishi dhe vaji i hashishit²⁰. Ajo çka e dallon kanabisin nga bimët tjera narkotike është se kanabisi ka dy lloje të luleve dhe atë lulet femërore në formë të pocës të cilat japin polenin. Lulet mashkullore (staminate) të cilat zakonisht vdesin kur mbaron ciklusi I rritjes së tyre.²¹ Bima e kërpit –

¹⁷R. Halili, „Kriminologjia,, Prishtinë 2008 fq.95

¹⁸ L.Sokoli, Droga Shtëpia Botuese “Rinia 2000” fq 25.

¹⁹https://www.emcdda.europa.eu/publications/country-overview/2013/north-macedonia/html_en

²⁰N.Elezi, Mjekësi Sociale Botimi II, Tetovë 2020, fq.97

²¹G.Winger, J.H.Woods, F.G.Hoffman, Manual i Abuzimit të Drogës dhe Alkoolit, Marijuana dhe Hashishi, fq.108, botuar në gjuhën angleze në vitin 2004, Oxford University Press, botuar në gjuhën maqedone nga Ars Lamina LLC në vitin 2010.

kanabisit përmban shumë kimikate,psikoaktivitet kryesor i të cilave është tetrahidrokannabinoli(tetrahydrocannabinol,THC)²².THC është veçuar për herë të parë nga dr.Rafael Mechoulam në Universitetin Hebre të Jeruzalemit në Izrael në vitin 1964.²³Përdorimi bëhet në forma të ndryshme ,në formë të cigares, me përzierje me barna, me përzierje nëpër pije të ndryshme etj.Efektet e saj janë më shumë relaksuese dhe qetësuese, jep gjumë, një ndjenjë kënaqësie euforie dhe rehatie.Kanabisi është një ndër substancat psikoaktive më të përdorura sot në botë, ajo më së shumti përdoret nga të rinjtë në formë të duhanit ose duke e përzier atë me duhan.Sipas raportit të UNODC të vitit 2015, në vitin 2013 vlerësohet se 181.8 milion njerëz të moshës 15-64 vjeç përdoren kanabis për qëllime jo mjekësore në nivel global²⁴ në vendet me të ardhura të larta dhe të mesme.Në Maqedonin e Veriut kanabisi është drogë e cila prodhohet, konsumohet dhe rradhitet si një ndër drogat më të përdorura nga adoleshentët dhe fillestarët.Shitesit ambulant gjejnë një interes të veçantë tek të rinjtë për këtë drogë për shkak të efektit të saj stimulues, shkaqet e përdorimit në aspektin social janë rebelimi ndaj prindërve, shkollës, ose gjendjes ekonomike.Rreziku i varshmerisë nuk është aq i lartë sa tek drogat e tjera, mirëpo përdorimi i shpeshtë dhe rritja e sasisë ngre nivelin e dëshirës për të provuar edhe droga të tjera siç janë: heroina dhe kokaina.

Në të gjithë jurisdiksonet ndërkombëtare kontrabanda me kanabis paraqet veper penale e cila dënohet sipas legjislacioneve vendore ,lartësia e denimeve është e ndryshueshme nga politikat vetijake të shteteve.Në vitin 2014,droga përbënte 57% të vlerësimit të përgjithshëm prej 1.6 milion veprash penale (EMCDDA, 2016)²⁵ Nga praktika gjyqësore globalisht kanabisi është drogamë e kërkuar momentalisht për shkak tëçmimit të saj më të lirë,prodhohet dhe importohet brenda kufijve Evropian.Sipas raportit Evropian të Drogave (EMCDDA)për vitin 2018 në Bashkimin Evropian janësekuestruar gjithsej 3.3 milion bimë kanabisi²⁶ ,Truqia është shteti që ka një rritje të vazhdueshme të prodhimit të kanabisit i cili një pjesë përdoret për tregjet

²²A.Goldstein, VARËSIANga Biologjia në Politikën e Drogës,faqe 196, e drejta e autorit Oxford University Press ,viti 2001,botuar në gjuhën maqedone nga Ars Lamina LLC,viti 2010.

²³ S.Kodra,Droga dhe efektet e saj, fq.100

²⁴https://www.who.int/substance_abuse/publications/msbcannabis.pdf

²⁵<https://www.drugsandalcohol.ie/27071/1/TD0217210ENN.pdf>

²⁶<https://www.emcdda.europa.eu/system/files/publications/13238/TD0420439ENN.pdf>

ilegale të brendshme dhe një pjesë importohet jashtë Turqisë nëpër rrugë të ndryshme kontrabandike.

3.2 Kokaina

Kokaina rradhitet si droga e dytë e paligjshme në Evropë me prejardhje nga Amerika e Jugut dhe trafikohet përmes rrugëve klandestine në Evropë. Ajo bën pjesë në grupin e drogave stimuluese, e cila prek sistemin nervor dhe ndryshon gjendjen shpirtërore, zakonisht jep eufori dhe përdoruesit ndjejnë një vetëbesim, lumturi dhe gëzim nga ana shpirtërore. Ajo merret nëpërmejt hundës me thithje, me tymosje dhe me injektim. Kokaina është bërë nga Erythroxylon cocoa, një bimë me gjethe të shëndetshme²⁷. Inkët ishin përdoruesit e parë të kokainës, ajo ishte privilegj vetëm për mbretërit ose njerëzit e zgjedhur të mbretit. Me kalimin e kohës gjethet e kokainës filluan të përdreshin edhe nga njerëzit e shtresës së thjeshtë. Gjermania dhe Peruja kanë qënë vendet e para të cilat kanë dhënë një informacion më të madh rreth përdorimit të Kokainës gjatë mesit të shekullit të 12-të. Kokaina u bë e njohur në vitin 1884 pasi mjeku austriak publikoi gjetjet e tij mbi aftësinë e kokainës për të nxitur anestezi korneale në operacionin kirurgjikal të syve²⁸. Në fund të viteve 1800 dhe fillimet e viteve 1900 u përhap pija e re e Coca-Colës e cila kishte shijen e kokainës, në një përqëndrim pak më të lehtë. Kokaina ishte trendi i ri dhe qendra e përdoruesve të saj ishin shtetasit amerikan. Qeveria e Shteteve të Bashkuara njoftonte 5000 vdekje nga përdorimi i kokainës deri në vitin 1912²⁹. Kokaina ishte një nga stimulantet më të kërkuar, ku deri në vitet e 1980-ta konsiderohej si një drogë luksoze për shkak të çmimit të saj³⁰. Fama e kokainës në kontinentin amerikan i atribuohet trafikantit më të njohur të shekullit të kaluar Pablo Eskobarit. Për shkak të efekteve të saj, kokaina edhe sot e kësaj dite mbetet një nga drogat më të shtrenjta dhe më të kërkuara, sidomos nga shtresa e lartë e shoqërisë në mbarë botën, sipas Zyrës së Kombeve të Bashkuara

²⁷ S.Kodra, Droga dhe efektet e saj, fq.65

²⁸G. Winger, J.H. Woods, F.G. Hoffman, Manual i Abuzimit të Drogës dhe Alkoolit, Marijuana dhe Hashishi, fq.125, botuar në gjuhën angleze në vitin 2004, Oxford University Press, botuar në gjuhën maqedone nga Ars Lamina LLC në vitin 2010.

²⁹ S.Kodra, Droga dhe efektet e saj, fq.67

³⁰A. Goldstein, VARËSIANga Biologjia në Politikën e Drogës, faqe 181, e drejta e autorit Oxford University Press ,viti 2001, botuar në gjuhën maqedone nga Ars Lamina LLC, viti 2010.

për drogën dhe krimin (UNODC)³¹ – nga viti 2007 deri në vitin 2017 çmimi i kokainës në Evropë varion nga 55 deri në 112 dollar për gram. Sipas raportit Evropian të Drogës (EMCDDA) për vitin 2018 janë konfiskuar 243 kilogram në rritje të gjetheve të kokës ,gjithashtu edhe 184 kilogram të koka-past, që vërteton zhvillimin e laboratorëve prodhues të kokainës³²

Maqedonia e Veriut është një vend transit për trafikimin e kokainës, por edhe të gjitha drogave të tjera, përdoruesit e kokainës në Maqedoninë e Veriut janë në një numër relativisht të vogël, për shkak të çmimit të lartë të saj dhe ekonomisë së dobët të vendit. Siç është theksuar pak më lartë Maqedonia e Veriut trafikimin, prodhimin dhe shpërndarjen e kokainës dhe të gjitha lëndëve narkotike e ndalon me ligj në bazë të nenit 215 dhe 216 të Kodit Penal të Republikës së Maqedonisë së Veriut. Sipas statistikave të UNODC për Maqedoninë e Veriut në vitin 2018 kokina ka një përdorim shumë të vogël në krahasim me vendet e tjera në rajon. Statistikat e publikuara nga Ministria e Punëve të Mbrendshme për vitin 2019 tregojnë se në pikat kufitare në Maqedoninë e Veriut është sekuestruar gjithsej 852.3 gram kokainë e pastër.³³

3.3 Heroina

Pluhuri i bardh- djalli i bardh ose heroina është një ndër drogat më të fuqishme dhe të frikshme në mbarë botën, ajo kryeson tregjet botërore. Heroina është droga më skllavëruese.³⁴ Heroina bën pjesë në familjen e opioideve, është lëndë e zierjes së morfines, zbulimi i saj i atribuohet shkencëtarit Heinrich Dreser si një punonjës i kompanisë Bayer në Gjermani. Shumë shpejt produkti i ri i kompanisë Bayer pushtoi tregjet në mbarë botën deri në vitin 1914 kur Akti i Harrisonit ndaloi përdorimin e heroinës dhe të çdo droge tjetër pa recetë të mjekut. Në vitin 1923 ,Divizioni i Narkotikëve në Departamentin e Shteteve të Bashkuara të Amerikës (Agjencia e parë federale e Drogës), ndaloi tregtimin e të gjithë narkotikëve ³⁵. Disa vite më vonë Lidhja e Kombeve bëri ndalesën e parë mbi eksportin e

³¹ Zyra e Kombeve të Bashkuara për drogën dhe krimin

https://dataunodc.un.org/drugs/heroin_and_cocaine_prices_in_eu_and_usa-2017

³²<https://www.emcdda.europa.eu/system/files/publications/13238/TD0420439ENN.pdf>

³³ Ministria e Punëve të Brendshme në Republikën e Maqedonisë së Veriut, mvr.gov.mk/granichni-premini

³⁴ L.Sokoli, Droga Shtëpia botuese, „Rinia,, 2000,, fq32

³⁵ S.Kodra, Droga dhe efektet e saj, fq 63

narkotikëve. Edhe përkundër ligjeve të rrepta, heroina vazhdon të mbetet pushtuesi i tregjeve të zeza, si një thesar i pazëvendësueshëm.

Varësia është efekti më i rrezikshëm i marrjes së heroinës, ajo dëmton veshkët, kanalet e zemrës, ngushton venat e gjakut dhe një sërë dëmsh të tjera që janë gati të pariparueshme.

Sipas raportit Evropian të Drogave të vitit 2020 (EMCDDA), në vitin 2018 gati 16 tonë heroinë anhidriti acetik pararendës kimik u kap në Bashkimin Evropian dhe furnizimi me 9 tonë të tjerë u ndalua para se të hynte në zinxhirin e furnizimit.³⁶

Maqedonia e Veriut, mbetet një rrugë kaluese ballkanike në trafikun e drogës. Si një nga furnizuesit më të mëdhej botëror edhe për Maqedonin e Veriut, Afganistani është pika kryesore e heroinës. Heroina vjen më shpesh nga Turqia, Bullgaria ose Greqia drejt Shqipërisë ose Serbisë, kokaina trafikohet rrugëve ajrore përmes aeroportit të Shkupit ose përmes detit në portet në Shqipëri dhe Bullgari, por drogat sintetike vijnë më shpesh nga Bullgaria dhe Serbia.³⁷ Si pjesë e Ish-Jugosllavisë, Maqedonia e Veriut deri në vitet e 90 pothuajse ishte e paprekur nga trafikimi dhe përdorimi i heroinës dhe narkotikëve të tjerë me përjashtim të rasteve shumë të rralla, kjo periudhë zgjati deri në fillimet e vitit 2000 -2001. Pas Luftës ndëretnike në vitin 2001 Maqedonia e Veriut pësoi një rënie të madhe ekonomike, rebelimi i popullatës në atë kohë si dhe kaosi i shkaktuar u mundësoi trafikantëve hapjen e rrugëve të reja të tregtimit të lëndëve narkotike edhe në Maqedonin e Veriut. Tensionet ndëretnike bënë bashkë edhe bashkëpunimet mes grupeve kriminale të cilat kishin filluar të krijoheshin dhe po sillnin një rend të ri në vend.

Duke iu referuar raportit CARPO të vitit 2005, konsumi vjetor i heroinës në Maqedoninë Veriut ka arritur deri në 300 kg heroinë, me një fitim për tregun e ilegal nga 10-12 milion euro. Shpërndarja e heroinës më së shumti bëhet në klube të natës. Në Republikën e Maqedonisë së Veriut nga 95%-96% të përdoruesve të drogës praktikojnë përdorimin intravenoz³⁸.

³⁶<https://www.emcdda.europa.eu/system/files/publications/13238/TD0420439ENN.pdf>

³⁷https://www.emcdda.europa.eu/publications/country-overview/2013/north-macedonia/html_en

³⁸<http://www.healthrights.mk/index.php/arhiva-na-vesti/14-vesti/576-%D0%B4%D1%80%D0%BE%D0%B3%D0%B0%D1%82%D0%B0-%D0%B2%D0%BE->

4. *Keqpërdorimi i narkotikëve*

Me hyrjen në fuqi të Konventës unike për drogat narkotike 1961, me prokollin e vitit 1972, Konventës për Substancat Psikotrope 1971, Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër tregtisë së paligjshme me droga narkotike dhe substance psikotorpe 1989, globalisht prodhimi, furnizimi dhe shpërndarja e narkotikët paraqet vepër penale , të denueshme me ligj , mvarësisht sipas ligjeve vetjake të shteteve. Këto Konventa janë të pranuar edhe nga Republika e Maqedonisë së Veriut e cila ndalon prodhimin e autorizuar dhe lëshimin në treg të drogave narkotike, substancave psikotrope dhe presekutoreve me nenin 215 të Kodit Penal, si dhe ndalon mundësinë e përdorimit të drogave narkotike me nenin 216 të Kodit Penal dhe gjithashtu ka në fuqi dhe zbatim Konventën unike për drogat narkotike të vitit 1961. Lartësia e dënimit për prodhuesit ose furnizuesit e drogave është nga 3 vjet deri në 10 vjet nëse vepra penale është kryer nga një individ, ndërsa nëse vepra penale është kryer nga disa persona lartësia e dënimit minimalisht shkon deri në 5 vjet burgim. Përdorimi i barnave në vende publike për përdorim personal është kundërvajtje e cila rregullohet me nenin 20 sipas Ligjit për kundërvajtje kundër rendit dhe paqes publike dhe përdoruesi dënohet me gjobë nga 200 deri në 500 Euro në valutë denar, ndërsa për persona juridik gjoba fillon nga 15.000 deri në 30.000 euro në kundërvlerë denar³⁹. Për përdoruesit e drogës, gjykata gjithashtu mund të marrë vendime me masat alternative për trajtim të detyrueshëm në institucionet përkatëse për narkotikët. Sipas raportit të EMCDDA I bazuar në Akademinë Reitox mbi shkeljet e ligjit për drogen në rajonin e Ballkanit Perëndimor, I organizuar me 2-3 prill të 2014 në Podgoricë, Maqedonisë së Veriut iu dha vërejtja se për përdoruesit gjithashtu edhe furnizuesit recidivist nuk kishte asnjë lloj ndryshimi në ligj⁴⁰, e cila nuk mund të jetë e barabartë me një veper penale që kryhet për herë të parë. Përdoruesit e parë në menyrë zyrtare të drogave në Maqedonin e Veriut janë regjistruar në vitin 1969 nga Ministria e punëve të brendshme⁴¹.

%D1%80%D0%B5%D0%BF%D1%83%D0%B1%D0%BB%D0%B8%D0%BA%D0%B0-
%D0%BC%D0%B0%D0%BA%D0%B5%D0%B4%D0%BE%D0%BD%D0%B8%D1%98%D0%B0.html

³⁹Ligjit për kundërvajtje kundër rendit dhe paqes publike, Gazeta Zyrtare numër 66/2007 Kuvendi I Republikës së Maqedonisë së Veriut, me ndryshime të botuar në Gazetën Zyrtare të vitit 2015, Neni 20.

⁴⁰https://www.emcdda.europa.eu/system/files/publications/968/Drug%20law%20offences%20in%20the%20West%20Balkan%20region_meeting%20report.pdf

⁴¹Ministria e Shëndetësisë - Strategjia nacionale për droga në Republikën e Maqedonisë (2006-2012).

Pavarësisht ndalesave ligjore,përpjekjeve të shteteve për kontrollimin e narkotikëve,raportet nga zyrat për narkotiket dhe statistikat e shumta flasin për numra të frikshëm të përdoruesvetë narkotikëve, të cilët janë në rritje çdo ditë e më shumë.Kjo gjendje për juridiksionet penale do të thotë se miliona njerëz janë të implikuar në trafikimin e paligjshëm të narkotikëve për qëllime kriminale.

Narkomani, si personalitet, varësisht se cilën drog dehëse apo pije narkotike e përdor, zakonisht është person i humbur,emocionalisht i papjekur ,në disa raste tepër inert ,pasiv ose depresiv e në rastet e tjera i vrazhdë ose agresive⁴²Duke qënë nën efektin e drogës dhe humbjen e vetëdijes këta persona jepen pas sjelljeve delikuate dhe veprime kriminale,e sidomos vepra penale kundër pasurisë – vjedhjeve të banesave ,shtëpive ,farmacive të ndryshme ,inkriminimin e tyre në vepra penale të dhunës,duke ushtruar dhunë tek familjarët ose njerëzit perreth tyre, për shkak të nevojës së tyre për lëndë narkotike shpesh herë ato janë pjesë e kindapimeve të ndryshme dhe shantazheve të personave të ndryshëm për të arritur deri tek të hollat të cilat u nevojiten për të blerë lëndën narkotike,organizimin e prostitucioniti cili është pjesë e pandashme e botës kriminale të narkotikëve ,trafikimin e armëve në rrugë të paligjshme etj.Kjo është edhe arsyeja pse kriminologjia për shkak të sjelljeve kriminale i cilëson narkomanet si factor kriminogjen.Sepse këto faktor kriminogjen kontribojnë në jetesimin dhe zgjerimin e organizatave kriminale.

Nga gjendja e narkomanëve shfrytëzojnë organizatat kriminale, të cilat së pari i anëtaresojnë në grupet e tyre kriminale, duke i furnizuar me lëndë narkotike për përdorim personal me kusht që të kryejnë detyra të ndryshme në adresë të organizatës, siç është për shembull shitës ambulant i cili do të tërheq përdorues të rinj në rrethin e tyre, ose si transportues të mallit nëpër kufijt ndërkombëtar.Edhe pse ligjet për narkotikët janë shumë të rrepta dhe çdo ditë po punohet për kapjen e rrjeteve të ndryshme kriminale, përsëri kjo në një formë është e pamundur pikërisht për shkak të këtij faktori kriminogjen, i cili shfrytëzohet nga rrjetet e mëdha kriminale.

<https://www.emcdda.europa.eu/system/files/attachments/11716/FYROM%20Strategy%202006-12.pdf>

⁴² R.Halili, Kriminologjia, Prishtinë 2009 fq.312

5. Indikatorët e kontrabandës me narkotik

Ekonomia e dobët, papunësia, pamundësia për të dalë nga situata të rënda ekonomike, sociale dhe shoqërore, mungesa e ndihmës nga strukturat shtetërore për njerëzit në nevojë, korrupsioni dhe qeverisjet e gabuara janë arsye kryesore të cilat shtyjnë persona të pafajshëm në botën e krimit. Sipas psikologjisë së Frojdit gjinia mashkullore konsiderohet më e predispozuar për tu bërë pjesë e grupeve kriminale, grup moshat më të mëdha sipas raportimeve të EMCDDA janë 14-39 vjec. Të rinjtë e grup moshës 14-18 vjec shpesh përdorin droga për ta anashkuar presionin e shkollës, problemet psikike të adoleshencës, presionin ose moskujdesi i duhur nga ana e prindërve (sidomos duhet theksuar fëmijët të cilët vijnë nga familje problematike ose familje ku njeri prind është përdorues i drogave, familje në të cilën është prezente dhuna në familje, fëmijë që vijnë nga prindër të divorcuar etj.). Kjo kategori është prehamë e lehtë e cila manipulohet më lehtë nga grupet kriminale. Pikat më të shpeshta të shitësve ambulant janë parqet e shkollave, klubet e natës, kazinot etj. Shitësit mund të jenë persona individual ose të organizuar në grup me numra të ndryshëm pjesëmarrësish.

Organizatave kriminale të drogës janë celulat kriminale më të fuqishme në botë, me një organizim dhe strategji të mirëfillt brenda tyre, rregullimi i tyre strukturor ngjason me fuqinë e hierarkive të cilat përbëhen nga shtresa e udhëheqësve pastaj administratorët e tyre, menaxherët e punëve brenda organizatës, rendi i njerëzve më të besueshëm duke zbritur deri tek punëtorët e thjeshtë, fundi i të cileve janë viktimat ose përdoruesit apo blerësit e narkotikëve. Këto grupe kriminale vëndojnë në funksion të tyre çdo element të mundshëm për të qëndruar në këmbë. Për shkak të përfitimeve vjetore miliarda dollarëshe në të shumtën e rasteve sidomos në shtetet me ekonomi më të dobët janë drejtuesit e politikës vendase që do të thotë se korrupsioni tek politikanët është në nivele të larta. Shpesh herë ne jemi dëshmitar se grupet kriminale janë investitorët më të mëdhej të partive të ndryshme politike. Ky është shkak që shumë shtete të zëna brenda këtyre krimeve janë të detyruara nga Bashkimi Evropian që të bëjnë reforma në ligje dhe në të gjithë organet shtetërore. Numri i veprave penale të furnizimit me drogë, në Bashkimin Evropian është rritur me 7% që nga viti 2008, me

një vlerësim e më shumë se 230 000 rasteve në 2018. Përsëri, kanabis dominon, duke zënë 57% të veprave penale të furnizimit⁴³

Duke marrë parasysh që Republika e Maqedonisë së Veriut me një ekonomi të dobët e cila varet nga buxheti shtetëror, ku shkalla e papunësisë sipas Entit Shtetëror statistikor arrin në 16.4 ,ose 155.949 persona⁴⁴ nuk i ka shpëtuar trafikimit të drogës, megjithëse konsiderohet si një vend transit për rrugët e trafikimit të drogës, institucionet bëjnë përpjekje për ti aplikuar sa më shumë ligjet ekzistuese për narkotikët dhe për të sjell ndryshime në ligje, të cilat do të jenë në përputhje me standardet evropiane dhe rregullat ndërkombëtare. Prokuroria Publike është një nga institucionet më të rëndësishme për ndjekjen e trafikantëve vetiak dhe grupimeve kriminale të trafikut të drogës Republikën e Maqedonisë së Veriut. Neni 29 për Prokurorinë Publike parashikon detyrat kryesore të saj të cilin e ngarkon në „Luftën kundër krimit të Organizuar dhe Korrupsionit”. Ministria e Punëve të brendshme me organet e policisë bashkëpunojnë me politikat e Europolit dhe Interpolit, për koordinim dhe shkëmbim të informacioneve. Trafikantët e drogës janë kryesisht meshkuj, me moshë brenda një grupi kriminal që varion nga 22 deri në 55 vjec, shumica e të cilëve janë të etnitetit maqedonas⁴⁵ Si shtet me përbërje nga etnitete të ndryshme i sapo dalë nga një krizë e krijuar mes dy etnive kryesore maqedonase dhe shqipëtare në vitin 2001, kjo nuk përben problem për të bashkëpunuar në krijimin e grupimeve të ndryshme kriminale. Të dhënat nga Ministria e Drejtësisë tregojnë se 546 persona u akuzuan kundër Nenit 215 dhe 122 kundër Nenit 216 të Kodit Penal në 2011⁴⁶.

Në vijim nëpërmjet tabelëstë publikuar nga Ministria e Punëve të Brendshme për vitin 2017-2018 do të paraqesim gjendjen e konfiskimeve totale të lëndëve narkotike sipas Kodit Penal të RMV- neni 215 dhe 216 në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

⁴³https://www.emcdda.europa.eu/system/files/publications/13236/TDAT20001ENN_web.pdf

⁴⁴https://www.stat.gov.mk/PrikaziSoopstenie_al.aspx?rbtxt=98

⁴⁵ Projekti Rajonal CARPO – Raporti mbi Gjendjen e Krimit të Organizuar dhe Krimit Ekonomik në Evropën Juglindore, fq.113, Strasburg, gusht 2006
<https://rm.coe.int/16806ef3d4>

⁴⁶https://www.emcdda.europa.eu/publications/country-overview/2013/north-macedonia/html_en

Konfiskimet totale të barnave sipas neneve 215 dhe 216 ⁴⁷			
LLOJI I LËNDEVE	Viti 2017	Viti 2018	rritet / zvogëlohet %
Marihuane (gram)	510,180.00	1,532,430.00	rritet trefish
Heroine (gram)	1,400.00	1,970.00	40.7
Kokaine (gram)	263.84	586.69	Rritet per 2.2 here
Pemë	389	819	Rritet per 2.1 here
Tableta sintetike	1,116,606	537	Shumëfishzvogëlimi

6. Rekomandimet e OBSH-se, për rrezikshmërinë e kanabisit

Organizata Botërore e Shëndetësisë, është një organizatë globale e cila kujdesjet për shëndetin public ndërkombetar. Krijimi i saj i atribuohet Kombeve të Bashkuara, detyrë e saj është të merret me kujdesin e shëndetit publik, bën monitorimin e rreziqeve të shëndetit publik, vendos standard ndërkombetare mbi higjenën, jep udhëzime ndërkombëtare shëndetësore, mbledh të dhëna globale, bën raportime globale, ofron vlerësime shkencore, bën zbulime të reja duke u munduar të mbroj mirëqënien e gjithë njerëzve në mbarë botën. Posedon fonde të saja të veçanta, sipas raportit të programit për buxhetin e vitit 2020-2021, fondet arrijn në 4,2 miliard euro⁴⁸. Siguron shërbime shëndetësore për shtetet e varfëra dhe bën kontrollin shtëpive të shëndetësisë në gjithë botën. Ajo u themelua në 7 Prill të vitit 1948 krahas Kombeve të Bashkuara⁴⁹, selia e saj ndodhet në Gjenevë me shumë zyra të vecanta, Maqedonia e Veriut është një ndër 194 vendet anëtare e saj.

Duke iu referuar Konvetës së vetme për Narkotikët të vitit 1961⁵⁰, OBSH I ka cilësuar substancat psikoaktive si të dëmshme për shëndetin dhe mirëqënien e njerëzve dhe ka përpiluar një liste të tyre të cilat i ndalon dhe i klasifikon sipas rrezikshmërisë së tyre.

⁴⁷ Ministria e Punëve të Brendshme- <https://mvr.gov.mk/analiza/kriminal/55>

⁴⁸<https://apps.who.int/iris/handle/10665/330074>

⁴⁹<https://www.who.int/about/who-we-are/history>

⁵⁰https://www.unodc.org/documents/commissions/CND/Int_Drug_Control_Conventions/Ebook/The_International_Drug_Control_Conventions_E.pdf

Kanabisi për vite me rradhë është cilësuar si një substancë e rrezikshme dhe bën pjesë në listën e drogave të ndaluara nga Organizata Botërore e Shëndetësisë. Konventa e vitit 1961 mbi narkotikët dhe drogat cilëson si të dëmshëm dhe ndalon përdorimin, prodhimin e kanabisit dhe e rreshton në një kategori me drogat e tjera siç janë: heroina, kokaina, morfina etj. Pavarësisht ndalesës nga Konventa e vitit 1961, gjatë vitit 1976 me anë të peticioneve të ndryshme Shtetet e Bashkuara të Amerikës i janë drejtuar shumë herë Organizatës Botërore të Shëndetësisë, që të heq kanabisin nga lista e drogave të rrezikshme dhe ta lejoj përdorimin e saj në mjeksi për përpunimin e produkteve mjeksore dhe rekomandimin e këtyre produkteve me recetë nga mjekët. Këto përpjekje kanë tentuar disa herë të shkojnë edhe nëpër seanca gjyqësore por kanë përfunduar si të pa sukseshme. Përpjekje dhe peticione janë bërë edhe gjatë gjithë viteve në vazhdim por pa sukses. Përpjekja e fundit ishte nga drejtori i përgjithshëm i OBSH Dr. Tedros Ghebreyesus, i cili paraqiti 8 rekomandime para Kombeve të Bashkuara në mbledhjen e datës 24 Janar të vitit 2019⁵¹.

Me këto 8 rekomandime, kërkohet që të rishikohen dhe rivlersohen edhe njëherë vlerat mjeksore të kanabisit⁵², duke i lejuar ekspertët dhe shkenctarët të japin edhe një herë një vlersim për efektet mjeksore, të cilat do të ndihmojnë shëndetin public, pa hequr kontrollimin për parandalimin e keqpërdorimeve edhe në aspektin medicinal.

Komisioni i Kombeve të Bashkuara, ka pranuar vetëm një propozimin nga OBSH me 27 vota pro dhe 25 kundër⁵³, për të hequr kanabisin nga orari i IV i konventës 1961⁵⁴. Ndërsa 4 rekomandime të tjera refuzoi dhe 2 rekomandime abstenoj duke lënë hapsirë edhe për një rivlersim të tij në të ardhmen. Duke lu referuar rekomandimeve të UNDOC, Komisioni refuzoi rekomandimin e OBSH për të zhvendosur⁵⁵:

⁵¹<https://www.who.int/teams/health-product-and-policy-standards/controlled-substances/who-review-of-cannabis-and-cannabis-related-substances>

⁵²https://cdn.who.int/media/docs/default-source/controlled-substances/unsg-letter-ecdd41-recommendations-cannabis-24jan19.pdf?sfvrsn=6070292c_2&download=true

⁵³ Draft report Rapporteur: Emmanuel Nweke (Nigeria) Addendum
https://www.unodc.org/documents/commissions/CND/CND_Sessions/CND_63/ECN72020_L1_Add4_e_V2001601.pdf

⁵⁴https://www.unodc.org/unodc/en/commissions/CND/Mandate_Functions/current-scheduling-recommendations.html

⁵⁵ Po aty.

- dronabinolin dhe stereoizomeret e tij nga oraret e Koneventës për substancat psikotrope e vitit 1971,
- për të shtuar dronabinol dhe stereoizomeret e tij (delta-9-tetrahidrokannabinolin) në Programin I të Konventës 1961,
- refuzoi rekomandimin për të lëvizur tetrahidrokannabinolin (gjashtë izomere të delta-9-tetrahidrokannabinolin) nga Konventa e 1971 në Konventën e 1961,
- refuzoi rekomandimin për fshirjen e dronabinolit dhe stereoizomerëve të tij (delta-9-tetrahidrokannabinolin) nga Konventa e vitit 1971,
- Ndërsa abstenoj me 27 vota për rekomandimin për të fshire ekstraktet dhe tinkturat e kanabisit nga Orari I Konventes 1961,
- Gjithashtu abstenoj rekomandimin e OBSH për të shtuar një shënim në Shtojcën I të Konventës 1961 për të lexuar "Përgatitjet që përmbajnë kryesisht kanabidiol dhe jo më shumë se 0.2 përqind të delta-9-tetrahidrokannabinolin nuk janë nën kontrollin ndërkombëtar",
- Komisioni gjithashtu refuzoi rekomandimin e OBSH-së për të shtuar përgatitje të caktuara të dronabinolit në Shtojcën III të Konventës 1961⁵⁶.

Ky raport lenë të kuptojmë se Komisioni ka vendosur që ti japin shkencës një mundësi për rivlerësimin e bimës së kanabisit për qëllime mjeksore, duke motivuar me ngulm kontrollimin e narkotikëve dheluftimin e trafikimit ilegal të tyre.

7. Legalizimi I kanabisit

Me legalizim nënkuptojmë lejimin e diçkaje të dënueshme nga strukturat ligjore, në rastin konkret me legalizim të kanabisit nënkuptojmë përdorimin e kanabisit për qëllime mjekësore. Kanabisi është një ndër drogat më të përharura dhe më të përdorura në botë , sidomos gjatë viteve të fundit. Bima e kanabisit është vlerësuar si një substancë narkotike e ndaluar e cila

⁵⁶https://www.unodc.org/unodc/en/commissions/CND/Mandate_Functions/current-scheduling-recommendations.html

duhet ti nënshtrohet dënimeve penale edhe sipas Konventës së vetme të Narkotikeve të vitit 1961 dhe Akteve të tjera për ndalimin dhe kontrollimin e drogave. Kanabisi nuk veçohet në asnjë rast nga drogat e tjera siç është heroina dhe kokaina përse i përket rrezikshmërisë së shëndetit publik. Kanabisi, siç u tha më lartë, cilësohet si një bimë, lulet e së cilës përmbajnë dy kanabionoidet THC dhe CBD. Për shkak të përmbajtjes së saj të THC-së ajo cilësohet si një drogë me efekte dehëse, edhe pse sipas zbulimeve të shkencës mjeksore CBD përcillet me përfitime shëndetësore të cilat mund të rezultojnë të dobishme për shërimin e disa sëmundjeve. Por pavarësisht kësaj, sipas të gjitha legjislacioneve ndërkombetare prodhimi, tregtimi i kanabisit, furnizimi me kanabis për çfarëdo lloj arsye, mbajtja e tij për përdorim personal ose shpërndarje tek të tjerët është i ndaluar me ligj dhe sanksionohet në bazë të juridiksioneve shtetërore me burgim. Lartësia e sanksioneve me burg, dallon sipas juridiksioneve të vet shteteve. Në vitet e fundit shumë shtete në botë bëjnë përpjekje për të ulur ndëshkimin e përdorimit të kanabisit, disa shtete kanë hequr sanksionimin me burg dhe e cilësojnë atë si një shkelje dytësore që hyn në grupin e masave alternative tek dënimet me gjobë, ndërsa disa shtete e konsiderojnë si kundervajtje⁵⁷.

Legalizimi i kanabisit është një nga temat më të vjetra dhe me aktuale në botë, për vite me rradhë ende nuk i është dhënë një përgjigje përfundimtare nga Komisioni Ndërkombëtar për Kontrollin e Drogave nëse bima e kanabisit mund të legalizohet siç kërkojnë një grup shtetesh ose mbetet në listën e drogave të rrezikshme. Vendi i parë që ka kërkuar heqjen e kanabisit nga lista e drogave të rrezikshme janë Shtetet e Bashkuara të Amerikës, të cialt sot numerojnë 34 shtete që lejojnë përdorimin e kanabisit për qëllime mjeksore me ligje të veçanta për kontrollimin e THC dhe në 18 shtete është lejuar mbikëqyrja e kanabisit në kushte shtëpiake për qëllime rekreative dhe medicinale⁵⁸. Për Shtetet e Bashkuara të Amerikës debati ende vazhdon, disa shtete kanë bërë dekriminalizimin total të kanabisit që nënkupton përdorimin e tij me një kontroll dhe ligj të veçantë, që ushtrohet nga ana e vet shtetit lejues ndërsa disa shtete kanë legalizuar kanabisin vetëm për qëllime mjeksore. Shtetet janë të pavaruara në legjislacioneve e

⁵⁷https://www.emcdda.europa.eu/news/2018/low-thc-cannabis-products-being-sold-in-the-EU%E2%80%93key-legal-issues_en

⁵⁸<https://zhurnal.mk/mbikqyrja-e-kanabisit-ne-bote-si-cili-shtet-deshiron-te-behet-kryeministri-zaev/>
Artikull postuar nga gazeta Zhurnal e ejnte ,31 dhjetor 2020

tyre dhe një nga modelet më të njohura është legalizimi i Marihuanës – kanabisit për qëllime mjeksore në shtetin e Kalifornisë në vitin 1996, ku pas nje debati të gjatë, qeveria e asaj kohe vendosi që ky vendim të merret me ane të referendumit, votës së popullit, i cili vendosi pro legalizimit. Ndërsa për Evropën ky vendim ishte pak i frikshëm edhe për diskutim, asnjë qeveri në Evropë nuk e ka pranuar prodhimin e kanabisit dhe u përmbahen rregullave ndërkombetare për dënimin e tyre me ligj, duke veçuar Holandën e cila njihet për politikën e saj progresive me legalizimin e kanabisit nga vendet e tjera Evropiane. Në vitin 1970 Holanda ka lejuar konsumimin e kanabisit nëpër kafeteritë të cilat ishin të licencuara⁵⁹. Holanda ndjek një model të veçantë dhe të vetmin në bote e cila bën ndarjen e llojeve të drogës i veçon ato dhe i rendit në kategori të veçanta, p.sh. përdorimi i kanabisit për përdorim personal deri në 5 gram nuk ndëshkohet me ligj, kontrollimi i sasisë së përdorimit me ligj është i rregulluar në mënyrë të veçantë për të gjitha llojet e drogave, Holanda parashikon se lejimi i përdorimit me sasi të vogla shkatërron tregun e madh të trafikimit të drogave, sepse në këtë mënyrë përdoruesit do të mund të blejnë bimën nga pika të licencuara të cilat kontrollohen nga autoritete e policisë shtetërore, gjithashtu Holanda licencën kafenetë për shitje dhe konsum të kanabisit brenda tyre, licencat i japin komunat duke vendosur disa kritere që duhet të plotësohen nga ana e kafeterive ndërsa dënohet ashpër me ligj nga shteti holandez shitja dhe posedimi personal i cili i kalon kufijtë e sasisë së caktuar me ligj⁶⁰. Në pajtim me parimin e praktikës, Prokuroria publike mund të marrë vendim që të mos ngrihet akuzë për vepër lidhur me drogat, nëse vlerëson se kjo nuk është në interes publik⁶¹. Defakto Holanda ka shkuar në heshtje drejt dekriminalizimit por që strategjia e saj ligjore ka qënë që të godas grupet e mëdha kriminale të cilët trafikojnë lëndët narkotike, praktika ligjore dhe statistikat e ndryshme të përdoruesve tregojnë një ulje të personave të varur dhe vdekjeve nga narkotikët në këtë shtet.

Dekriminalizimi i narkotikëve në Portugali erdhi pas një situatë tejet të rënduar të vitetve të 90-ta për shkak të rritjes së veprave penale si pasojë e trafikimit, tregtimit, përdorimit me

⁵⁹https://www.emcdda.europa.eu/publications/topic-overviews/cannabis-policy/html_en

⁶⁰https://www.emcdda.europa.eu/publications/topic-overviews/cannabis-policy/html_en

⁶¹ V. Dekov, Dekriminalizimi i drogave si bazë për politikë humane dhe të efektshme për drogat Analizë e modelit Portugez dhe Holandez të dekriminalizimit Dokumenti për Politika Publike http://coalition.org.mk/wp-content/uploads/2021/01/BRIF_ALB_CIP.pdf

narkotike,numrat e të burgosurve për trafikantët dhe përdoruesit po rriteshin çdo ditë ,ligji për ndalimin e tyre nuk kishte efektet e mjaftueshme, me një strategji të menduar mirë nga organet shtetërore dhe me konsultimin me ekspertët e narkotikëve Portugalia filloi me aplikimin e programit për dekriminalizimin e narkotikëve.Dekriminalizimi i barnave përcaktohet si eliminimin e dënimeve penale për përdorimin e drogës dhe posedimi i barnave për përdorim personal,si dhe eleminimin e dënimeve penale për posedim të pajisjevetë përdorura për qëllim të futjes së barnave në trupat njerëzor, siç janë shiringat⁶².

Statistika.com vlerëson se në vitin 1999 kanë gjetur vdekjen nga mbidoza 369 persona ,ndërsa me dekiminalizimin e drogës në vitin 2016 ka një ulje drastike në vdekshmërinë nga mbi doza në vetëm 30 persona, gjithashtu statistika.com raporton se në vitin 2000 kanë humbur jetën 907 persona per shkak të injektimit me shiringa dhe infektimit të tyre me HIV, kurse në vitin 2017 kjo shifër minimalizohet ose gati eliminohet në vetëm 18 persona të ifektuar me HIV nga injektimi me shiringa, gjithashtu Portugalia ka një rënie të personave të burgosur të ngarkuar me vepra penale të drogës nga viti 1999 në të cilin janë regjistruar plot 3863 persona të dënuar ,shifër e cila në vitin 2017 përgjysmohet në 1140 të dënuar për vepra penale me ngarkim trafikim,ngarkim ,posedim ,shpërndarje të drogave⁶³ .

Duhet theksuar se kanabisi me THC më të vogel se 0,3 % ose 0,2% varësisht vlersimit të shteteve është pothuajse legal në të gjitha shtetet, tek produktet e kozmetikës me pretendimin se këto produkte nuk kane aspak efektin dehës dhe nuk janë të rrezikshme për shëndetin e njerëzve. Që nga viti 2017, kanabisi bimor dhe vajrat e kanabisit janë ofruar për shitje të hapur në dyqanet e ushqimit të shëndetshëm ose dyqanet e specializuara në disa vende të BE-së, duke përfshirë Francën, Italinë, Luksemburgun dhe Austrinë.⁶⁴

⁶²Drug Decriminalization in Portugal Learning from a Health and Human-Centered Approach Prepared by: Drug Policy Alliance 131 West 33rd Street 15th Floor New York,Ny 10001 drugpolicy.org
https://drugpolicy.org/sites/default/files/dpa-drug-decriminalization-portugal-health-human-centered-approach_0.pdf

⁶³<https://www.statista.com/chart/20616/key-developments-since-portugal-decriminalized-drugs/>

⁶⁴https://www.emcdda.europa.eu/news/2018/low-thc-cannabis-products-being-sold-in-the-EU%E2%80%93key-legal-issues_en

Në vitin 2016 Maqedonia e Veriut iu bashkohet vendeve evropiane në legalizimin e kanabisit për qëllime mjekësore duke u bërë kështu vendi i 14-të në Evropë. Legalizimi i Kanabisit rregullohet në bazë të Ligjit për Kontrollin e Drogave Narkotike dhe Substancave Psikotrope. Me këtë ligj parashihet të hidhen në treg tre lloje prodhimesh dhe atë vaji i kanabisit me përmbajtje të THC 0,2 %, vaj i kanabisit me përmbajtje më të lartë se 0,2% të THC dhe preparate me bazë të konopit. Legalizimi i kanabisit ka qëllime humane dhe do të përdoret për mjekimin e sëmundjeve të parapara në bazë të shkencës mjekësore. Maqedonia e Veriut me legalizimin e kanabisit, synon që të hyjë në tregun evropian nga i cili pritet të ketë përfitime të majme të cilat do të hyjnë në arkën shtetërore. Në bazë të Ligjit për Kontrollin e Drogave Narkotike dhe Substancave Psikotrope ajo parashikon një tatim për subjektet juridike të licencuara për prodhimin e Marihunes rreth 10% nga fitimi i prodhimit, gjithashtu subjektet juridike janë të detyruara që fitimet e përfituara duhet të jenë investime brenda territorit të saj, në sfera të ndryshme, me ç'rast do të hapeshin vende të reja pune dhe zhvillim në degë të ndryshme.

8. Përfitimet financiare nga legalizimi i kanabisit

Pas shumë dekadash ndalimi i përdorimit të kanabisit për qëllime mjekësore, nëpër botë po fillon një etapë e re me legalizimin e marihuanës për qëllime mjekësore. Marihuana është bima me e konsumuar në botë, numri më i madh i veprave penale në botë është nga shpërndarësit ilegal të marihuanës, duhet theksuar se nga raporte të ndryshme mbi numrin e të dënuarve nëpër burgje, shpërndarësit e marihuanës janë ato që kanë numrin më të madhë që vuajnë dënimet nëpër burgje, e njëjta vlen edhe për Maqedoninë e Veriut dhe për vendet tjera Evropiane dhe Ballkanike. Me legalizimin e marihuanës shtetet pretendojnë të zvogëlojnë tregun ilegal të saj dhe të zvogëlojnë numrin e veprave penale. Por një faktor tjetër i rëndësishëm është edhe përfitimi financiar i shteteve nga kultivimi dhe prodhimi i produkteve mjekësore nga bima e kanabisit.

Sikurse çdo produkt tjetër edhe legalizimi i marihuanës mund të sjell të ardhura të shumta për shtetin nëpërmjet taksave. Aksionet e marihuanës momentalisht në të gjithë botën janë me një rritje ekstreme, e kjo për shkak të trendit më të fundit, përdorimit të marihuanës për qëllime

mjekësore.Për Evropën deri në fund të vitit 2016 legalizimi i marihuanës nuk shihej si një domosdoshmëri ajo ishte më e stepur,në gjashtë muajt e parë të vitit 2018 pati një rritje të jashtëzakonshme të pacientëve që përdorin produktet e kanabisit për shërim,lehtësim të dhimbjeve dhe kjo përqindje kaloi përtej 40% ,me investimet që u rriten deri në 150 milion Euro⁶⁵.Gjatë vitit 2020 shumë vende evropiane legalizuan marihuanën për qëllime mjeksore,për shkak të kërkesës së madhe të tregut dhe efekteve që po jepte marihuana tek pacientët me sëmundje të ndryshme por sidomos ato malinje.Futja e Bimës së kanabisit në industrinë e farmacisë për përdorimin dhe legalizimin e barnave të prodhuara nga marihuana po merr vëmendjen gjithnjë e më shumë nga investitorët për prodhimin e kësaj bime, për shkak të përfitimeve shumë të larta,produktet e saj janë produktet më të kërkuara të momentit,duke filluar nga produktet e kozmetikës, barnat e ndryshëm për shërimin e disa sëmundjeve sidomos sëmundjeve malinje,përdorimi i tyre në mjekësinë dentare,përdorimi i tyre si barna të qëndrueshëm për kafshët dhe si ushqim për to.Amerika dhe Kanadaja janë vendet që kryesojnë në prodhimin e kanabisit në botë,ndërsa për Evropën Holanda është shteti i cili ka bërë më shumë hapa drejt legalizimit të kanabisit, por edhe reforma të mirëfillta në drejtësi për kontrollimin e saj në shpërndarjen në treg.Sipas një raporti të vitit 2015 rreth 300 pacientë gjermanë me kushte të rënda mjekësore lejoheshin të blejnë produkte të kanabisit në çdo farmaci për të lehtësuar dhimbjen e tyre,vlera e se ciles arrinte mes 800 dhe 1000€ në muaj,vlerë e cila nuk mbulohej nga sistemi i sigurimit shëndetësor⁶⁶.Deri në vitin 2017 Gjermania ishte një nga vendet më skeptike për sa i përket legalizimit të marihuanës dhe prodhimit të bimës brenda territorit të vët,për të plotësuar nevojat e pacientëve,Gjermaninë furnizonte Holanda,zhvillimi i tregut dhe rritja e kerkesës,por më së shumti fitimi financiar detyroi Gjermaninë që ta rimendoj legalizimin dhe prodhimin e bimës së kanabisit brenda territorit të saj,pas vitit 2016 Gjermania është vendi me zhvillimin më të shpejtë të përdorimit të marihuanës për qëllime mjekësore në vendet evropiane.Përgjat vitit 2020 sipas Raportit Evropian mbi Kanabisin edicioni i 6 të kompanisë Prohibition Partners Gjermania ka trajtuar me produkte të kanabisit mbi 128.000 pacientë duke u bërë një nga vendet me tregun më të madh evropian.Në gjysmën e parë të vitit 2020 në Gjermani janë shitur mbi 75 milion euro kanabis

⁶⁵<https://www.medcannworldforum.com/the-impact-of-medical-cannabis-in-europe/>

⁶⁶<https://www.ncbi.nlm.nih.gov/pmc/articles/PMC4328738/pdf/embr0016-0130.pdf>

mjekësor dhe CBD⁶⁷kështu Gjermania kryeson në tregun e kanabisit dhe CBD-së në Evropë. Në një nga analizat e fundit të bëra për vitin 2020-2025 sipas statistikave të Prohibition Partners të publikuara në raportet për Spanjën,legalizimi i kanabisit dhe përpunimi i CBD-së do te sjell fitime vjetore deri në 60 milion euro,taksat e të cilave variojnë nga 10% deri në 15% ,duke iu referuar një analize të bërë në Universitetin Autonom të Barcelonës me legalizimin e kanabisit në Spanjë priten të ardhura deri në 3.3 billion euro taksa që do hyjnë në Thesarin Publik të Spanjës⁶⁸.Pas Spanjës renditen edhe shtetet e tjera evropiane siç është Franca,Republika Çeke, Italia,Zvicra etj, të cilat llogaritin të ardhura mjaft të larta nga legalizimi i marihuanës.Duhet theksuar se këto shifra janë të arritura në raport me përdorimin e pacienteve dhe plotësimin e nevojave të tjera që i kërkon tregu në bazë të popullsisë.

Edhe në Maqedoninë e Veriut pritet që të ketë një rritje ekonomike nga Legalizimi i kanabisit për qëllime mjekësore,në një intervistë për shtyp të kryetarit të shtetit Zoran Zaev për Dojçe Vele,të ardhurat nga legalizimi i kanabisit pritet të jenë deri në 250 milion euro⁶⁹.Maqedonia e Veriut do të taksoj kompanitë me një tatim prej 10%,me kusht që përfitimet e kompanive të investohen në shtetin e Maqedonisë në sfera të ndryshme,me qëllim të rritjes së ekonomisë dhe standartit të jetesës për qytetarët e Maqedonisë së Veriut.Disa kompani të licencuara kanë filluar të hedhin në treg vajin e kanabisit për qëllime mjeksore nga 300ml deri ne 600 ml, me çmime të cilat variojnë nga 90 euro deri në 150 euro⁷⁰,çmime te cilat dirigjohen nga Agjensioni i barnave dhe pajisjeve mjekësore në Maqedonin e Veriut (Malmed).Ndërsa pritet që numri i produkteve të shumohet si për produktet kozmetike ashtu edhe për barnat mjeksore,të cilat do të jenë në raport me numrin e popullsisë në vend për të mbuluar nevojat e pacientëve në territorin e Maqedonise së Veriut.

Kanada është një ndër shtetet me përfitimet më të mëdha nga legalizimi i kanabisit, e cila sipas disa raportimeve të saj gjatë vitit 2019, të paraqitura nëpër mediat e vendit u raportua një

⁶⁷ Prohibition Partners, Raproti për Gjermanin mbi Kanabisin dhe konsumatorin e CBD,https://prohibitionpartners.com/report-uploads/Germany-Cannabis-Consumer-Report-Executive-Summary.pdf?mc_cid=31da04f9fb&mc_eid=f491767c69

⁶⁸<https://www.uab.cat/web/newsroom/news-detail-1345668003610.html?noticiaid=1345773927768>

⁶⁹<https://p.dw.com/p/3n0oK>

⁷⁰<https://www.galafarm.com.mk/sq/SH%C3%8BRBIM-CBD-PRODUKTI/>

fitim prej 8.26 miliard dollarë nga legalizimi i marihuanës⁷¹. Statistikat e tilla janë të ndjekura nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës të cilat sipas Cowen, një kompani investimesh dhe shërbimesh financiare, vlerëson se industria CBD në Shtetet e Bashkuara do të jetë me vlerë 16 miliardë dollarë deri në 2025 produktet që përmbajnë derivate të kanabisit si kanabidiol ose CBD⁷². Kalifornia është një nga shtetet që ka të legalizuar marihuanën i cili ka një tatim prej 15% për shitjet me pakicë të kanabisit. Sipas Departamentit të Administratës së Taksave dhe Tarifave të Kalifornisë, industria e kanabisit sjell 411.3 milion dollarë në akcizë, 98.9 milion dollarë në taksën e kultivimit dhe 335.1 milion dollarë në taksën e shitjes, gjithsej në 845.3 milion dollarë në të ardhura nga taksat për tremujorin e tretë të 2019⁷³. Këto të ardhura shpërndahen në disa sektorë të cilët presin zhvillimin e tyre, një pjesë e tyre shkon për edukimin e të rinjve në lidhje me drogat dhe parandalimin e përdorimit të tyre, një pjesë e tyre është e ndarë për mbrojtjen e mjedisit dhe qendrën për kërkime mjekësore të kanabisit. Këtë shembull kane ndjekur edhe disa shtete të tjera në Shtetet e Bashkuara të Amerikës të cilat këto të ardhura i përdorin në sektorët ku kanë më shumë nevojë sidomos në arsimin publik, për programe të vetëdijësimit të të rinjve lidhur me përdorimin e drogave si dhe për bursa të fëmijëve me të ardhura të ulta të cilët nuk kanë mundësi të ndjekin studimet e larta, gjithashtu një pjesë e këtyre të ardhurave shkon për sigurimin shëndetësor dhe përmirësimin e tij publik, poashtu edhe në infrastrukturë.

⁷¹<https://www.bnnbloomberg.ca/cannabis-canada-pot-industry-adds-8-26b-to-canada-s-gdp-1.1324939>

⁷²<https://www.nytimes.com/2020/12/02/world/europe/cannabis-united-nations-drug-policy.html>

Artikull I marrë nga NyTimes – botuar në datë 02.dec.2020 me autor Isabella Kwai

⁷³<https://theeconreview.com/2020/12/18/high-economy-impacts-of-marijuana-legalization-on-the-us-economy/#:~:text=According%20to%20a%20RCG%20Economics,total%20labor%20income%20of%20%24260%2C732%2C000>

Kapitulli i II-të

Përkufizime lidhur me narkotikët

1. *Bima*

Kanabisi është bimë barishtore lulëzuese, rrjedh nga familja e Cnnabaceae (kërpit) me origjinë nga Azia Lindore dhe Qëndrore dhe më pastaj e përhapur në të gjithë botë. E gjejmë me emërime të ndryshme për shkak të “famës së saj nëpër të gjithë botën”, emri i saj më i njohur në rrugën ilegale është „bari”,⁷⁴. Karakterizohet nga ngjyra jeshile, përbëhet nga rrënjët e forta, kërcelli gjethet dhe lulja. Është bimë gjinore që do të thotë përbëhet nga dy gjinitë: gjinin femërore dhe gjinin mashkullore, të cilët dallojnë për nga madhësia e gjetheve, bima mashkull ka gjethe më të ngushta dhe nuk rritet shumë, ndërsa bima femër është më e gjatë e me gjethe më të plota, rritet nga 3- 6 metra varësisht rrethanave dhe kushteve klimatike. Tradicionalisht, majat e luleve të mbuluara me rrëshirë të bimëve femërore dhe gjethet e tyre fqinje janë më të dëshirueshme, dhe disa kultivues fermerë mbledhin ekskluzivisht vetëm bimë femra⁷⁵. Nga studimet e Jean Baptise Lamar rezultoi se kjo bimë ndahet në dy nënloje dhe atë:

- Cannabis Indica dhe
- Cannabis Sativa

Me studimet e mëvonshme për shkak të efektit të saj kanabisi ose kërpit i bashkohen edhe dy nëngrupe të tjera:

- Cannabis ruderalis
- Cannabis afghanica

Kërpi është cilësuar si një bimë e jashtëzakonshme për shkak se çdo pjesë e saj mund të përpunohet, nga përpunimi i kërcellit të kërpit mund të fitohet materiale për veshje, për shkak të numrit të madh të fibrave mund të fitohen edhe materiale të forta ndërtimore. Fibrat e kërpit shërbenin për të bërë veshje në Kinë 600 vjet para erës sonë, kurse në Europë veshjet

⁷⁴<https://www.mjeket.al/index.php?go=drogat&id=142>

⁷⁵G. Winger, J.H. Woods, F.G. Hoffman Manuali i Abuzimit me Drogën dhe Alkoolin ASPEKTI BIOMEDIKAL Kapitulli 7, faqe 108, përshkruar si një referencë nga (Paris dhe Nahas, 1984), botuar në Anglisht në 2004. Nga Oxford University Press, botuar në Maqedonisht nga Ars Lamina DOO në vitin 2010.

mbretërore shpesh ishin të përbëra nga përzierjet e kërpit dhe linit⁷⁶.Produktet që rrjedhin nga farat e kërpit dhe vajit të kërpit kanë një shumëllojshmëri të habitshme këtu përfshihen:drithërat,vajra gatimi,kozmetike,bare,bio-plastika,farat e shpendëve dhe ushqim për kafshët,karburant,locione,lubfrikante,margarine,bojra dhe boje,pluhurat e proteinave,sapun dhe shampo⁷⁷.Në shekullin e XX prodhimi I kërpit u ndalua me ligj për shkak të vetive të tij dhëhese,të cilat rrezikojnë shëndetin e njerëzve.

Siç është theksuar edhe në kapitullin paraprak, Maqedonia e Veriut, e ndalon me ligj sipas Kodit Penal kultivimin , prodhimin,tregtimin dhe përdorimin e kanabisit, por në vitin 2016 Republika e Maqedonisë së Veriut miratoi Ligjin për Kontrollin e Barërave Narkotike dhe Substancave Psikotrope për qëllime farmaceutike.Ligji mundëson kultivimin e kanabisit dhe afionit (lulekuqes) për përdorime medicinale i cili do të monitorohet nga institucionet.Ky ligj rregullon:kompetencat e organeve përkatëse të cilat do të jenë përgjegjëse për të kryer kontrollin mbi prodhimin dhe tregtimin e barnave narkotike dhe substancave psikotrope,cakton masat për parandalimit të substancave narkotike dhe abuzimin me to,trajtimin e veçantë të personave të varur nga drogat narkotike,rehabilitim dhe riintegrimin e tyre në shoqëri,cakton kushtet e veçanta të cilat do të duhet të posedojnë personat juridik për kultivimin,prodhimin dhe tregtimin e barnave narkotike,substancave psikotrope,gjithashtu ky ligj percakton masat mbi abuzimin e prodhimit te barnave narkotike dhe substancave psikotrope, ne bashkepunim me bordin ndërkombëtar të kontrollit të barnave (është organ i pavarur i Kombeve të Bashkuara roli i të cilit është monitorimi për zbatimin e konventave për kontrolline drogave me seli në Vien të Austrisë) dhe UNDOC ⁷⁸përpilon listat e llojeve të barnave, të cilat do të lejohen për kultivim gjithmon duke qënë në zbatimueshmëri dhe pajtueshmëri të plotë me ligjet ndërkombëtare për lejimin e kultivimit të barërave psikotrope dhe substancat narkotike.

Ligji për kontrollimin e barnave narkotike dhe substancave psikotrope Kërpin e përkufizon si: „Kanabis"janë të gjitha pjesët e freskëta ose të thata mbi tokë të bimës,

⁷⁶<https://www.mjeket.al/index.php?go=drogat&id=142>

⁷⁷<https://www.hemp.com/sq/what-is-hemp/>

⁷⁸Zyra e Kombeve te Bashkuara per Drogen dhe Krimin shih <https://www.unodc.org/>

përveçfarave të llojeve të ndryshme të bimëve të kanabisit (kanabis sativa, kanabis indicadhe kanabis ruderalis)⁷⁹.

Pas miratimit të Ligjit për Kontrollimin e Barnave Narkotike dhe Substancave Psikotrope Ministria e Shendetësisë, në bazë të nenit 22 të këtij ligji solli vendimin për ndryshimin, plotësimin dhe klasifikimin e listës së barnave narkotike dhe substancave psikotrope për listat e Konventave për barna narkotike dhe substance psikotrope, në të cilin e ndryshoi emërtimin: Kanabis ,Rreshire kanabisi, tretje dhe ekstrakt kanabisi dhe e zëvendësoi me fjalën Kërp ,Kanabis dhe rrëshirë kanabisi dhe ekstrakte dhe tinktura të kanabisit, ndryshoi dhe zëvendësoj me emërtimin Kanabis, bimë dhe pjesë e bimëve që i përkasin gjinisë së ,Kanabisit, gjithashtu emërtimin Kërp Indian dhe rrëshirë e Kërpit Indian e ndryshoj dhe e zëvendësoj me emërtimin kanabis spp⁸⁰. Ndryshime të cilat hynë në fuqi 8 ditë pas publikimit në gazetën zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut numër 37. nga shkurti I vitit 2016. Me këtë ndryshim bima e kanabisit zyrtarisht bëhet legale në kultivimin, prodhimin e saj në Republikën e Maqedonisë së Veriut për përdorim farmaceutik-mjekësor. Klasifikimi bëhet në kater lista: „në listën e parë klasifikohen substancat narkotike prodhimi dhe përdorimi i të cilave përbën vepër penale, në listën e dytë klasifikohen substancat dhe bimët që i nënshtrohen kontrollimit, në listën e 3 klasifikohen substancat dhe bimët që i nënshtrohen kontrollit të rreptë, ndërsa në listën e katërt klasifikohen substancat dhe bimët që janë pararendësit në përputhje me rregulloret përpararendësit. Substancat në listën II dhe të III vendosen në treg në bazë të përputhjes së tyre sipas rregullores së Bordit Ndërkombëtar për Kontrollin e Narkotikëve⁸¹, të cilat më së pari i hyjnë ekzaminimit laboratorik nga Agjensioni i barnave dhe pajisjeve mjekësore për Republikën

⁷⁹Ligji për Kontrollimin e Barnave Narkotike dhe Substancave Psikotrope ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 103/2008, 124/10, 164/13 dhe 149/15), neni 3, paragrafi 8.
www.slvesnik.com.mk

⁸⁰https://malmed.gov.mk/wp-content/uploads/3.0-Listi-za-imenuvanje-i-dopolnuvanje-na-listi-za-klasifikacija-opojni-drogi_Sl_Vesnik-br.87-od-2016.pdf

⁸¹ Klasifikimin e barnave e gjejmë në Raportin e paraqitur nga Bordi Ndërkombëtar për Kontrollin e Narkotikëve, Substancat Psikotrope 2020, Statistikat për vitin 2019, Vleresimet e Mjekësisë Vjetore dhe Kërkesat Shkencore. https://www.incb.org/documents/Psychotropics/technical-publications/2020/20-06957_Psychotropics_2020_ebook.pdf

e Maqedonisë së Veriut. Emërtimet sipas nenit 22 të këtij ligji, janë të identifikuara nën emrat e tyre ndërkombëtare të pambrojtur (INN) ose nën emrin shkencor⁸².

Në Evropë janë të licencuar vetëm disa shtete për prodhimin e farave të kanabisit, për kultivimin e tyre për qëllime medicinale. Këto kompani janë kompani të cilat përdorin teknologji të veçantë shkencore, të cilat licencohen dhe më pas monitorohen nga organet për kontrollimin e drogave dhe organe të tjera përkatëse struktura të Kombeve të Bashkuara.

Kanabisi në Maqedoninë e Veriut për kultivim dhe prodhim hyjnë si „farë“, e blerë nga agjencione të licencuara nga Holanda ose Spanja nga personat juridik të cilët janë të licencuar nga Komisioni Ndërsektorial, transporti i së cilës bëhet nën masa të rrepta sigurie, duke futur kështu në funksion kontrollet e rrepta doganore, agjencionet për çdoganim të mallrave të cilët para se të bëjnë çdoganimin janë të detyruar që mallin e arritur ta dërgojnë për ekzaminim laboratorik në agjencionin e barnave. Pas përgjigjes pozitive nis procedura e çdoganimit dhe pranimit të farës nga personi juridik i licencuar. Një procedurë e cila kryhet nën kontrolle të rrepta dhe masa të ashpra nga ana e ministrive përkatëse. Sipas nenit 36 të Ligjit për kontrollin e barnave narkotike dhe substancave psikotrope, personi juridik është i limituar në blerjen e farave dhe kultivimin e rrënjëve vjetore të cilat i paraqet me anë të raportimeve deri tek Komisioni Ndërsektorial, të cilët do të vendosin për sasinë e kultivimit në bazë të lartësisë së licencës⁸³.

2. Kultivimi

Mbjellja e farave të kanabisit nga personat juridik të licencuar në Republikën e Maqedonisë së Veriut është e rregulluar në nenin 29-v të Ligjit për kontrollimin e barnave narkotike dhe substancave psikotrope, i cili është i obliguar që të paraqesë kërkesë në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujrave, e cila brenda afatit 15 ditor nga dita e pranimit të kërkesës do të lëshoj miratimin pozitiv ose negativ për mbjelljen e farës⁸⁴. Me

⁸²Ligji për Kontrollin e Barnave Narkotike dhe Substancave Psikotrope ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 103/2008, 124/10, 164/13 dhe 149/15) ndryshuar në Shkurt të vitit 2016 të publikuar në Gazetën Zyrtare të RMV numër 37. www.slvesnik.com.mk, Neni 23

⁸³Po aty, Neni 36.

⁸⁴Po aty, Neni 29.

marrjen e miratimit pozitiv nga Ministria e Bujqësisë,Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujrave,detyrohet të informojë edhe Ministrinë e Shëndetësisë dhe Agjencionin e Barnave për fillimin e mbjelljes⁸⁵.

Për mbjelljen e farave të Kanabisit personat juridik duhet të plotësojnë disa kriteriume, të cilat janë të parashikuara në Ligjin për kontrollimin e barerave narkotike dhe substancave psikotrope, të cilat mbikqyren nga Komisioni Ndërsektorial.Një nga kriteriumet kryesore është përgatitja e ambientit në të cilin do të kultivohet bima e kanabisit.Personat juridik për çdo mbjellje të bëjnë raportim në :Agjencionin e barnave dhe pajisjeve mjeksore, në Ministrinë e Shëndetësisë dhe në Ministrinë e Bujqësisë,Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujrave në të cilin është caktuar resort i veçantë.Zakonisht këto raportime bëhen për çdo veprim që marrin me afat 15 ditë para marrjes së veprimit, me qëllim që Komisioni Ndërsektorial të jetë i njoftuar në kohë dhe të ketë mundësi për mbikqyrje të imtesuar të kushteve, në të cilën do të kultivohet bima.Në të kundërtën ,nëse Komisioni me anë te kontrollit të tij në ambientet e subjektit juridik konfirmon mbjellje ose ndonje veprim te pa lajmëruar do të vlejné rregullat e caktuara në nenet 92,93 ,94 te Ligjit per Kontrollin e Barnave Narkotike dhe Substancave Psikotrope,si pasojë e së cilës do të jetë marrja e licencës dhe konfiskimi I mallit dhe objektit⁸⁶.

Zakonisht mbjellja e kanabisit preferohet të bëhet në fund të marsit dhe në fillim të prillit për shkak se kësaj bime i nevojiten kushte të ngrohta klimatike sidomos rreze të diellit,në një periudh kohore prej 24 orësh kërkon së paku deri në 6 orë rreze dielli.Mbirja e tij kërkon një temperaturë deri në +10 gradë,ndërsa për zhvillimin e tij nevojitet +15 grad celcius.Kanabisi është një bimë shumë e ndijshme e cila dëshiron kushte shumë precize dhe fikse.

Kanabisi sipas përcaktimit të Ligjit për kontrollimin e barërave narkotike dhe subsatncave psikotrope të miratuar nga Republika e Maqedonisë së Veriut në vitin 2016 me disa ndryshime në vitet e ardhshme,mund të kultivohen në dy lloj mënyra.Njëmënyrë është mbjellja gjatë kohës së stinës së pranverës nëpër sera, të cilat po ashtu duhet të jenë të

⁸⁵Ligji për Kontrollin e Barnave Narkotike dhe Substancave Psikotrope("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 103/2008, 124/10, 164/13 dhe 149/15) ndryshuar në Shkurt të vitit 2016, publikuar në Gazetën Zyrtare të RMV numër 37. www.slvesnik.com.mk, Neni 29.

⁸⁶ Po aty, Neni 95.

çertifikuara dhe të monitoruara nga ana e Komisionit Ndërsektorial, i cili jep pëlqimin pozitiv ose negative nëse personi juridik i plotëson ose jo kushtet për mbjellje në serë e cila duhet të jetë e mbuluar, me pajisjet e përshtatshme për kultivimin dhe zhvillimin e kanabisit. Ndërsa mbjellja e dytë është mbjellja në ambiente të mbylluara nëpër vazo, proces i cili është shumë më i veshtirë se sa procesi i parë, sepse teknologjia duhet të jetë në përputhje me ligjin dhe në dobi të zhvillimit të kanabisit, gjithashtu duhet veçuar fakti që mbjellja në ambiente të mbylluara detyron kultivuesit që pastërtia dhe sterilizimi i ambientit të jetë në përputhje me normat maksimale të rregulluara në bazë të neneve 32 dhe 33 të Ligjit për kontroll të barnave narkotike dhe substancave psikotrope, sepse nga këto norma mvaret cilësia e lules së kanabisit, e cila ndahet në fund me klasa në bazë të cilësisë. Kanabisi që kultivohet me llamba, ka THC-në me të lartë dhe është më cilësor, ndërsa kanabisi që prodhohet në ambiente të jashtme ka përqindje më të lartë të CBD-së dhe është i cilësuar si kanabis industrial.⁸⁷ Gjithashtu Ligji për kontrollin e barnave narkotike dhe substancave psikotrope, në bazë të nenit 29-g detyron personat juridik që përgjatë gjithë procedurës së zhvillimit të rritjes së bimës, duke filluar nga numri i mbjelljes së farave, numri i mbirjes së farave, atyre që janë kalbur nën dhe, shkallat e rritjes së bimës, kalbja e ndonjëres nga bimët e deri në përfundim të të gjithë ciklit të rritjes së bimës, për çdo ndryshim më të vogël duhet të njoftojë dhe raportojë brenda 3 ditëve ndryshimin e ndodhur Ministrinë e Shëndetësisë dhe Ministrinë e Bujqësisë dhe Agjencioni i barnave dhe pajisjeve mjekësore⁸⁸.

Neni 29-d i Ligjit për kontrollin e barërave narkotike dhe substancave psikotrope, detyron subjektin juridik të licencuar që 15 ditë para korrjes së bimës të njoftoj Ministrinë e Shëndetësisë për fillimin e vjeljes së bimës⁸⁹. Në bazë të datës së paraqitur, Komisioni Ndërinstitucional i përcaktuar nga ky ligj, do të inspektojë në vendndodhje numrin e bimës së mbledhur dhe masën e lagësht. Pasi është bërë inspektimi i plotë dhe subjekti juridik i ka plotësuar të gjitha kriteriumet dhe fazat e rritjes së bimës dhe ka bërë paraqitjen e rregullt në

⁸⁷<https://top-channel.tv/2019/11/05/top-story-sa-kushton-1-liter-vaj-kanabisi-dhe-si-dallohet-cilesia-e-tij/>

⁸⁸ Ligji për Kontrollin e Barnave Narkotike dhe Substancave Psikotrope ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 103/2008, 124/10, 164/13 dhe 149/15) ndryshuar në Shkurt të vitit 2016 publikuar në Gazetën Zyrtare të RMV numër 37. www.slvesnik.com.mk, Neni 28-g

⁸⁹Po aty, Neni 29-d

ministrinë përkatëse,vazhdon me tharjen e bimës në hapsira të veçanta për qëllime të tharjes me aparaturë përkatëse.Pas tharjes së bimës prodhuesi i licencuar është i detyruar që të peshojë masën e thatë me peshore të licensuar në bazë të Ministrisë së Bujqësisë,Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujrave,peshën duhet ta paraqes në ministrinë përkatëse,masë e cila ambalazhohet sipas kushteve të caktuara në nenin 29-gj⁹⁰.Prodhimi paketohet me foli farmaceutike në atë mënyrë që të mos hyjë ajr ose lagështi brenda paketimit, në të kundërtën do ta dëmtonte produktin dhe do të shtonte gjithashtu kilogramet e paraqitur në ministrinë përkatëse, që pas inspektimit mund të paraqes rrezik për subjektin juridik duke i marrë licencën edhe duke e penalizuar në baze të normave të caktuara të po këtij ligji.Pas paketimit të mirëfilltë nëpër foli bëhet matje përsëri e produktit, dhe pastaj ambalazhim nëpër kuti të kartonit të cilët izoloohen hermetikisht duke i vulosur me shirit sigurie.Në të kutinë e kartonit shënohet data e paketimit ,sasia neto dhe bruto para dhe pas paketimit me foli dhe kutin e kartonit,emri ,zyra e regjistruar e personit juridik,viti i prodhimit,emri i lëndës së parë,dhe data e paketimit. Subjekti juridik përsëri nga neni 29-gj pas paketimit është i detyruar që të njoftojë ministrinë përkatëse dhe Agjencionin e barnave dhe paisjeve mjekësore brenda 3 ditëve nga data e procesit të përfunduar⁹¹.

Komisioni Ndërinstitucional ka lirinë e plotë që edhe pas raportimit të mbarimit të procesit të inspektoje në çdo kohë në vendndodhje për të gjithë procedurat e kryera.Rreziku i personave juridik në këtë proces të paketimit të prodhimit qëndron në ambalazhimin e prodhimit i cili duhet të jetë me të gjitha standardet e kërkuara dhe të jetë një ambalazhim i sigurtë për të ruajtur cilësinë dhe sasinë e cila raportohet para ministrive përkatëse, sepse në të kundërtën kjo masë për shkak të ambalazhimit paketimit jo të sigurtë mund të bymehet dhe të shtojë në peshë,komisioni i cili do të kryejë verifikimin e sasisë do të përballet me kilogram të ndryshëm.Një veçori tjetër është peshorja e cila duhet të jetë e çertifikuar dhe e kontrolluar mirë sepse gabimi i peshores mund të coje në marrjen e licences së personit juridik dhe mbartjen e pasojave juridike.Gjithashtu, rol të madh luan edhe ambienti në të cilin do të ruhen

⁹⁰Ligji për Kontrollin e Barnave Narkotike dhe Substancave Psikotrope("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 103/2008, 124/10, 164/13 dhe 149/15) ndryshuar në Shkurt të vitit 2016 publikuar në Gazetën Zyrtare të RMV numër 37. www.slvesnik.com.mk , Neni 29gj

⁹¹Po aty, Neni 29 gj

kutijat e vulosura , një ambient me lagështi përsëri mund të çoj në konflikte kilogramesh me masën apo sasinë e paraqitur,prandaj sygjerohet që në dhomat përkatëse të specializuara për mbajtjen e prodhimit duhet të ketë matës të veçantë për matjen e vlagës dhe lageshtisë së dhomës.Mbetjet e bimës groposen në një gropë të thellë brenda ambienteve të rrethuara të subjektit juridik, sipas elaboratit të paraqitur në Ministrinë e Shëndetësisë.Kërçelli mund të thahet dhe pastaj të groposet ,ndërsa gjethet dhe mbetjet e tjera groposen për të hyrë në procesin e kalbëzimit.Gjethet e poshtme të bimës përdoren për produktet e kozmetikës pasi që nuk përmbajnë THC dhe kanë vetëm përbërje të CBD-së e cila nuk ka efektet dehëse.Pra mbetje të bimës së kanabisit kemi vetëm kërçellin,pasiqë në Maqedoninë e Veriut ende nuk është përforcuar mirë industria për perpunimin e plotë të kanabisit,sidomos të kërçellit i cili ka shumë fije fibrike të forta të cilat përdoret për ndertime të forta.

3. Bar narkotik

Kanabisi cilësohet si bimë dehëse,për shkak të përmbajtjes së lartë të kimikaleve të ndryshme të cilat gjenden në substancat narkotike.Bima e kanabisit përmban një numër të madh të Alkaloideve të cilat së bashku i quajmë kanabinoidi⁹².Ekzistojnë disa lloje të kanabinoidit,më të shquara janë:Delta-9-tetrahidrokanabinol(THC),Cannabidiol (CBD),dhe Cannabinol (CBN).

Delta-9-tetrahidrokanabinol(Δ -THC),ose Δ 1-THC(i përdorur në nomenklaturë kimike të vjetër),ose dronabinol,me shkurtim THC është substancë kryesore psikoaktive e gjetur në bimën e kanabisit⁹³.THC ose tetrahydrocannabinoli është përberes aktiv të kanabisit,i cili është veçuar për herë të parë nga Dr.Rafael Mechoulam në Universitetin Hebre të Jeruzalemit në Izrael në vitin 1964⁹⁴.

⁹²G.Winger, J.H.Woods,F.G.Hoffman,Manual i Abuzimit të Drogës dhe Alkoolit,Marijuana dhe Hashishi,fq.108,botuar në gjuhën angleze në vitin 2004,Oxford Unniversity Press,botuar në gjuhën maqedone nga Ars Lamina LLC në vitin 2010.

⁹³<https://www.mjeket.al/index.php?go=drogat&id=142>

⁹⁴S.Kodra, Droga dhe efektet e saj, faqe 100

Cannabidiol (CBD) është një phytocannabinoid i zbuluar në vitin 1940. Është një nga 113 kanabinoidet e identifikuar në bimen e kanabisit dhe përben deri në 40% të ekstraktit të bimës⁹⁵. CBD-ja ka vetitë farmakologjike por nuk është psikoaktive⁹⁶, ajo kundërvepron me THC⁹⁷.

Cannabinol (CBN) gjendet në kanabisin e vjetruar dhe është kanabinoidi më i butë psikoaktiv. Kanabisi ka mbi 400 fitokomponentë, nga të cilët të paktën 60 janë kanabinoide, si dhe flavonoide terpen, fitosterole, acide yndyrore omega (omega 3, omega 6 dhe omega 9) dhe përmban aminoacide, përbërje azoti, glikozide, vitamina (A, B, B2, B6, C, D, E, acid folik), pigmente dhe përbërje alkane⁹⁸.

Zbulimet e deritanishme kanë vërtetuar se prania e ulët THC, CBD, CBN duke u përkrahur nga Organizata Botërore e Shëndetësisë ka efekte shëruese të disa sëmundjeve: epilepsia, sëmundjen e Parkinsonit, sklerozën, aneminë, shizofreninë, artritin sëmundjet malinje etj. Ligji për kontrollimin e barërave narkotik dhe substancave psikotrope në Republikën e Maqedonisë dhe në përputhje me rregullat e OBSH, ka limituar përqindjen e THC me 0,2 %, të rregulluar me nenin 22 nga ky ligj⁹⁹. Nga kjo dalim në përfundim se: përqëndrimi më i madh se 0,2 % e THC në product është e ndaluar me ligj dhe cilësohet si vepër penale e cila dënohet në bazë të nenit 215 të Kodit Penal të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

4. Prodhimi

Zbulimet e fundit shkencore kanë treguar se kanabisi është një bimë medicinale për vetitë shëruese të saj për trajtimin e disa sëmundjeve. Nga lulja dhe gjethet e larta të kanabisit prodhohet vaji i kanabisit dhe barëra të tjerë mjekësor me një përqëndrim të THC jo më të lartë se 0,2% dhe në disa shtete varion edhe deri në 0,3%. Gjithashtu gjethet e poshtme të kanabisit

⁹⁵<https://drugsinc.eu/en/encyclopedia/cbd-cannabidiol/>

⁹⁶ Cannabis sativa and Hemp J.A. Hartsel, J.Eades, B.Hickory and A. Makriyannis, Chapter 53 <http://diverdi.colostate.edu/C480A3/reading%20materials/interconversion/nutraceuticals%202016%209780128021477%2000053X.pdf>

⁹⁷<https://www.ncbi.nlm.nih.gov/pmc/articles/PMC3736954/>

⁹⁸<https://fokus.mk/maslo-od-kanabis-kako-dejstvuvai-i-shto-mozhe-da-izlechi/>

⁹⁹Ligji për Kontrollin e Barnave Narkotike dhe Substancave Psikotrope ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 103/2008, 124/10, 164/13 dhe 149/15) ndryshuar në Shkurt të vitit 2016 publikuar në Gazetën Zyrtare të RMV numër 37. www.slvesnik.com.mk, Neni 22.

nuk përmbajnë THC por vetëm CBD e cila ka dhënë shume rezultate pozitive për përgatitjen e produkteve kozmetike(kremra për fytyrë,losione,shampoo etj),gjithashtu gjejnë përdorim në ushqimet e kafshëve,në industrinë e veshjeve për prodhimin e pëlhurave të ndryshme etj.Kërçelli ashtu siç e kemi theksuar, mund të përpunohet për të nxjerr materiale të forta në industrinë e tekstit si litarët, konopet, penjtë e ndryshëm dhe gjithashtu për materiale ndërtimore.

Në Republikën e Maqedonisë së Veriut kanabisi i legalizuar ka gjetur përdorim momentalisht vetëm në përpunimin e vajit,për shkak të mungesës së teknologjisë përkatëse për përpunimin e produkteve të tjera.Këto substanca dhe produkte janë të klasifikuara në listën e klafisikimeve të barërave në pajtim me ligjin, të vendosura në nenin 21¹⁰⁰ të Ligjit për kontrollin e barerave narkotikëve dhe substancave psikoatrive,të cilësuar si klasifikime II dhe të III të cilësuar si legale për përdorimin ne territorin e Maqedonisë së Veriut,sasia e të cilave përcaktohet nga Minsitri i Shëndetësisë në bazë të nevojave vjetore.

Personat juridik të licencuar për kultivimin e kanabisit sipas ligjit në fuqi janë të kufizuar deri tek tharja e lulës së kanabisit, pastaj përpunimi i lulës për përfitimin e produktit duhet ti bashkohet licencë e veçantë, e cila është e rregulluar në nene të veçanta të ligjit në fuqi.Lejet e prodhimit të produkteve mjekësore,veterinare dhe shkencore janë leje të posaçme të cilat mund të merren nga personi juridik i licencuar për kultivim nëse posedon personelin e duhur që kërkohet me rregullore dhe nëse posedon gjithashtu aparaturën e duhur e cila është një investim i madhë.Leja për kultivim është e bashkuar me lejen për prodhim të vajit dhe produkteve te kanabisit,që do të thotë se kompanitë që prodhojnë produktet mjekësore,veterinare ose shkencore mund të jenë të ndara si persona juridik nga kultivuesit e licencuar.

Neni 32¹⁰¹ i ligjit për kontrollin e barnave narkotike dhe substancave psikotrope bën rregullimin dhe ndarjen se cilët subjekte juridike mund të jenë të lejuara për prodhimin e

¹⁰⁰Ligji për Kontrollin e Barnave Narkotike dhe Substancave Psikotrope("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 103/2008, 124/10, 164/13 dhe 149/15) ndryshuar në Shkurt të vitit 2016 publikuar në Gazetën Zyrtare të RMV numër 37. www.slvesnik.com.mk , Neni 21

¹⁰¹Po aty, Neni 32.

produkteve mjekësore. Leja për prodhimin dhe tregtimin e produkteve mjekësore, veterinarë ose shkencore shqyrtohet 90 ditë dhe jepet nga Agjencioni i barnave dhe Pajisjeve mjekësore (zakonisht janë farmacitë të licencuara në vend, prodhues të barnave të ndryshëm mjekësore) nëse aplikanti siguron që nuk do të abuzojë dhe nuk do të prodhojë mallrat e dëmshme dhe siguron një staf të profesionalizuar për prodhimin e barnave mjekësore dhe cilësore, prodhimi i së cilave kufizohet nga madhësia e hapësirës, që do të thotë kufizimet i vendon Ministria e Shëndetësisë në bazë të kapacitetit të hapësirës për prodhim. Leje e veçantë kërket nga personi juridik i cili posedon licencën e veçantë për prodhim dhe tregtim të produkteve mjekësore, veterinarë dhe shkencore, kjo leje rregullohet në bazë të nenit 33¹⁰² të ligjit në fuqi për kontrollin e barnave narkotike dhe substancave psikotrope dhe jepet me pëlqimin e Agjencionit të barnave dhe pajisjeve mjekësore. Puna e personit juridik të licencuar kontrollohet nga Ministria e punëve të brendshme dhe Ministria e Shëndetësisë, për të pasur kontroll mbi produktet e prodhuara ose të asgjësuar. Kjo licencë jepet me një afat kohor prej 5 vjetësh dhe pas skadimit personi juridik duhet të paraqes kërkesë të re për licencimë cila theksohet në nenin 34 dhe nuk është e transferueshme tek një person tjetër juridik.

Licencës për prodhimin e produkteve mjekësore, veterinarë dhe shkencore nga kanabisi i bashkohet edhe licenca për personat e autorizuar për import, eksport dhe transit¹⁰³ e rregulluar me nenin 37, 38, 39, 40, 41, 42, 43, 44, 45 dhe 46 të Ligjit mbi kontrollin e barërave narkotike dhe substancave psikotrope. Lejet për import, eksport dhe transit quhen leje të veçanta për shkak të procedurave të veçanta që u jepen personave juridik të cilët posedojnë një licencë për prodhimin e produkteve mjekësore, veterinarë dhe shkencore. Këto leje rregullohen nga Ministria e Shëndetësisë me një afat kohor prej 3 muajsh, janë leje të pa transmetueshme në persona të tjerë juridik, përjashtim bëhet vetëm në rast të ndonjë katastrofe natyrore ose kushteve të jashtëzakonshme.

¹⁰²Ligji për Kontrollin e Barnave Narkotike dhe Substancave Psikotrope ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 103/2008, 124/10, 164/13 dhe 149/15) ndryshuar në Shkurt të vitit 2016, publikuar në Gazetën Zyrtare të RMV numër 37. www.slvesnik.com.mk, Neni 33

¹⁰³Po aty, Neni 37.

Shitja e këtyre produkteve nëpër farmaci gjithashtu kontrollohet dhe kujdes të veçantë i kushtohet sasisë e cila limitohet duke i detyruar mjekët në mjekësi, stomatologji dhe veterinarët që përdorimin e këtyre barërave ta japin me recetë dhe asesi në forma të tjera. Shitja nuk mund të bëhet me kërkesë nga pacienti pa patur një recetë dhe rreptësisht ndalohet përdorimi ose rekomandimi nga mjekët për fëmijët deri në moshën 18 vjeçare dhe për personat të sëmundje mendore.

5. Përcaktimi i nevojave vjetore për barna narkotike

Pas sjelljes së miratimit për ligjin e legalizimit për barnat narkotike dhe substancat psikotrope për qëllime farmaceutike dhe shkencore, shtetet detyrohen të bëjnë një vlerësim për përcaktimin e nevojave për barna narkotike, e cila bëhet sipas rregullave të dhëna nga Bordi Ndërkombëtar për Kontrollin mbi Drogat dhe Organizata Botërore e Shëndetësisë, duke zbatuar rregullat e Konventave dhe Traktateve Ndërkombëtare mbi Narkotikët, në bazë të nevojave të paraqitura shtetërore nga Ministria e Shëndetësisë përcaktohet sasia e cila duhet prodhuar brenda një periudhë kohore (brenda 1 viti) e cila shifër sugjerohet nga Agjencioni I barnave dhe pajisjeve mjekësore.

Shtetet në përgjithësi kanë një rregullore të tyre në bazë të nevojave të paraqitura gjatë një viti, por nëse një vend nuk arrin të përmbushë detyrimin e tij të bazuar në traktate për të dhënë vlerësime për narkotikët barnat dhe vlerësimet për substancat psikotrope, atëherë përcaktohen vlerësimet dhe vlerësimet nga INCB për të bërë të mundur që vendi në fjalë të importojë substanca të kontrolluara¹⁰⁴

Kur një vend nuk arrin të përmbushë detyrimin e tij të bazuar në traktate për të dhënë vlerësime për narkotikët, barnat dhe vlerësimet për substancat psikotrope, përcaktohen vlerësimet dhe vlerësimet nga INCB për të bërë të mundur që vendi në fjalë të importojë

¹⁰⁴Guide on Estimating Requirements for Substances under International Control Developed by the International Narcotics Control Board and the World Health Organization for use by Competent National Authorities https://www.incb.org/documents/Narcotic-Drugs/Guidelines/estimating_requirements/NAR_Guide_on_Estimating_EN_Ebook.pdf

substancia të kontrolluara¹⁰⁵. Organizata Botërore e Shëndetësisë nëpërmjet udhëzimeve të ndryshme ju siguron shteteve informacionin e duhur rreth barnave narkotike, pajisjeve mjekësore dhe organizimet e shteteve ndërmjet vete¹⁰⁶. OBSH ndihmon shtete gjithashtu me përpilimin dhe publikimin e listave për barat e klasifikuara sipas rregullave ndërkombëtare¹⁰⁷

Për përzgjedhjen, sasinë, cilësinë dhe dozën e barnave narkotike zgjedh vet shteti në bazë të nevojave të raportit mbi konsumimin e bërë në tre vjetet e fundit, në bazë të shitjes së tyre dhe në bazë të kërkesës për vitin e fundit e cila mund të jetë rritur ose zvogëluar varësisht sëmundshmërisë¹⁰⁸. Këto kalkulime bëhen nga Agjencia e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore duke i raportuar Ministri i Shëndetësisë, listën e përpiluar e raportojnë tek personat juridik të licencuar për të kultivuar, prodhuar, farmacitë shitëse të këtyre barnave.

6. Licenca e operimit me narkotik

Rregullat për marrjen e licencës për kultivimin e kanabisit për qëllime mjekësore, janë pothuajse të njëjtat në të gjithë vendet Evropiane, të cilat kanë aprovuar kultivimin e kanabisit për qëllime farmaceutike.

Britania e Madhe është një ndër vendet ku aplikimi për licencë mund të behët edhe në mënyrë elektronike nëpërmjet faqës të qeverisë së Britanisë së Madhe¹⁰⁹, duke ofruar shumë guida të ndryshme të cilat do ti udhëzojnë të interesuarit për kushtet të cilat do të duhet të plotësohen

¹⁰⁵INTERNATIONAL NARCOTICS CONTROL BOARD Guide on Estimating Requirements for Substances under International Control Developed by the International Narcotics Control Board and the World Health Organization for use by Competent National Authorities

https://www.incb.org/documents/Narcotic-Drugs/Guidelines/estimating_requirements/NAR_Guide_on_Estimating_EN_Ebook.pdf

¹⁰⁶https://www.who.int/hiv/pub/amds/who_edm_par_may99.pdf - udhëzues i OBSH-së mbi Parimet Operative për prokurorim të mirë farmaceutik Gjenevë 1999.

¹⁰⁷ Trade and Health: Towards building a National Strategy, Editors: R.Smith, Ch.Blouin, Z.Mirza, P.Beyer, N.Drager (Fjalor i Globalizimit, Tregtisë dhe Shëndetësisë sugjeruar nga OBSH e cila ndihmon në përpilimin me listat model të ilaceve)

¹⁰⁸ Shembuj se si duhet të bëhen përlllogaritjet na jepen shumë qartë në Shtojcën I. Metodatat për llogaritjen e sasisë e kërkesave përsubstancat e kontrolluara, në: Guide on Estimating Requirements for Substances under International Control Developed by the International Narcotics Control Board and the World Health Organization for use by Competent National Authorities

https://www.incb.org/documents/Narcotic-Drugs/Guidelines/estimating_requirements/NAR_Guide_on_Estimating_EN_Ebook.pdf

¹⁰⁹<https://www.gov.uk/> – është faqja zyrtare e qeverisë së Britanisë së Madhe e cila shfrytëzohet për të dhënë shërbime dhe informacione qeveritare. Në faqen e njëjtë mund të gjejmë sqarime të ndryshme lidhur me marrjen e licencave për kultivimin e kanabisit brenda kufijve për Britaninë e Madhe.

dhe për dokumentacionin e nevojshëm, një ndër këta guida është publikuar në Mars të vitit 2021¹¹⁰. Të drejtat për të dhënë licencën i takojnë Ministrisë së Brendshme. Për paraqitjen e kërkesës kultivuesi duhet të paguajë një shumë prej 580 paund sterlina, ndërsa karakteristike është se licencat jepen vetëm për një sezonë të mbjelljes dhe licenca duhet rinovuar përsëri duke ju nënshtruar një kontrolli të Shërbimit të Zbulimit dhe Ndalimit (DBS) për tu kualifikuar për të riaplikuar¹¹¹ me një pagesë të re prej 326 paund sterlina.

Agjencia Daneze e Barnave (DMA) është kompetente për të dhënë licencat për kultivimin e kanabisit për qëllime farmaceutike, karakteristikë është se për të pasur licencë patjetër duhet të jetë pëlqimi i policisë daneze që kultivuesit të jenë persona pa ndonjë precedent penal¹¹².

Bullgaria gjithashtu është kultivuese e kanabisit me përqindje të THC-së jo më të lartë se 0,2%, licencat i jep Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujrave ndërsa mbikqyrjen e bëjnë organet e Akti i Kontrollit të Subjekteve Narkotike dhe Prekursorëve (NSPCA). Dallimi nga vendet e tjera është afati i përgjigjes për lejen e licencës e cila për Britanin e Madhe dhe Danimarkën është vetëm 60 dite, për organet bullgare pritja është 90 ditore¹¹³

Edhe Rumania është shtet që ka legalizuar kultivimin e kanabisit për qëllime farmaceutike me THC të ulet, por që nuk ka kultivues vendas duke mirëpritur investitorë të huaj.

Sipas EMCDDA në një informacion të paraqitur për Italinë dhe Suedinë¹¹⁴ thuhet se: "Ligji Italian 242 i vitit 2016 thotë se kultivimi i variteteve të caktuara të bimëve të kërpit që përmbajnë më pak se 0.2% THC lejohet pa ndonjë licencë, dhe bimët mund të përdoren për të prodhuar produkte të ndryshme të specifikuar, përfshirë ushqimin dhe kozmetikën", por citon se prodhimet nga pjesët e bimës që përmbajnë THC të lartë nuk janë të lejuara¹¹⁵.

¹¹⁰https://assets.publishing.service.gov.uk/government/uploads/system/uploads/attachment_data/file/970326/Application_and_process_guide_-_Hemp_March_2021_v1.2.pdf

¹¹¹<https://straininsider.com/cannabis-growing-licence-eu/>

¹¹²<https://laegemiddelstyrelsen.dk/en/special/medicinal-cannabis/companies/pilot-programme/authorisation-to-produce-cannabis-intermediate-products/~media/7B4786439F7549C5AA470B248D1F5818.ashx>

¹¹³https://www.emcdda.europa.eu/news/2019/italy-and-sweden-court-decisions-low-thc-cannabis-products_en

¹¹⁴https://www.emcdda.europa.eu/news/2019/italy-and-sweden-court-decisions-low-thc-cannabis-products_en

¹¹⁵Po aty.

Republika e Maqedonisë së Veriut

Marrja e licencës për kultivimin e kanabisit për qëllime farmaceutike në Maqedonin e Veriut rregullohet me nenin 29-a të Ligjit për kontrollin e barnave narkotike dhe substancave psikotrope. Pëlqimi lëshohet nga Ministria e Shëndetësisë pasi më parë ka marrë pëlqimin nga Qeveria e Maqedonisë së Veriut. Subjekti juridik mund të jetë çdo person ose investitor që plotëson kushtet e parapara në këtë ligj, veçori e Maqedonisë së Veriut është se licencat nuk l ka të kufizuara vetëm për shtetasit e Maqedonisë së Veriut, por licencat mund të jepen edhe për shtetas të huaj me kushte të njëjta të cilat përcaktohen në këtë ligj. Në nenin 29-b të këtij ligji janë përcaktuar kushtet e para që duhet ti plotësojë personi juridik potencial është të ketë siguruar hapsirë, tokë të përshtatshme, ambiente të cilat plotësojnë kushtet për kultivimin, tharjen e prodhimit, personi juridik është i detyruar që hapësirën të cilën e ka zgjedhur për të kultivuar bimët duhet ta rrethojë me gardh të lartë minimalisht deri në 4 metra dhe me tela me gjëmba mbi gardh, gjithashtu personi juridik detyrohet që të siguroj të gjithë hapsirën me ndonjë kompani sigurimi me personel të specializuar me prani fizike dhe me kamera të cilat do të jenë aktive 24 orë. Ndërsa për personelin i cili do të jetë pjesë e kultivimit të bimës duhet patjetër të ketë siguruar një agronom i cili është i diplomuar dhe ka dhënë provime për kultivimin e kësaj bime (Maqedonia ka munges të këtij kuadri), një farmacist të diplomuar me më së paku tre vjet përvoj pune dhe një jurist i cili do të drejtoj punët juridike dhe një person tjetër për kryerjen e punëve të tjera shtesë. Për aplikimin e licencës kërkesa i drejtohet Ministrisë së Shëndetësisë, e cila duhet të përmbajë të dhëna të detajuar për aplikantin që do të thotë përveç informacioneve formale duhet që patjetër të dëshmojë me një dëshmi të marrë nga Gjykata se nuk është në ndjekje penale ose nuk është i proceduar penalisht. Nëse është shtetas i huaj nga Gjykata e Lartë e shtetit që ka shtetësinë dhe jeton, këtu ligjërisht bëhet klasifikimi i personave të cilët do të paraqiten si pronarë ose investitorë të personit juridik, krahas së cilës do të duhet të dëshmojnë edhe të hollat dhe dokumentacionin nga zyra taksative që është i pastër dhe i rregullt. Krahas informacionit personal për investitorin ose pronarin e personit juridik duhet patjetër të sjellë prova për hapsirën, nëse është e marrë me qira duhet kontrata e qirasë e noterizuar, nëse është pronar i tokës, fletëpronësinë që dëshmon faktin e tillë, planin e rritjes së bimës. Për kontrollimin e kësaj kërkesë formohet një komision me

dy përfaqësues nga Ministria e Shëndetësisë, një përfaqësues nga Ministria e Buqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujrave, një përfaqësues nga Agjencia e barnave dhe pajisjeve mjekësore dhe një specialist për bimët medicinale¹¹⁶ Ndryshe nga vendet evropiane Maqedonia e Veriut përgjigjen e kërkesës e kthen në një afat kohor prej 30 ditësh. Puna e komisionit ndahet si vijon: Ministria e Shëndetësisë në bashkëpunim me Agjencionin e barërave dhe pajisjeve mjekësore specialistin për njohjen e barnave medicinale me pëlqimin e qeverisë vendos për kushtet e hapsirës, të pajisjeve mjekësore të cilat do të përdoren për rritjen e bimës¹¹⁷. Ndërsa Komisioni i përbashkët i përfaqësuesve të Ministrisë së Shëndetësisë, Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujrave, Agjencionit të barnave dhe specialitetit për njohjen e barnave medicinale mbikqyrë të gjithë punën e personit juridik dhe është i detyruar që dy herë gjatë një cikli të mbjelljes të bëjë kontroll në hapsirat e kultivimit, do të inspektojë dokumentacionin nëse raportimet e bëra nga subjekti juridik janë në përputhje me gjendjen momentale dhe të vendos nëse i plotëson ose jo kushtet për vazhdim të mëtutjeshëm. Licenca e lëshuar nga organet përkatëse me pëlqimin e qeverisë jepet vetëm për kultivimin e bimës së kanabisit për qëllime farmaceutike dhe vlen vetëm për persona juridik të licencuar dhe vetëm për kultivim vetëm për brenda kufijve të territorit të Maqedonisë së Veriut. Gjithashtu me këtë ligj është paraparë edhe nevoja për zgjerim e cila praqitet nga personi juridik i cili duhet që krahas licencës të cilën e ë posedon duhet të bëjë kërkesë të re e cila do të kalojë në po të njëjtat rregulla dhe do të vendoset për leje të zgjerimit.

7. Licenca e eksportit dhe importit të prodhimit

Eksporti dhe importi i narkotikëve (lulja e kanabisit e kultivuar, rrënjët, gjethet ose pjesë të tjera nga bima e kanabisit e kultivuar nga personat juridik të licencuar në bazë të Ligjit për kontrollin e barërave narkotike dhe substancave psikotrope deri në momentin para përpunimit është komponent narkotik) me Ligjin për kontrollin e barërave narkotike dhe substancave psikotrope

¹¹⁶Ligji për Kontrollin e Barnave Narkotike dhe Substancave Psikotrope ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 103/2008, 124/10, 164/13 dhe 149/15) ndryshuar në Shkurt të vitit 2016 publikuar në Gazetën Zyrtare të RMV numër 37. www.slvesnik.com.mk, Neni 29-b

¹¹⁷ Po aty. Neni 29-b

mund të eksportohet nën masa të rrepta sigurie duke lëshuar raport për eksportimin në personin tjetër juridik të licencuar (personin juridik për prodhimin e produkteve mjekësore, veterinarë dhe shkencore), dhe me pjesëmarrjen e organeve të policisë ose kompanisë së sigurimit kryhet importi eksporti i bimës narkotike vetëm brenda territorit të Maqedonisë së Veriut, ndërsa importi ose eksporti jashta kufijve të territorit të Republikës së Maqedonisë së Veriut paraqet veper penale e cila do të ndëshkohet sipas nenit 215 të Kodit Penal të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Ndërsa eksporti dhe importi ndërkombëtar i kanabisit të përpunuar dhe të cilësuar si produkt medicinal me THC të ulët i miratuar me listat ndërkombëtare të barërave mjekësore, rregullohet sipas Konventës Ndërkombëtare të Barnave. Dy shtete që kryejnë eksport-importin duhet të posedojnë leje të veçanta ligjore të miratuara nga juridiksonet e dy shteteve dhe një marrëveshje midis kompanive për produktet e eksportuara-importuara të cilat duhet të jenë të licencuara dhe klasifikuara sipas listës së barnave të Konventave Ndërkombëtare të barnave. Juridiksonet për rregullat e tilla mvaren nga ligjet shtetërore, disa shtete janë më të ashpra dhe disa më të buta. Tregtia ndërkombëtare rregullohet nga traktatet e KB për Kontrollin e Barnave (tre-thelbësore), dhe veçanërisht nga ligji ndërkombëtar i tregëtisë dhe investimeve¹¹⁸.

Ndërsa Eksporti dhe importi i produkteve mjekësore, veterinarë dhe shkencore është i lejuar të hyjë brenda ose të dalë nga kufijt e Republikës së Maqedonisë, në bazë të listave të miratuara nga Ministria e Shëndetësisë, nëpër vendkalimet kufitare të caktuara nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut, me kërkesë nga Ministria e Shëndetësisë në bazë të lejes së lëshuar nga Agjencioni i barnave dhe Pajisjeve. Forma e licencës përcaktohet nga Ministria e Shëndetësisë e cila duhet të përmbajë numrin dhe datën e importit me të cilat konfirmohet së importi lejohet në bazë të nenit 51 të Ligjit për kontrollin e barnave narkotike dhe substancave psikotrope¹¹⁹. Personat juridike të licencuar dërgesës që duhet të eksportohet nga R.M.V çdo dërgesë duhet ti bashkangjisë kopje të vërtetuar të licencës dhe lejen e organit i cili e

¹¹⁸<https://cannabossom.com/all-you-need-to-know-about-import-and-export-of-cannabis/>

¹¹⁹Ligji për Kontrollin e Barnave Narkotike dhe Substancave Psikotrope ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 103/2008, 124/10, 164/13 dhe 149/15) ndryshuar në Shkurt të vitit 2016 publikuar në Gazetën Zyrtare të RMV numër 37. www.slvesnik.com.mk, Neni 51.

ka miratuar eksportin,dokumentet e udhëtimit siç është fatura ,fletë dërgesa ose dokumentet e transportite cila duhet të përmbajë emrin e substancës ose bimës si në listë dhe emrin tregëtar,selia e importuesit dhe eskportuesit ,sasi të e ekportuara dhe sasi të importuara nga R.M.V¹²⁰.Ndalohet eksportimi i dërgesave të substancave dhe bimëve nga Republika e Maqedonisëklasifikuar në listat II dhe III dhe përgatitjet e tyre, përveç nëse vendi i ciliimportuesi nuk konfirmon në lejen e importit që një dërgesë e tillë ishte e lejuar¹²¹

¹²⁰Ligji për Kontrollin e Barnave Narkotike dhe Substancave Psikotrope("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 103/2008, 124/10, 164/13 dhe 149/15) I ndryshuar në shkurt të vitit 2016 të publikuar në Gazetën Zyrtare të RMV numer 37. www.slvesnik.com.mk ,Neni 53.

¹²¹ Po aty,Neni 54.

Kapitulli III-të

Rregullimi i veprimtarive me barna narkotik

1. Veprimtaria në institucionet shëndetësore

Shkenca mjeksore, duke përfshire mjekët, dentistët, veterinarët dhe punonjës të tjerë të kujdesit shëndetësor që kanë qasje të drejtperdrejt në dhënien dhe shkrimin e recetave të barnave narkotik pasi vërtetuan vetit shëruese të kanabisit tek pacientet për një numër të konsiderueshëm sëmundjesh, pavarësisht konventave për ndalimin e përdorimit të kanabisit dhe cilësimin e tij si një drogë psikoaktive, ata lobuan nëpër botë për përdorimin e barnave mjeksore me përmbajtje të kanabisit me THC të ulët. Rregullimi i terapisë me produkte narkotike është i rregulluar në mënyra të ndryshme në bazë të legjisllacioneve vetijake të brendshme të shteteve. Në Amerikë rregullimi i terapisë me kanabis është një kompleks shtet që kanë marrë përsipër legalizimin e terapisë nga bima e kanabisit nuk janë në harmoni dhe përputhje me Ligjin Federal i cili e dënon përdorimin e kanabisit, ndërsa disa shtete kanë lejuar përdorimin e barnave mjeksore me përmbajtje të kanabisit dhe gjithashtu një numër i madh i tyre kanë legalizuar plotësisht kanabisin dhe shumë të tjera janë duke ndjekur politikën e njëjta¹²². Ndërsa për Evropën shtetet janë të pavaruar të vendosin për përdorimin e produkteve mjeksore të kanabisit edhe pse janë zbatues të Konventave të cilat ndalojnë rreptësisht ndalimin e marihuanës. Holanda është shteti i cili ka një përdorim më të gjatë të produkteve mjeksore të kanabisit, kompania holandeze „Bedrocan”, është prodhuesi më i madh i produkteve mjeksore të licencuar nga autoritetet holandeze¹²³. Gjermania dhe Britania e Madhe gjithashtu janë konsumues të produkteve mjeksore të kanabisit nga e njëjta kompani. Vetëm për shtetin e Italisë produktet Bedrocan transportuan 280 kg,¹²⁴ sipas të njëjtit raport të EMCDDA të vitit 2019 në Itali kurohen nga 9.000 deri në 10.000 persona me produkte mjeksore të kanabisit. Nuk ka ndonjë ligj të veçantë rreth përdorimit të produkteve mjeksore të kanabisit, ato lejohen për pacientet të cilësuar me sëmundje të rënda, mund të blihen në farmaci për të lehtësuar

¹²²<https://www.ncbi.nlm.nih.gov/pmc/articles/PMC5312634/>

¹²³<https://bedrocan.com/>

¹²⁴https://www.emcdda.europa.eu/system/files/publications/10171/20185584_TD0618186ENN_PDF.pdf

dhimbjet e tyre pa mbeshtje financiare nga sigurimi shëndetësor. Irlanda Veriore (MB) raporton prevalencën më të lartë vjetore të opioideve me recetë kudo në botë me 8.4 përqind¹²⁵.

Barnat narkotike dhe substancat psikotrope të prodhuara në formë të ilaceve, janë nën kontrollet e ligjeve ndërkombëtare, kryesisht nga Organizata Botërore e Shëndetësisë e cila nga afër jep udhëzime dhe raporte mbi këto medikamente. Konventa e vetme e vitit 1961 dhe Protokollin I saj në 1971 si dhe Konventa për Substancat Psikotrope 1972, parashikojnë detyrimin e dyfishtë të qeverive për të vendosë një sistem kontrolli që siguron disponueshmërinë e duhur të substancave të kontrolluara për qëllime mjekësore dhe shkencore, duke parandaluar njëkohësisht abuzimin, devijimin dhe trafikimin "¹²⁶.

Në Republikën e Maqedonisë së Veriut barnat narkotike mund të përshkruhen vetëm me recetë të mjekut, i cili do të mbajë përgjegjësi penale nëse tejkalon dozën e caktuar nga Agjencioni i barnave dhe Pajisjeve mjekësore në përputhje me dispozitat ndërkombëtare të caktuara nga Organizata Botërore e Shëndetësisë. OBSH gjithashtu ndihmon me udhëzime dhe trajnime speciale të mjekëve se si të mos bien pre e mashtrimeve të personave të cilët insistojnë për shkruarjen e këtyre recetave, ato duhet të tregojnë një kujdes të veçantë për kategorinë e përzgjedhur të pacientëve, opiadet lëshohen nga mjeku specialist vetëm kur pacienti ka kaluar nëpër disa faza të para me medikamente më të lehta, kur dhimbja fillon të jetë e pakontrollueshme atëherë shkruan recetën për opiadet. Mjekët detyrohen që këto receta të lëshohen vetëm personave të cilët konstatojnë se kanë vërtet nevojë për një dozë të caktuar të këtyre produkteve. Sipas nenit 41 të Ligjit për kontrollin e barnave narkotike dhe substancave psikotrope, mjekët specialistë të përgjithshëm, mjekët specialistë familjarë mund të përshkruajnë pacienteve receta të barnave me përmabjete të THC, dronabinol ose nabinol vetëm me rekomandimin e një specialisti në neurologji, onkologji dhe radioterapi dhe sëmundje

¹²⁵ The non-medical use of prescription drugs Policy direction issues Discussion Paper United Nations New York 2011

<https://www.unodc.org/documents/drug-prevention-and-treatment/nonmedical-use-prescription-drugs.pdf>

¹²⁶ Konventa për substancat psikotrope 1961 dhe Protokollin I saj në 1971, https://www.unodc.org/pdf/convention_1971_en.pdf

infektive i cili është i punësuar në një institucion shëndetësor publik në spital¹²⁷,përshkrimi i këtyre produkteve patjetër që para se të pranohet si ilaç nga pacienti mjeku duhet të ketë edhe një deklaratë pëlqimi nga ana e pacientit të cilit duhet ti shpjegohet rreth përmbajtjes së produktit, si dhe efekteve anësore.Shkrimi i këtyre recetave është përcaktuar me ligj që tju shërbejnë vetëm pacientëve me sëmundje të rënda malinje,për njerëz të infektuar me HIV,për sëmundjet e sklerozës dhe për fëmijët ligjerisht rekomandohet vetëm në rastet shumë të rënda me sëmundje epileptike.Rregullimi i formës dhe përshkrimi i recetës bëhet nga Ministria e Shëndetësisë.Disa shtete siç është Izraeli,dozën e këtyre barnave e cakton mjeku në bazë të studimit të vet mbi sëmundjen e pacientëve dhe produkti sigurohet nga sigurimet shëndetësore.Ligji për kontrollin e barnave narkotike dhe substancave psikotrope në Maqedonin e Veriut ndalon rreptësisht përshkrimin e receteva dhe përdorimin e këtyre barnave për personat nën moshën 18 vjec dhe personat me çrregullime mendore¹²⁸.Kirurgët dentar,mjekët specialistë dhe mamitë mund të zotërojnë për kontrollimin e dhimbjeve tek pacientët e tyre në përputhje me rregullat e dhëna nga Ministria e Shëndetësisë.Kroacia ka një përshkrim recetë në të cilën duhet të shënohet shuma e THC,numri i dozave individuale,dozimi dhe mënyra e përdorimit,llojin e ilaçeve bimore dhe përgatitjen bimore¹²⁹,trajtimi i të cilave është me një afat prej 30 ditësh dhe jo më shumë se 7.5 gram¹³⁰.

2. Veprimtaria për qëllime të hulumtimeve mjekësore dhe shkencore

Kërkimet shkencore dhe mjekësore kanë një rol tejet të rëndësishëm për çdo lëndë të çfarëdo lloj shkencë,qofshin ato të ndara veç e veç ose të paraqitura si tërësi.Kërkimet shkencore dhe mjekësore mbështeten fort nga të gjithë juridiksionet ndërkombëtare,sepse ato i japin vërtetësinë produktit ose lëndës e cila mund të hidhet në treg.Hulumtimet shkencore dhe mjekësore për bimën e kanabisit gjithashtu kanë një përkrahje të madhe të vazhdueshme.Adminsitrata e Ushqimit dhe Barnave në Shtete e Bashkuara të Amerikës (FDA)jep një mbështetje të madhe shkencës rreth hulumtimit të kanabisit për përdorim

¹²⁷Ligji për Kontrollin e Barnave Narkotike dhe Substancave Psikotrope("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 103/2008, 124/10, 164/13 dhe 149/15) ndryshuar në Shkurt të vitit 2016 publikuar në Gazetën Zyrtare të RMV numër 37. www.slvesnik.com.mk , Neni 41

¹²⁸Po aty, Neni 41.

¹²⁹<https://www.drugsandalcohol.ie/27071/1/TD0217210ENN.pdf>

¹³⁰Po aty.

mjekësor. Për të kryer hulumtime shkencore, klinikat mjekësoro-shkencore duhet të pajisen me një licencë të lëshuar nga organet e Administratës së Ushqimit dhe Barnave në SHBA e cila aprohet nga Administrata së Zbatimit të Drogës (DEA) nën udhëzimet e Aktit të Substancave të Kontrolluara i vitit 1970, të cilat bashkëveprojnë me disa agjenci federale¹³¹, për shembull Programi i Furnizimit me Drogë i Institutit Kombëtar të Abuzimit me Drogat (NIDA) ofron marihuanë të nivelit kërkimor për studim shkencor¹³². Administrata e Zbatimit të Drogës (DEA) është organi i më i lartë për mbikqyrjen dhe dhënien e lejes për bashkëpunime të tilla, ajo rregullon kontrollin mbi prodhimin dhe shpërndarjen e produkteve farmaceutike të listuara përmes Divizionit të Kontrollit të Devijimit të DEA-së¹³³. Të njëjtat rregulla vlejnë edhe për produktet mjekësore të kanabisit për kafshët. Në Evropë hulumtimet shkencore të kanabisit për përdorim mjekësor, mbështeten nga Komisioni Evropian, ndërsa hulumtimi i pavarur i shteteve është i rregulluar sipas ligjeve të vet shteteve, të mbështetura në udhëzimet e Komisionit Evropian nën udhëheqjen e Akteve, Protokolleve, Konventave të ndryshme mbarëkombëtare, të kontrolluara poashtu nga Ministria e Drejtësisë në bashkëpunim me udhëzimet e Ministrisë të Shëndetësisë duke ndjekur rregulloret ndërkombëtare mbi selektimin e Drogave. Komiteti Shkencor për Sigurinë e Konsumatorit (SCCS), Komiteti Shkencor për Shëndetin dhe Rreziqet Mjedisore (SCHER) dhe Komiteti Shkencor për Rreziqet e Shëndetit në Shfaqje dhe Sapo Identifikuar (SCENIHR) kanë miratuar më shumë se një mijë mendime shkencore, shumica prej të cilave kanë shërbyer si bazë për rregulloret, duke kontribuar në një politikëbërje më të bazuar në prova të BE-së¹³⁴. Në Maqedonin e Veriut hulumtimet shkencore-mjeksore me produktet mjeksore nga kanabisi janë të rregulluara me nenet 68 dhe 69 të Ligjit për kontrollin e barnave narkotik dhe substancave psikotrope¹³⁵, të cilët u lejojnë institucioneve mjekësore dhe shkencore të rrisin, prodhojnë, importojnë bimë nga listat e klasifikuara, me leje nga Agjencia e Barnave dhe pajisjeve mjekësore, me detyrim që të mbajnë evidencë për çdo etapë të

¹³¹<https://www.fda.gov/news-events/public-health-focus/fda-and-cannabis-research-and-drug-approval-process>

¹³²NIDA Instituti Kombëtar i Abuzimit me Droga

<https://www.drugabuse.gov/research/research-data-measures-resources/nida-drug-supply-program>

¹³³<https://www.dea.gov/what-we-do>

¹³⁴https://ec.europa.eu/health/newsletter/108/focus_newsletter_en.htm

¹³⁵Ligji për Kontrollin e Barnave Narkotike dhe Substancave Psikotrope ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 103/2008, 124/10, 164/13 dhe 149/15) ndryshuar në Shkurt të vitit 2016 publikuar në Gazetën Zyrtare të RMV numër 37. www.slvesnik.com.mk, Neni 68, Neni 69

zhvillimit të tyre dhe kërkimeve shkencore dhe mjekësore të tyre,si dhe rezultatet përfundimtare që duhet ti publikojnë dhe ti paraqesin pranë organeve kompetentë,me qellim që të realizojnë një figurë sa më të pastër të kërkimeve të tyre.Agjensioni i barnave dhe pajisjeve mjeksore lëshon licencat për klinikat shkencore duke u kërkuar që të paraqesin fakte të forta të cilat duhet të aprovohen nga Ministria e Shëndetësisë në bashkëpunim me Ministrin e Punëve të Brendshme,Ministrinë e Drejtësisë,Ministrinë e Ambientit dhe disa Ministri të tjera.Produkti ofrohet dhe mbikqyret nga Ministria e Punëve të Brendshme nën rregulla të rrepta të sigurisë,klinikat shkencore-mjeksore janë të detyruara të mbajnë regjistrime dhe raporte të detajuara mbi kërkimet shkencore.Raportet e mbledhura duhet të dorezohen nëpër institucionet përkatëse të cilat më pas do të përpilojnë statistika dhe të dhëna vjetore të cilat janë të detyruara ti paraqesin pranë Organizatës Botërore të Shëndetësisë dhe Zyrës për Kontrollimin e Drogave.

3. Evidentimi i narkotikeve

Evidentimi i narkotikëve ka një procedurë të veçantë për regjistrimin e barnave narkotike të cilat kërkojnë lëshimin e tyre nëtreg,pikë së pari duhet të jenë të licencuar dhe të kalojnë përmes një kontrolli nga autoritetet shëndetësore kompetente,ky kontroll ka të bëjë me cilësinë dhe sigurinë e produktit e cila lidhet me shëndetin e pacientëve.Nevoja për barna narkotike ka shtyrë bashkëpunime midis shteteve prodhuese dhe atyre blerëse.Kompanit juridike të licencuara për prodhimet e narkotikeve duhet ta vërtetojnë produktin e tyre me prova të forta mbi efikasitetin dhe sigurinë e narkotikut,duke u zotëruar se do të mbajë përgjegjësi për prodhimin i cili do të dalë në treg me kushtet të aprovuara mbi çmimin i cili luan një rol tepër të rëndësishëm,marketingun dhe përdorimin e saj,e cila do të përmblihet në një deklaratë lëshuar autoriteteve shëndetësore të shtetit përkatës, kompetente për kontrollimin e tregut,shpërdarjes dhe përdoruesve.Duke pasur parasysh interesin dhe rritjen e numrit të kompanive prodhuese të barnave narkotike,Organizata Botërore e Shëndetësisë me ndihmën e ekspertëve duke iu përmbajtur kërkesave të Komisionit për Droga Narkotike përpiloj një listë

model me 300 ilaçe nga të cilat 30 ishin ato psikoaktive¹³⁶, nga të cilat bëhet përzgjedhja se cilat barna janë të sigurta për përdoruesin duke i dhënë një rëndësi tepër të veçantë varësisë të produktit. Pra OBSH ka rolin e një kontrollori mbarëkombëtar i cili faktikisht vendos rregulla dhe orienton shtetet me anë të raporteve dhe udhëzimeve se cilat produkte do të lejohen të futen në treg. Për regjistrimin e një bari narkotik kompanitë prodhuese janë të detyruara që të posedojnë specifikacione të veçanta dhe tu përbahen rregullave të çertifikimit të OBSH me informacione në lidhje me kualitetin, qëndrueshmërinë, përbërjen dhe sasinë e substancave kimike, farmaceutike, farmakologjile dhe toksike të cilat i përmban produkti, dhe gjithashtu të sigurojnë importimin e tyre kombëtar dhe ndërkombëtar. Shtetet vendosin vet se me cilat shtete prodhuese do të bashkëpunojnë në blerjen e këtyre produkteve duke pasur parasysh cilësinë e garantuar nga specifikacionet e paraqitura në OBSH, klimën e vendit, analizat e detajuara dhe përqindjen e përgjegjësisë së kompanisë juridike të licencuar në lidhje me varësinë dhe cilësinë e produktit. Në bazë të përqindjes të nevojës së pacientëve, kualifikimeve mjeksore, përgatitjes profesionale të farmacistëve për shitjen e këtyre barnave, Ministria e Shëndetësisë vendos për sasinë vjetore të banave narkotike. Regjistrimi i produktit kalon nëpër disa faza të cilat duhet të zbatohen nga subjektet juridike të licencuara, siç u cek edhe më lartë plotësimi i formularit mbi cilësinë dhe sigurinë e produktit është faza fillestare, kontrollin e së cilës e bën Instituti Shëndetësor Publik i Republikës së Maqedonisë së Veriut, më pas ky kontroll pasohet me fazën dytë e cila është faza e përzgjedhjes së produktit nga ana e komisioneve të ngritura nga Agjencioni i barnave dhe pajisjeve mjekësore, Instituti i Shëndetit Publik për Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe Ministria e Shëndetësisë në bazë të rregullave ndërkombëtare të përcaktuara nga OBSH¹³⁷. Nëse produkti i plotëson të gjitha kriteriumet atëherë lëshohet një çertifikatë regjistrimi e cila publikohet në gazetën zyrtare me të gjitha të dhënat: emrin, përmbajtjen, përdorimin, prodhuesin, distributorin për aprovimin e produktit që

¹³⁶Guidelines for the Control of Narcotic and Psychotropic Substances In the context of the international treaties by Professor Bror Rexed International Narcotics Control Board Vienna, Austria Dr K. Edmondson Department of Health Canberra, Australia Dr Inayat Khan Division of Mental Health World Health Organization Geneva, Switzerland Mr Robert J. Samsom Health Protection Branch Ministry of Welfare, Health and Cultural Affairs Leidschendam, Netherlands WORLD HEALTH ORGANIZATION GENEVA 1984.

https://apps.who.int/iris/bitstream/handle/10665/39299/9241541725_eng.pdf?sequence=1

¹³⁷Ligji për Kontrollin e Barnave Narkotike dhe Substancave Psikotrope ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 103/2008, 124/10, 164/13 dhe 149/15) I ndryshuar në shkurt të vitit 2016 të publikuar në Gazetën Zyrtare të RMV numer 37. www.slvesnik.com.mk

mund të lëshohet në treg.Regjistrimi me të gjitha të dhënat duke potencuar prodhuesin në gazetën zyrtare ka një rëndësi të jashtëzakonshme për përdoruesit sepse shumë shtete me ekonomi të dobët nuk mund të përballojnë kostot e prodhimit të këtyre barnave brenda territoreve të tyre dhe në pamundësi të plotësimit të kushteve për blerjen e produktit nga shtetet prodhuese që padiskutim kanë një fuqi të madhe ekonomike të cilat garantojnë një cilësi dhe siguri mbi produktin atëherë publikojnë prodhime të njëjta të cilat nuk kanë sigurinë e duhur për përdoruesit.Faza e fundit është faza pasi është aprovuar produkti duhet të lëshohet në përdorim vetëm me miratimin e komisioneve të spitaleve kombëtare të cilat pasi kanë kryer provat e nevojshme japin mendimin pozitiv mbi lëshimin e produktit nëpër farmacitë vendase.Për Maqedonin e Veriut – barnat nga produktet e kanabisit do të lëshohen në përdorim vetëm me autorizimin e mjekut specialist nëpërmjet recetës.Farmacitë të cilat do të lëshojnë një produkt të tillë duhet të vërtetohen nëpërmjet recetës së lëshuar nga mjeku specialist dhe të evidentohen të dhënat personale të pacientit që përdor terapinë I cili duhet të jetë vetë present ose nëse pacienti për shkak të gjendjes së rëndë të tij nuk mund të jetë present atëherë personi i cili do të kërkojë produktin në farmaci do të regjistrohet gjithashtu me të gjitha të dhënat personale në emër të kujt e merr produktin medicinal në Librin e veçantë të Narkotikëve¹³⁸,në të kundërtën për personat të cilat do të kryejnë veprime të kundërligjshëm do të parashikohet vepër penale dhe sanksione kundërvajtëse.Substancat narkotike të evidentuara në listat e barnave nga Agjencioni i barnave dhe pajisjeve mjekësore evidentohen dhe rregullohen në bazë të nenit 78 të Ligjit për kontrollin e barnave narkotik dhe substancave psikotrope,I cili përcakton se evidentimi ose regjistrimi i narkotikëve bëhet nga personat e licencuar juridik në bazë të këtij ligji të cilat të dhëna duhet ti paraqiten organit shtetëror nëbazë të udhëzimeve të dhëna nga Ministria e Buqësisë,Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujrave,së paku një herë në vit¹³⁹.

¹³⁸Ligji për Kontrollin e Barnave Narkotike dhe Substancave Psikotrope("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 103/2008, 124/10, 164/13 dhe 149/15) i ndryshuar në Shkurt të vitit 2016 të publikuar në Gazetën Zyrtare të RMV numer 37. www.slvesnik.com.mk

¹³⁹ Po aty, Neni 78

4. Raportimi mbi veprimtarinë me narkotik

Jane dy nene të rëndësishme, neni i 16 i Konventës për Substancat Psikotrope dhe neni 18 i Konventës së Vetme mbi Narkotike 1961 të cilat ngarkojnë palët, pra shtetet që të raportojnë mbi efektete anësore negative dhe varësinë e barnave narkotike tek pacientët. Këto dy Konventa gjithashtu ngarkojnë OBSH-në për mbajtjen e përgjegjësisë rreth produkteve të lëshuara nga listat model, të përpiluara me ndihmën e ekspertëve sipas saj¹⁴⁰. Raportimi mbi efektet anësore dhe ecurinë e produktit ka një rëndësi tejet të madhe pasi me anë të raportimeve vijmë deri tek konkluzionet përfundimtare rreth cilësisë dhe sigurisë së tyre për shëndetin e njerëzve. OBSH-së stimulon shtetet që të kenë sa më shumë raportime të tilla. Raportimi i mjekëve dhe dentistëve në rangje kombëtare për efektet anësore të ilaçit në disa shtete është një urdhër ligjor, ligji detyron mjekët që të japin raporte në regjistrat e tyre mbi gjendjen dhe ecurinë e produktit të ri të hedhur në Zyrën për kontrollin e ilaçeve. Raportimi për efektet anësore bëhet me anë të formularëve të cilat lëshohen nga ana e mjekut ose dentistit në zyrën për kontrollimin e ilaçeve ose agjencionet e barnave. Raportimi i efekteve anësore shoqërohet me pikë ekskluzive dhe me shpërblime motivuese për mjekët, të cilët mbajnë evidenca të tilla mbi produktet që i rekomandojnë tek pacientet dhe shohin më nga afër ecurinë e tyre, prandaj këto raportime vlerësohen dhe çmohen shumë. Më pas Zyra e veçantë për Kontrollin e Ilaceve informacionet e grumbulluara i punon në dosje dhe me anë të përfaqësuesve nga Ministria e Shëndetësisë këto raportime i grumbullojnë dhe i paraqesin para OBSH-së. Sipas këtyre raportimeve, OBSH mund të vlerësojë rreziqet dhe përfitimet në përdorimin e substancës si ilaç dhe të raportojë Komisionin për Barna Narkotike¹⁴¹ i cili jep vendime për ecurinë e mëtutjeshme të barnave narkotike. Të gjitha shtetet të cilat kanë legalizuar marihuanën për qëllime mjeksore OBSH-ja i udhëzon nëpërmjet raportimeve të ndryshme që i publikon me statistika dhe mendime shkencore, të cilat do tju shërbejnë shteteve

¹⁴⁰ Konventa e vetme mbi Narkotike 1961

<https://undocs.org/en/ST/CND/1/Add.1/Rev.7>

¹⁴¹ Guidelines for the Control of Narcotic and Psychotropic Substances In the context of the international treaties by B. Rexed International Narcotics Control Board Vienna, Austria K. Edmondson Department of Health Canberra, Australia I. Khan Division of Mental Health World Health Organization Geneva, Switzerland R. J. Samsom Health Protection Branch Ministry of Welfare, Health and Cultural Affairs Leidschendam, Netherlands WORLD HEALTH ORGANIZATION GENEVA 1984.

https://apps.who.int/iris/bitstream/handle/10665/39299/9241541725_eng.pdf?sequence=1

për të përmisuar juridiksionet e tyre mbi legalizimin e kanabisit,për të analizuar përfitimet financiar gjithashtu për të hyre në hulumtime të reja rreth bimës së kanabisit.

Gjithashtu edhe raportimi i të gjithë procesit të prodhimit të marihuanës është i detyrueshëm për të gjithë personat juridik të licencuar në bazë të Ligjit për Kontrollin e Lëndëve Narkotike dhe Substancave Psikotrope.Personat juridik janë të obliguar që të raportojnë me anë të deklaratave të tyre për çdo veprim të cilin do ta ndërmarrin,me qëllim që të vendojnë në dije Komsionin Ndërsektorial.Meqë në Maqedonin e Veriut prodhimi i farave të kanabisit nuk është i lejuar,subjektet juridike duhet të blejnë farën e marihuanës tek persona juridik të licencuar nga vende të licencuara,të cilat licenca do ti paraqesin në dokumentacionet e pranimit nga ana e subjektit juridik në Republikën e Maqedonis së Veriut.Raportimi fillon nga 15 ditë para porositjes së farës,tek i cili do të deklaroj se personi juridik ka nevojë për mbjellje të farave të reja¹⁴².Më pas vazhdon me procedurën e përgatitjes së dokumentave për pranimin e fares, e cila është një procedurë e gjatë dhe e kontrolluar mirë,veprimi i parë që ndërmerret pas raportimit është përpilimi i kontratës me një kompani shpedicioni e cila është e licencuar dhe ka kushte të veçanta për pranimin e farave të kanabisit.Shpedicioni ka për detyrë të hapë një dosje ndërkombëtare nëpërmjet sistemit online dhe ka për qëllim njoftimin e doganave të tjera për pritjen e farave me qëllim që të vërtetojë ekzistencën e kompanisë së licencuar në shtetin tonë për doganat e tjera ndërkombëtare.Personi juridik i licencuar përgatit një raport të mirëfillt me të cilën e njofton Agjencionin e barnave dhe pajisjeve mejsore me sektor të veçantë për lejet e tilla,për cfar do ti përdor këto fara,të cilës do ti bashkangjit edhe çertifikatën e origjinës të farës,kompaninë nga e cila ka bërë porosinë,licencën nga Ministria e Bujqësisë,Pylltarisë dhe Ekonimisë së Ujrave për lejimin e mbjelljes së farave,dhe licencën nga Ministria e Shëndetësisë për lejimin e rritjes së bimës.Agjencioni i barnave dhe pajisjeve mjekësore vendos për lejen e tillë e cila do të zgjase me nje afat kohor prej 90 ditësh¹⁴³.Personi juridik gjithashtu është i detyruar që të raportojë për pranimin e farave Ministrinë e Bujqësisë,Pylltarisë dhe Ekonimisë së Ujrave,Ministrinë e Shëndetësisë dhe Agjencionin e

¹⁴²Ligji për Kontrollin e Barnave Narkotike dhe Substancave Psikotrope("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 103/2008, 124/10, 164/13 dhe 149/15) ndryshuar në Shkurt të vitit 2016 publikuar në Gazetën Zyrtare të RMV numër 37. www.slvesnik.com.mk , Neni 29-v.

¹⁴³Po aty.

barnave dhe pajisjeve mjekësore,duke mos tejkaluar numrin e farave për të cilin ka marrë leje.Personi juridik i licencuar është i detyruar të raportojë Ministrinë e Shëndetësisë,Ministrisë së Bujqësisë,Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujrave dhe Agjencionin e barnave dhe pajisjeve mjeksore për përgatitjen e serave dhe mbjelljen e farave,në mënyrë të detajuar pastaj edhe procesin e zhvillimit të bimës,raporte të cilat duhet të tregojnë qartë sasinë e rrënjëve të mbjelluara,rrënjëve të rritura,rrënjëve të kalbura,dhe deri tek procesi i paketimit të prodhimit.Raportim i veçantë nevojitet për rrënjët të cilat janë kalbura ose farat të cilat nuk kanë plasur,rrënjët e kalbura duhet të ekzekutohen në një mënyrë të veçantë,para Komisionit i cili do të vij në vendndodhje për të konfirmuar ekzekutimin e tyre,e njëjta procedur ndodh edhe me pjesën tjetër e mbetur të bimës në fund të procesit zhvillimor¹⁴⁴.

5. Mbikëqyrja e narkotikëve

Nga Konventa e Vetme e Narkotikëve e vitit 1961, është formuar organi i pavarur për monitorimin e narkotikeve, më saktësisht monitoron shtetet që kanë legalizuar marihuanën dhe ndjek nga afër punën e tyre-Bordi Ndërkombetar i Kontrollit të Narkotikëve(INCB) dhe raporton çdo vit për zbatueshmërinë e Konventës së Kombeve të Bashkuara Kundër Trafikimit të Paligjshëm të Barnave Narkotike dhe Substancave Psikotorope e vitit 1988¹⁴⁵.Bordi Ndërkombëtar i Kontrollit të Narkotikëve me anë të përfaqësuesve të vet, kërkojnë nga të gjithë shtetet të cilat kanë legalizuar përdorimin e kanabisit për qëllime mjeksore që të marrin përsipër kontrollin e plotë procesin e prodhimit,sasinë dhe cilësinë e produktit pa u përpunuar,vlerësimet mjekësore të produktit i cili do të përpunohet për qëllime mjekësore dhe do të lëshohet në treg,plotësimin e kërkesës së tregut e cila duhet të jetë në raport me pacientët dhe popullsinë brenda territorit të caktuar,dhe gjithashtu me theks të veçantë kërkohet monitorimi në shpërndarjen e ilaçeve dhe kontrolli mbi përdoruesit dhe sidomos parandalimi i devijimit të këtyre substancave narkotike të paraqitura në listat përkatëse.Lëshimi i produktit në treg padyshim paraqet një rrezik për konsumuesin, nëse nuk ka një monitorim nga instutucionet shëndetësore kombëtare në bashkëpunim me OBSH-në.Shtetet kanë

¹⁴⁴Ligji për Kontrollin e Barnave Narkotike dhe Substancave Psikotorope("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 103/2008, 124/10, 164/13 dhe 149/15) ndryshuar në Shkurt të vitit 2016 publikuar në Gazetën Zyrtare të RMV numër 37. www.slvesnik.com.mk , Neni 29-g

¹⁴⁵<https://www.incb.org/incb/en/psychotropics/index.html>

legjitimuar regjistrat për mbajtjen e evidencave të efekteve anësore dhe vlerësimeve për një produkt. Këto regjistra janë të administruara nga Zyra për Kontrollin e ilaçeve. Monitorimi mbi kontrollin e narkotikëve kërkohet në mënyrë të detajuar dhe të specifikuar më së shumti për të kontrolluar përmbajtjen e THC-së, e cila nuk lejohet të jetë më shumë se 0,2% dhe në shumë pak vende 0,3% nëse rritet për fibra, kontrolli mbi farat e kanabisit nuk është aq i specifikuar sa është kontrolli përqendrimin e THC në bimë¹⁴⁶, sidomos këtë fenomen e vërejmë në legjislacionin e Portugalisë dhe Qipros, të cilat vëmendje të posaçme i kushtojnë përqendrimin të THC, ndërsa pranimi i farave të kanabisit për kultivim është shumë i lehtë për tu pranuar nga shtetet e tjera dhe nuk kërkon ndonjë procedurë të veçantë¹⁴⁷. Mbikqyrja e narkotikëve ndryshon nga vendi në vend, sipas ligjeve të miratuara në mënyrë të pavarur nga shtetet. Holanda është shteti i cili ka legalizuar përdorimin e kanabisit më se 40 vjet më parë dhe përqendrimi i saj në monitorimin e narkotikëve qëndron në shitjen ilegale të produktit apo bimës, nga kompanitë për klientelën e “njohur”, tejkalimi i sasisë dhe të marre në mënyrë ilegale është vepër penale dhe ndëshkohet shumë më rëndë se veprat e tjera. Holanda ka agjencinë e veçantë qeveritare të quajtur Zyra e Kanabisit Medicinal, e cila është mbledh të gjithë prodhimin e prodhuesve fermerë dhe me pas ajo vet bën shpërndarjen nëpër farmacitë që bëjnë shpërndarjen e medikamenteve të ndryshme për qëllime mjeksore, me përqendrim të ndryshëm të THC dhe CBD me një vlerë prej 45 euro për 5 gram¹⁴⁸, në bazë të nevojës së paraqitur në raport me popullsinë. Qendra Evropiane për Drogat dhe Varesinë nga Drogat detyron shtete të cilat kanë legalizuar produktet narkotike për qëllime mjekësore që të plotësojnë standardet kryesore të cilat janë: klasifikimi i popullsisë dhe raportimi në bazë të pacientëve të identifikuar në bazë të terapive medicinale të udhëzuara nga mjekët specialistë, identifikimi i detajuar i personave problematikë (përdoruesit ilegal dhe shpërndarësit), raportim mbi gjendjen e ecurisë dhe efektet anësore të barnave të lëshuara në treg, numrin e përgjithshëm dhe statistika të verifikuara nëse ka rritje ose zvogëlim të varësisë së popullatës duke përdorur këto produkte, efektet anësore të tyre dhe infeksionet e ndryshme, shteti duhet të mbajnë përgjegjësi dhe raporte për produktivitetin dhe cilësinë e

¹⁴⁶<https://www.emcdda.europa.eu/system/files/publications/4135/TD0217210ENN.pdf>

¹⁴⁷<https://www.drugsandalcohol.ie/27071/1/TD0217210ENN.pdf>

¹⁴⁸ Po aty.

kompanive, personave që i udhëheqin këto kompani (të cilët duhet të jenë të pastër pa precedime penale të mëparshëm), raportime të detajuara nga organet e policisë, si dhe raportime dhe bashkëpunim me doganat. Qendra Evropiane për Parandalimin dhe Kontrollin e Sëmundjeve (ECDC¹⁴⁹) është Agjencioni i Bashkimit Evropian i cili koordinon mbikëqyrjen e bazuar në raste të të gjitha rasteve të reja të infeksionit të raportuara të infeksioneve nga droga të mbartura në gjak në nivel evropian, duke përfshirë ato infeksione të cilat mund të transmetohen nëpërmjet shkëmbimit të pajisjeve të injektuese¹⁵⁰, e rëndësishme është kapja në fazën e parë të infeksioneve nga droga për parandalimin e tyre.

Për Maqedoninë e Veriut monitorimi i narkotikëve të prodhuara për qëllime mjeksore bëhet nga Komisioni Ndërsektorial me përbërje nga përfaqësues të disa ministrive duke pasur një rëndësi të veçantë përfaqësuesit e Ministrisë së Shëndetësisë në bashkëpunim me përfaqësuesit e Agjencionit të Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore të cilët nëpërmejt raportimeve të paraqitura nga kompanitë prodhuese verifikojnë prodhimin, sasinë dhe cilësinë. Gjithashtu në bazë të Ligjit mbi kontrollin e barnave narkotike dhe substancave psikotrope u formua një Komision i veçantë i emëruar si Qendra për Monitorimin e Barnave dhe varësia nga droga e cila në bazë të nenit 79, ka për obligim të monitorojë tre fusha kyçe dhe atë:

- Fushën shëndetësore e cila përfshin përdoruesit epidemiologjik, raportin e përdorimit të medikamenteve në bazë të popullsisë së përgjithshme, evidentimin e përdoruesve problematike, trajtimin e këtyre personave, rrezikun e vdekshmërisë lidhur me këto medikamente dhe sëmundjet infektive të lidhura me përdorimin e barnave narkotike.
- Të dhënat e policisë
- Dhe të dhënat e doganave¹⁵¹

¹⁴⁹ Agjencioni i Bashkimit Evropian, Qendra Evropiane për Parandalimin dhe Kontrollin e Sëmundjeve.
<https://www.ecdc.europa.eu/en>

¹⁵⁰ UDHËZUES I ECDC DHE EMCDDA Parandalimi dhe kontrolli i sëmundjeve infektive ndërmjet njerëzve të cilët injektojnë droga

https://www.emcdda.europa.eu/system/files/publications/638/EMCDDA_ECDC%20Guidance%20ALB.pdf

¹⁵¹ Ligji për Kontrollin e Barnave Narkotike dhe Substancave Psikotrope ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 103/2008, 124/10, 164/13 dhe 149/15) i ndryshuar në shkurt të vitit 2016 të publikuar në Gazetën Zyrtare të RMV numer 37. www.slvesnik.com.mk, Neni 79.

Pikëfillimi i ndërmarrjes së legalizimit të marihuanës për qëllime mjeksore është në rradhë të parë fusha shëndetësore, numri i lartë i pacienteve të cilët kanë nevojë të trajtohen me këto barna, në bazë të raporteve të paraqitura nga Agjencioni i barnave dhe pajisjeve mjekësore në bashkëpunim me Ministrin e Shëndetësisë, e cila këto shifra i përpjeston në bazë të numrit të popullsisë në vend, ndërmerr vendim për të paraqitur kërkesën në qeveri për të shqyrtuar mundësinë e legalizimit të marihuanës. Fusha shëndetësore është e lidhur drejtpërsëdrejti me raportimet në të vërtet analizën e reagimeve të pacientëve të cilët përdorin produktet narkotike, nëse ato do të kenë një varësi ose infeksion në gjak ose reagime të tjera negative do të paraqiten para Komisionit Ndërqeveritar nga Agjencioni i barnave dhe pajisjeve mjekësore, dhe do të merret vendim mbi vazhdimësinë e tyre ose ndërprerjen totale. Legalizimi i marihuanës për qëllime shëndetësore duke u ardhur në ndihmë pacientëve të cilët kanë nevojë për përdorimin e këtyre produkteve, gjithashtu është një risk ose rrezik për një pjesë tjetër të njerëzve përdorues të marihuanës dhe drogave të tjera të cilët mund të shfrytëzojnë terrenin për të ardhur më lehtë deri tek synimi i tyre. Prandaj monitorimi i shpërndarjes së këtyre produkteve është i pastjetërsueshëm dhe obligativ për shtetin e Maqedonisë së Veriut dhe të gjithë shtetet tjera në botë të cilat kanë legalizuar ose po synojnë të legalizojnë marihuanën për qëllime mjekësore. Narkomania edhe në Maqedonin e Veriut është një pikë e errët e cila sipas raportimeve të ndryshme kombëtare dhe ndërkombëtare çdo ditë e më shumë ka një përhapje më të gjerë. Blerja e produkteve narkotike sidomos barnave me rrezikshmëri më të lartë të varësisë pa një monitorim ose kontroll mbi blerësit është një lloj legalizimi për këto persona. Kujdes i veçantë u kushtohet recetave të lëshuara nga mjekët specialistë për pacientët ose shitjet e produkteve narkotike nëpër farmacit të cilat duhet të jenë të selektuara për persona të cilat kanë nevojë për një trajtim të tillë mjekësor, pasi që nëse këto barna narkotike nuk kanë një kontroll se kujt i shitën, shumë shpejt mund të bien në dorë të personave problematike të cilat mund të përdorin për qëllime të rishitjeve të tyre tek narkomanët ose të miturit. Grupet kriminale gjithashtu mund të përdorin personat të cilëve ju lejohet blerja e këtyre produkteve dhe në këtë rast monitorimi do të mund të kontrollojë sasinë e lejuar. Shpërndarja e këtyre produkteve duhet të jetë e bazuar mirë në një platformë e cila do

të evidentonte përdoruesit e vërtet, të cilët gjithashtu do të ishin në mbikqyrje për efektet anësore të këtyre produkteve.

Organet e policisë drejtohen nga Ministria e Punëve të Brendshme nga e cila del edhe Ligji për policinë dhe Ligji për kundërvajtje për prishjen e rendit publik dhe paqes¹⁵². Këto dy Ligje i japin të drejtë organeve të policisë të mbajnë evidencë mbi përdoruesit e drogës, të gjurmojnë, zbulojnë, vrojtijnë, trafikantët dhe grupet kriminale, këto të dhëna të paraqiten në Prokurorin Publikë e cila do të ngrite procedurën për ndjekje penale. Edhe pse nëpër raporte të ndryshme ndërkombetare të anti-drogës Maqedonia e Veriut paraqitet si një rrugë transitë e kalimit të mallrave ilegale pra drogës ajo përsëri ballafaqohet me një numër të lartë të përdoruesve të drogave të ndryshme në vet territorin e saj. Përfshirja e organeve të policisë dhe bashkëpunimi i saj nëpërmjet Ministrisë së Punëve të Brendshme me INTERPOL-in dhe EUROPOL-in dhe bashkëpunimi me organizatat të tjera botërore kundër krimit të organizuar dhe drogës, ndihmojnë në zbulimin e kriminalitetit të organizuar dhe trafikimit të drogës¹⁵³. Gjithashtu e drejta për ruajtjen e qetësisë dhe rendit publik i takon organeve të policisë, e cila ju jep të drejtë të sanksionojnë përdoruesit e marihuanës. Të dhënat e Policisë janë të dhënat më të rëndësishme për identifikimin e personave problematike përdorues ose shpërndares të lendeve narkotike. Policia, duke vepruar në parandalimin dhe zbulimin e krimit i ofron prokurorit publik dhe gjykatës material të nevojshëm për fillimin e procedurës penale, gjatë zhvillimit të procedurës penale ofron ndihmë kriminalistike lidhur me identifikimin e personave dhe sendeve, ofron ndihmë për ekzekutimin e vendimeve, jep të dhëna nga evidenca e caktuara etj.¹⁵⁴ Këto të dhëna mund të ndihmojnë dhe të paralajmërojnë mjekët dhe farmacistët për personat problematike, dhe gjithashtu edhe mjekët dhe farmacistët duhet të informojnë policinë për personat të cilët kërkojnë këto barna narkotike.

Duhet theksuar se subjektet juridike të licencuara janë të detyruara që në ambientet në të cilin rritet bima përveç kushteve të rrethimit, dhe krijimit të gardhit të pakalueshëm nga persona të ndryshëm, duhet patjetër të posedojnë roje me pjesëmarrje fizike 24/7 gjatë të

¹⁵²<https://www.osce.org/files/f/documents/1/2/23807.pdf>

¹⁵³<https://mvr.gov.mk/page/europol>

¹⁵⁴ E. Sahiti & I. Zejneli, E drejta e procedurës Penale e Republikës së Maqedonisë, Shkup 2007 fq.93-94

gjithë kohës i cili do të mbajë evidencë të posaçme për të gjithë hyrjet dhe daljet e të gjithë personave qofshin ato personat e punësuar ose vizitor në ambijentet e rrethuara¹⁵⁵.Roja duhet të ketë portën e veçantë i cili do të sigurojë që dera kryesore të jetë gjithmonë mbyllur dhe për ardhjen e ndonjë vizitori të jetë i lajmëruar nga personat kompetent të subjektit juridik,nga i cili do të kërkojë që të paraqes kartën e identitetit dhe arsyen e vizitës e cila do të evidentohet në librin për evidencë¹⁵⁶.Subjekti juridik i licencuar është i detyruar për arsye të sigurisë së lartë të lidhë marëveshje me kompani të posaçme të cilat menaxhojnë me sigurimin e objektit 24 orë gjatë gjithë kohës,dhe në të cilën duhet të posedojnë kamera aktive të regjistruara në të gjithë ambijentin e rrethuar,me qëllim që të mund të evidentohet ndonjë dalje e pakontrolluar.Këto pamje filmike të siguruara nga kamerat dhe evidenca e rojës mund të kërkohen në çdo kohë nga kontrollet e organeve të policisë,kur dyshohet se ka ndonjë parregullsi ose raportohet ndonjë e tillë.Pamjet filmike të pranuar nga organet e policisë mund të përdoren kundër subjektit juridik në rast të ndonjë procesi gjyqësor të ngritur kundër tij,ose personave kompetent të tij,gjithashtu këto pamje mund të përdoren nga subjekti juridik në mbrojtje të tij në rast të ndonjë procesi të ngritur gjyqësor.

¹⁵⁵Ligji për Kontrollin e Barnave Narkotike dhe Substancave Psikotrope("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 103/2008, 124/10, 164/13 dhe 149/15) ndryshuar në Shkurt të vitit 2016 publikuar në Gazetën Zyrtare të RMV numër 37. www.slvesnik.com.mk , Neni 29-b.

¹⁵⁶ Po aty, Neni 29-b

Kapitulli i IV-të

Parandalimi i kontrabandës me narkotikë

1. Autoritetet kompetente

Në bazë të Ligjit për Kontrollimin e Barnave Narkotike dhe Substancave Psikotrope Qeveria e Maqedonisë së Veriut solli vendimin për formimin e Komisionit Ndërsektorial i cili përbëhet nga perfaqësues të disa ministrive dhe atë: Ministrisë së Drejtësisë, Ministrisë së Punëve të Brendshme, Ministrisë së Shëndetësisë, Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujrave, Ministria e Vetëqeverisjes Lokale, Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor, Ministrisë për Punë të Jashtme, Ministrisë së Financave, Administrata Doganore, Agjencia për Rini dhe Sporte, Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, Ministria e Punës dhe Politikës Sociale¹⁵⁷. Ky Komision Ndërsektorial jep rekomandime dhe propozime për zbatimin e Konventës Ndërkombëtare për Kontrollin e Narkotikeve, ndihmon në rishikimin e ligjit, në periudha të ndryshme kohë pas kohe, përpilon strategji të mbikqyrjes së narkotikeve për parandalimin dhe abuzimin me to, të cilat i publikon, raporton për publikun mbi dëmet që i shkaktojnë narkotikët, përfaqësojnë Republikën e Maqedonisë së Veriut në organizatat ndërkombëtare, dhe shumë punë të tjera të cilat ju ngarkohen nga Qeveria e Maqedonisë së Veriut.

1.1 Funkcionet dhe raportimet

Secila Ministri ka funksionin përketes të caktuar në bazë të ligjit. Subjektet juridike janë të detyruara që të paraqesin raportet e veta për çfarëdo lloj veprimi që ndërmarrin në Ministrinë e Shëndetësisë e cila ka formuar sektorin e veçantë të mbikqyrjes me narkotikët. Ky sektor është përbërë nga një staf i profesionalizuar të cilët ndjekin nga afër punën e subjekteve juridike dhe mbajnë evidence të ndryshme mbi zhvillimin e produktit, që më pas me anë të këtyre evidencave të krijojnë statistika dhe raporte për Organizatën Botërore të

¹⁵⁷Ligji për Kontrollimin e Barnave Narkotike dhe Substancave Psikotrope ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 103/2008, 124/10, 164/13 dhe 149/15) I ndryshuar në shkurt të vitit 2016 të publikuar në Gazetën Zyrtare të RMV numer 37. www.slvesnik.com.mk, Neni 7.

Shëndetësisë.Ministria e Shëndetësisë me anë të Komisionit të veçante të formuar në bashkëpunim me Institucionet e tjera në bazë të Ligjit për Kontrollin e lëndëve narkotike dhe substancave psikotrope, i jep të drejtë pjestarëve të këtij Komisioni që të bëjnë kontrollimin e ambientit të subjektit juridik i cili është i licencuar për prodhimin e marihuanës,në çdo kohë dhe pa lajmërim,ato konstatojnë kushtet parësore të kompanisë e cila është e detyruar tu përmbahet rregullave të vendosura në Ligjin mbi kontrollin e lëndëve narkotike dhe substancave psikotrope të evidentuara në mënyrë të qartë nëpër disa nene të veçanta,gjithashtu ato mund të verifikojnë dhe bëjnë matjen e prodhimit të paraqitur në raportet të lëshuara nëpër ministritë përkatëse,sic janë:Ministria e Shëndetësisë ,Ministria e Bujqësisë dhe Agjencioni ibarnave dhe pajisjeve mjekësore.Nëqoftëse Komisioni has ndonjë parregullsi në vendndodhje menjëherë do të merren masat e parashikuara në pjesën e 12 të ligjit të përcaktuar në nenet 91,92,93,94¹⁵⁸.

Me të dhënat e mbledhura nga të gjitha ministritë krijohen statistika dhe raporte te ndryshme të cilat paraqiten para Organizatës Botërore të Shëndetësisë dhe Komisionit për Kontrollin e Drogave dhe Substancave Psikotrope.

2. *Ministria e Shëndetësisë*

Ministria e Shëndetësisë është institucioni më i rëndësishëm në procesin e Legalizimit të Marihuanës për qëllime mjekësore.Propozim Ligji për legalizimin e marihuanës për qëllime mjekësore bazohet në të dhënat e nevojave të pacientëve të cilat i evidenton Agjencioni ibarnave dhe pajisjeve mjekësore të cilat ia raporton nëpërmjet Ministrisë së Shëndetësisë.Nëpërmjet Ministrisë së Shëndetësisë caktohen rregullat e përdorimit,masën e lejuar,mënyrën,formën e barnave mjekësore me përmbajtje marihuana me përqëndrim të THC.Gjithashtu është Ministria e Shëndetësisë është organi kryesor që vendos mbi përqëndrimin e THC,e cila nuk për Maqedoninë e Veriut nuk mund të jetë më e lartë se 0,2%,gjithashtu Ministria e Shëndetësisë cakton nivelin e CBD,jep udhëzime të detajura,të plota

¹⁵⁸Ligji për Kontrollin e Barnave Narkotike dhe Substancave Psikotrope("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 103/2008, 124/10, 164/13 dhe 149/15)ndryshuar në Shkurt të vitit 2016 publikuar në Gazetën Zyrtare të RMV numër 37. www.slvesnik.com.mk , Neni 91,92,93,94

dhe të qarta për përdorimin e barnave¹⁵⁹.Ministria e Shëndetësisë është institucioni i cili ka barrën e raportimit mbi efektin e barnave me përmbajtje të marihuanës në Organizatën Botërore të Shëndetësisë,si dhe raportimin e Bordit Ndërkombëtar mbi Kontrollin e Narkotikëve (INCB).Ministria e Shëndetësisë përpilon ligj të veçantë mbi klasifikimin e barnave në pajtueshmëri me rregullat Konventave Ndërkombëtare.Ajo ngren një Komision të veçantë i cili do të mbikqyr punën në mënyrë të vazhdueshme nëpër Kompanit e Licencuara për mbjellje të marihuanës,do të ushtroj kontroll dhe raportoje për prodhimin,tregtimin dhe cilësinë e saj.Në shumë shtete në botë të cilat kanë legalizuar marihuanën për arsye shëndetësore, Ministria e Shëndetësisë ka një përgjegjësi shumë më të lartë edhe se vet organet e policisë.Megjithatë ligjet e shteteve ndryshojnë në varësi të Juridiksionit të tyre.Disa shtete praktikojnë formimin e bordeve ose agjencioneve të veçanta ,kështu është rasti I Holandës,e cila nën Ministrinë e Shëndetësisë ka krijuar një degë të veçantë që do të merret vetëm me procesin e prodhimit të kanabisit dhe shpërndarjes së tij në përputhje me rregullat e Konventës së Vetme të Narkotikëve të 1961 ,Zyrën e Kanabisit Medicinal(OMC)¹⁶⁰e cila paraqet një agjencion qeveritar të formuar nga qeveria holandeze, me qëllim për të patur një kontroll me të specifikuar të kontrollit mbi kompanitë prodhuese të kanabisit¹⁶¹.Të gjitha shtetet të cilat kanë legalizuar kanabisin për qëllime medicinale në botë,synim kryesor kanë mbajtjen në kontroll prodhuesit dhe prodhimin e marihuanës.Një ndër kushtet kryesore nga qeveria holandeze për subjektet juridike të licencuara si mbjellës dhe prodhues të marihuanës është që këto subjekte juridike janë të detyruara që prodhimin e tyre tia shesin Zyrës së Kanabisit Medicinal e cila me pas këtë prodhim e licencon në procedura të veçanta e klasifikon dhe e shpërndan nëpër farmaci¹⁶².Zyra e Kanabisit Mjekësor në Holandë¹⁶³ ka rolin sikurse Agjencioni I barnave dhe pajisjeve mjekësore në Maqedonin e Veriut,por kjo agjenci gjithashtu ngarkohet nga qeveria holandeze të grumbullojë prodhimin dhe të klasifikojë THC dhe CBD në nivele të ndryshme,duke kontrolluar gjithashtu edhe çmimin e cila përmban një kosto rreth 45euro për 5

¹⁵⁹<https://investnorthmacedonia.gov.mk/mk/%D0%B8%D0%BD%D0%B2%D0%B5%D1%81%D1%82-%D1%84%D0%B0%D1%80%D0%BC%D0%B0%D1%86%D0%B8%D1%98%D0%B0/>

¹⁶⁰ <https://english.cannabisbureau.nl/>

¹⁶¹<https://www.drugsandalcohol.ie/27071/1/TD0217210ENN.pdf>

¹⁶²https://publications.europa.eu/resource/cellar/c0703c01-0d38-11e7-8a35-01aa75ed71a1.0001.03/DOC_1

¹⁶³<https://english.cannabisbureau.nl/>

gram¹⁶⁴. Këto barna mund ti përshkruajnë vëtem mjekët specialistë për lehtësimin e simptomave që vijnë nga skleroza e shumëfishtë, HIV /SIDA, kanceri, dhimbja afatgjatë neurogjenerike dhe çiklistët shoqërohet me sindromen Tourette¹⁶⁵.Strategji të njëjtë ndjek edhe Republika Çeke e cila ka licencuar vetëm 26 farmaci të cilat kanë kompetenca për shitjen e produkteve të kanabisit për qëllime mjekësore, me një recetë të veçantë nga mjekët të autorizuar për të përshkruajtur këtë lloj recetë me një kufi prej 30 gram në muaj¹⁶⁶,licenca të cilat i jep Agjencioni Shtetëror për Kanabisin Medicinal,i cili vendos mbi rregullat e përshkrimi të recetës dhe regjistrimin e saj në formë elektronike duke i regjistruar edhe të gjithë personat të cilët përdorin këto produkte me qëllim që të kenë një qasje me të lehtë drejt personave të cilëve iu lejohet përdorimi dhe personave problematike ose grupeve kriminale.Ministria e Shëndetësisë në Itali është organi koordinues i cili ka të drejtën e dhënies së licencave për kultivimin, prodhimin, posedimin e kanabisit,gjithashtu përpilon ligje të veçantë të cilat kontrollojnë formën e recetës,sasinë,klasifikojnë mjekët të cilët janë të autorizuar për lëshimin e këtyre barnave,gjithashtu japin leje të përpunimit të marihuanës për farmacitë,me qëllim të prodhimin të barnave mjeksore duke bërë edhe klasifikim e përqëndrueshmërisë së THC dhe kontrollin e CBD.Italia ndjek të njëjtin model sikurse Holanda,fermerët janë të detyruar të dorëzojnë produktin në Ministrinë e Shëndetësisë, e cila pastaj bën shpërndarjen për prodhimin e saj nëpër kompanitë e licencuara për të përpunuar marihuanën në produkte mjeksore.Këto farmaci janë të detyruara të nxjerrin leje të veçantë në përputhje me kushtet të cilat janë vënë nga qeveria Italiane, nën kontroll nga Ministria e Shëndetësisë,prodhimi blehet si substancë aktive me anë të kuponave të cilat me pas I nënshtrohen përpunimit magjstral.Ministria e Shëndetësisë ka një kontroll të veçantë në sistemin elektronik mbi farmacitë të cilat regjistrojnë recetat e dhëna nga mjekët me emër,mbiemër dhe të dhëna personale të pacienteve dhe mjekut rekomandues të produktit mjekësor.Maqedonia e Veriut ka ndjekur një praktikë sikurse Italia,në të cilën Ministria e Shëndetësisë është organi koordinues.Duke qënë ende në një gjendje pak a shumë eksperimentale në këtë fushë, Maqedonia e Veriut ka marrë për bazë disa praktika juridike nga disa shtete.Ministria e Shëndetësisë është ministria me detyra më të

¹⁶⁴<https://www.drugsandalcohol.ie/27071/1/TD0217210ENN.pdf>

¹⁶⁵Po aty.

¹⁶⁶<https://www.emcdda.europa.eu/system/files/publications/4135/TD0217210ENN.pdf>

mëdha në legalizimin e marihuanës, sepse kjo ministri konsiderohet si pikë fillimi i marrjes së një vendimi të tillë. Me anë të raporteve të ndryshme rreth numrit të pacientëve të cilët kanë nevojë për trajtime të tilla mjekësore. Organizata Botërore e Shëndetësisë gjithashtu jep udhëzime për Ministrin e Shëndetësisë për të rregulluar dhe kontrolluar sa më mirë procesin e prodhimit dhe përpunimit të marihuanës për produkte mjekësore. Gjithashtu obligon qeverit nëpërmjet të përfaqësuesve të tyre nga Ministria e Shëndetësisë të raportojnë mbi numrin e pacientëve të cilët kanë nevojë për trajtime të tilla, numrin e personave me HIV, numrin e personave të cilët kanë nevojë për rehabilitim, raportim mbi gjendjen e Kompanive të licencuara, cilësinë e prodhimit, klasifikimin e barnave, përqëndrimin e THC dhe CBD të cilat duhet të jenë në përputhje të patjetërsueshme me Koneventën e Vetme të Narkotikëve 1961 dhe Konventën për Substanca Psikotrope dhe Protokollet e saj¹⁶⁷. Duke iu referuar Ligjit mbi kontrollin e lëndëve narkotike dhe substancave psikotrope, ngarkon Ministrinë e Shëndetësisë të kryej këto aktivitete të përshkruara në nenin 10 të këtij ligji¹⁶⁸:

- të ushtrojnë kontroll mbi prodhimin dhe tregtimin e barnave narkotike, substancat psikotrope dhe pararendësit,

- të bashkëpunoj me organet e tjera kompetente shtetërore për të siguruar përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga marrëveshjet e ratifikuara ndërkombëtare në fushën e kontrollit të barnave narkotike, substancave psikotrope dhe paraardhësit,

- obligon Ministrinë e Shëndetësisë të paraqet raporte pranë organeve të organizatave ndërkombëtare kompetente për importin dhe eksportin e barnave narkotike, substancave psikotrope dhe pararendësve në përputhje me detyrimet që rrjedhin nga konventat ndërkombëtare për kontrollin e drogave,

- të bashkëpunoj me institucionet e arsimit të lartë, institucionet që kryejnë punë kërkimore shkencore, me institucionet që kryejnë punë juridike, psikologjike, sociale, çështjet arsimore,

¹⁶⁷<https://apps.who.int/iris/bitstream/handle/10665/279948/9789241210225-eng.pdf>

¹⁶⁸Ligji për Kontrollin e Barnave Narkotike dhe Substancave Psikotrope ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 103/2008, 124/10, 164/13 dhe 149/15) ndryshuar në Shkurt të vitit 2016 publikuar në Gazetën Zyrtare të RMV numër 37. www.slvesnik.com.mk, Neni 10

informuese dhe mjekësore, si dhe me shoqatat joqeveritare, bashkësive fetare dhe grupeve fetare, dhe i referohet parandalimit, trajtimit, rehabilitimit dhe riintegrit social i personave të cilët abuzojnë me narkotikët, substancat psikotrope dhe pararendësit,

- të planifikoj veprimtari kërkimore në fushën e farmakologjisë, toksikologjisë, mjekësisë, psikologjisë, rehabilitim, socialelegjislacioni për mbrojtjen, edukimin dhe parandalimin, trajtimi, rehabilitimi dhe riintegritimi social i personave të cilët abuzojnë me narkotikët, substancat psikotrope dhe pararendësit,

- të autorizoj një institucion shëndetësor që do të udhëheqë në Republikën e Maqedonisë I cili do të bëj regjistrim qendror mbi personat që abuzojnë ose janë të varur nga narkotikëtdrogë, substancë psikotrope ose pararendësit e tjerë

- të autorizoj një institucion shëndetësor që do të performojë në Republikën e Maqedonisë duke diagnostifikuar trajtimine abuzuesve të drogës ose të varësisë nga një substancë psikotrope dhe të cilët janë HIV pozitivë ose kanë AIDS dhe për këto persona të mbahet shënim një regjistër të veçantë,

- të informoj publikun për rreziqet e përdorimit të barnave narkotike dhe substancat psikotrope dhe

- të bashkëpunoj me organizata dhe institucione ndërkombëtare për të promovuar aktiviteteteve parandaluese, terapeutike dhe rehabilituese në zonat e varësisë nga narkotikët, substancat psikotrope dhe pararendësit¹⁶⁹.

Në bazë të nenit 29-b të Ligjit për Kontrollin e Lëndëve Narkotike dhe Substancave Psikotrope subjekti juridik duhet patjetër të ketë të punësuar një farmacist i cili do të ketë një përvojë pune 3 vjeçare në fushën e farmacisë, që do të thotë se kontrolli i brendshëm i prodhimit I

¹⁶⁹Ligji për Kontrollin e Barnave Narkotike dhe Substancave Psikotrope ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 103/2008, 124/10, 164/13 dhe 149/15) ndryshuar në Shkurt të vitit 2016 publikuar në Gazetën Zyrtare të RMV numër 37. www.slvesnik.com.mk, Neni 10.

kalohet krejtësisht një farmacisti të licencuar nga Ministria e Shëndetësisë¹⁷⁰. Ministria e Shëndetësisë përpilon udhëzime të ndryshme dhe jep seanca edukative për subjektet juridike të licencuara, gjithashtu edhe për mjekët dhe farmacistët. Në bashkëpunim me Ministrin për Punën dhe Politikën Sociale jep udhëzime për trajtimin e personave të cilët janë të varur nga lëndët narkotike, të cilët mund të vuajnë dënime të ndryshme në institucionet penitensiare dhe korrektuese, gjithashtu në bashkëpunim me Ministrin e Arsimit organizon seminare dhe orë të ndryshme për dhënien e informacionit rreth pasojave të lëndëve narkotike dhe varësisë ndaj tyre me qëllim që informacioni të jetë sa më i gjerë sidomos tek fëmijët dhe të adoleshentët. Ministria e Shëndetësisë nëpërmjet programeve të saja përpilon statistika të ndryshme rreth narkomanëve të evidentuar sipas të dhënave të ndryshme, me qëllim reflektimin e përdoruesve, adoleshentëve të cilët janë lehtësisht të manipulueshëm nga dilerët e drogave të ndryshme, reflektimin e familjes dhe dhënien e informacionit të duhur se si duhet të veprohet në ndeshje me persona të tillë.

Ministria e Shëndetësisë, është gjithashtu kompetente për ngritjen e institucioneve rehabilituese për narkomanët, duke përpiluar programe të veçanta të cilat do tju vinin në ndihmë këtyre personave. Ministria e Shëndetësisë gjithashtu është kompetente të kërkoj ndihmë dhe të krijoj fonde të veçanta për krijimin e kuadrove profesionale mjeksore, për trajtimin e personave të mvarur nga lëndët narkotike. Duhet theksuar fakti se Maqedonia e Veriut nuk ka qendra të veçanta për rehabilitimin e narkomave, rehabilitimi ose shërimi i tyre në raste më të rënda bëhet në shtetet fqinje dhe në këtë rast është shtetit Serbisë i cili ka qendrën më të madhe të rehabilitimit të narkomanëve.

3. Ministria e Drejtësisë

Legalizimi i marihuanës për qëllime mjeksore kërkon një definim të qartë të ligjit mbi atë çfar paraqet si definicion kjo formë e legalizimit. Legalizimi i marihuanës për qëllime mjeksore nënkupton lejimin e prodhimit dhe përpunimin e saj nga subjekte të licencuara të cilat kontrollohen nga ministrinë përkatëse, njëra ndër to është Ministria e Drejtësisë, përdorimi i së

¹⁷⁰Ligji për Kontrollin e Barnave Narkotike dhe Substancave Psikotrope ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 103/2008, 124/10, 164/13 dhe 149/15) ndryshuar në Shkurt të vitit 2016 publikuar në Gazetën Zyrtare të RMV numër 37. www.slvesnik.com.mk, Neni 29-b

cilës është i lejuar vetëm për persona të cilat vuajnë nga sëmundje të cilat mund të trajtohen me produkte të tilla,të cilat përshkruhen nga mjekët specialist me receta të veçanta.Në fakt shpesh herë bëhet ngatërresa e termave legalizim i marihuanës për qëllime mjekësore dhe dekriminalizim i marihuanës.Me dekriminalizim i marihuanës nënkuptojmë lejimin e përdorimit të marihuanës duke e lejuar përdorimin e saj për arsye personale,e cila do të hiqet nga Kodi Penal si një vepër penale.Disa shtete Evropiane kanë hequr nga Kodi Penal përdorimin personal të marihuanës si një vepër penale dhe e kanë zëvendësuar atë me kundërvajtje me qëllim që të zvogëlojnë numrin e të burgosurve për këtë vepër, e cila vitet e fundit është kthyer në një trend për të rinjtë,dhe qëllimi dytësor i kësaj kthese të ligjit ka qenë mos infektimi i të miturve me kriminalitet¹⁷¹.Ndarja e një hapsire e një përdoruesi të marihuanës me persona që kanë kryer krime më të rënda do të ishte një infektim total ose një nxitje në krim të këtyre personave.Dënimet maksimale parashikohen nga 3 deri në 5 vjet për përdorim personal të marihuanës në shtetet që kanë si sanskion burgimin ndërsa për trafikim dhe shpërndarje të drogës dënimi penal arrin nga 10 deri në 15 vjet,mvarësisht nga Juridiksioni I shtetit dhe sasia narkotike¹⁷².Në vende të ndryshme Ministria e Drejtësisë në procesin e legalizimit të marihuanës ka funksione të ndryshme,psh në disa vende Ministria e Drejtësisë ka sektor të veçantë të cilët merren me kontrollin e ekzekutimit të aktgjyqimeve të cilët kanë lidhje me prodhimin e substancave narkotike,ndërsa në disa shtete Ministria e Drejtësisë merr kontrollin edhe të definimit të ligjit.Në Maqedonin e Veriut Ministria e Drejtësisë patjetër ka një rol kyç në procesin e legalizimit të marihuanës, e cila është e definuar në nenin 12 të Ligjit për Kontrollin e Lëndëve Narkotike dhe Substancave Psikotrope,i cili ligj obligon Ministrinë e Drejtësisë të kontrolloj ekzekutimin e aktgjyqimeve në lidhje me prodhimin e paligjshëm,tregtimin e barnave narkotike dhe substanva psikotrope¹⁷³.Gjithashtu Ministria e Drejtësisë në bazë të Ligjit të

¹⁷¹http://publications.europa.eu/resource/cellar/c0703c01-0d38-11e7-8a35-01aa75ed71a1.0001.02/DOC_1

¹⁷²<https://www.emcdda.europa.eu/system/files/publications/3573/Trafficking-penalties.pdf>

¹⁷³Ligji per Kontrollin e Barnave Narkotike dhe Substancave Psikotrope("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 103/2008, 124/10, 164/13 dhe 149/15) I ndryshuar ne Shkurt te vitit 2016 te publikuar ne Gazeten Zyrtare te RMV numer 37. www.slvesnik.com.mk , Neni 12

dhënë bashkëpunon me organizata dhe institucione ndërkombëtare në zbatimin e traktateve ndërkombëtare të ratifikuara të kontrollit të narkotikëve dhe substancave psikotrope¹⁷⁴.

Personat Juridik të licencuar për prodhimin e marihuanës janë të detyruar që të kenë të punësuar një Jurist në kompanin e tyre me qëllim të interpretimit të drejtë të ligjit nga kompania përkatëse, gjithashtu juristi duhet të përpilojë të gjitha raportet që përgatiten për ecurinë e prodhimit nga subjekti juridik drejtuar Komisionit Ndërsektorial dhe gjithashtu të vëndojë në dijeni personin juridik për çdo ndryshim të pësuar në ligj¹⁷⁵.

¹⁷⁴Ligji për Kontrollin e Barnave Narkotike dhe Substancave Psikotrope ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 103/2008, 124/10, 164/13 dhe 149/15) I ndryshuar në shkurt të vitit 2016 të publikuar në Gazetën Zyrtare të RMV numer 37. www.slvesnik.com.mk, Neni 13

¹⁷⁵Po aty.

4. Ministria e Punëve të Brendshme

Një ndër ministrit kryesore përgjegjëse për marrjen e masave në parandalimin e trafikimit të drogës, kontrollues të prodhuesve dhe shpërndarësve të lëndëve narkotike është Ministria e Punëve të Brendshme, e cila miraton programe të veçanta që synojnë të zvogëlojnë trafikimin, prodhimin, shpërndarjen e lëndëve narkotike në mënyrë të paligjshme, me standard të njëjtë evropiane me nivel të lartë të policisë, edukim dhe trajtim të specializuar të sektorit të administratës dhe të gjithë personave të tjerë të punësuar në Ministrinë e Punëve të Brendshme në pajtueshmëri me të gjitha standardet evropiane. Një ndër marrëveshjet më të arrira të Ministrisë së Punëve të Brendshme konsiderohet lidhja me Europolin me qëllim të shkëmbimit të informacioneve, si dhe partneriteti i saj me organizatën ndërkombëtare të policisë INTERPOLIN¹⁷⁶. Ministria e Punëve të Brendshme në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut kryen edhe një sërë aktivitete të tjera të cilat kanë të bëjnë me parandalimin dhe kontrollimin në pikat kufitare, si dhe bashkëpunimin ndërkombëtar për ndarje të informacioneve të cilat janë të rëndësishme në luftimin kundër kriminalitetit. Trafikimi i lëndëve narkotike paraqet një problem serioz në të gjithë rruzullin tokësor duke u konsiderohet si një ndër „bizneset“, më fitimprurëse në botë dhe arrin të kap shifrën e fitimit deri në 24 miliard euro në vit duke kaluar nëpër disa faza të cilat:

- mbulojnë kultivimin e substancave psikotrope (barnave),
- prodhimin e tyre,
- shpërndarjen ndërkufitare dhe
- në fund shitjen e substancave të caktuara që janë të ndaluara nga ligji¹⁷⁷.

Republika e Maqedonisë së Veriut trafikimin, prodhimin, shpërndarjen e drogave, ofrimin tek personat e tjerë, shitjen etj, I parashikon si vepra penale të rregulluara në nenet 215 dhe 216 në bazë të Kodit Penal¹⁷⁸, ndërsa përdorimi personal i marihuanës, nuk është I përcaktuar si vepër penale por si prishje e rendit public dhe kundërvajtje. Për narkomanet mund të shqiptohet

¹⁷⁶ Ministria e Puneve te Brendshme - Republika e Maqedonise se Veriut <https://mvr.gov.mk/default>

¹⁷⁷ O. Koshevalis, E. Maksimova KRIMI I ORGANIZUAR DHE KORRUPSIONI - Universiteti „ Goce Delchev „ - Shtip, Fakulteti i Drejtësisë, 2018, mënyra e qasjes (URL) <https://e-lib.ugd.edu.mk/777> - PDF.

¹⁷⁸ A. Osmani, Kodi Penal i Republikës së Maqedonisë së Veriut, viti 2015, SHB "FURKAN ISM" Shkup

mjekim I detyrueshëm kur vepra penale është kryer për shkak të varshmërisë, kurse gjykata konstaton se ekziston rrezik që kryerësi për shkak të varshmërisë së tillë edhe në të ardhmen të kryejë vepra të tilla¹⁷⁹. Me këtë vijnë në përfundim se përdoruesit të narkotikëve për qëllime personale nuk janë në ndjekje penale sipas Kodit Penal, por I kalojnë drejtpërdrejtë Ministrisë së Punëve të Brendshme në bashkëpunim me Prokurorinë dhe Gjykatën¹⁸⁰. Ministria e Punëve të Brendshme gjithashtu është organi I parë I cili bie në kontakt të parë dhe të drejtpërdrejtë me trafikantët, prodhuesit e paligjshëm, personat që bëjnë shitjen e lëndëve narkotike dhe kanë nën kontroll trafikimin dhe trafikantët, e cila mbanë edhe evidencën e këtyre veprave penale, të cilat evidenca I raporton në institucionet shtetërore të paktën një herë në vitë. Siguron statistika të cilat duhet ti raportojë në Zyrën Kombeve të Bashkuara për Drogat dhe Krimin (UNODC). Evidenton në një system të veçantë drogat e sekuestruara dhe mban raport për pasurit e fituara nga shitja e tyre e paligjshme gjithashtu sekuestron prona e pasuri të fituara në mënyrë të paligjshme me anë të trafikimit dhe prodhimit të paligjshëm të lëndëve narkotike. Kontribon në mënyrë të veçantë dhe është një nga ministritë më të rëndësishme në parandalimin e trafikimit dhe prodhimit të paligjshëm të lëndëve narkotike. Të dhënat e Ministrisë së Punëve të Brendshme janë të rëndësishme edhe për evidentimin e personave problematik, sepse në bazë të këtyre të dhënave mund të jetë më i lehtë kontrollimi i shpërndarjes së barnave narkotike për qëllime mjeksore. Duke iu referuar raportit për situatën në fushën e trafikimit të paligjshëm të drogës të publikuar nga Ministria e Punëve të Brendshme për vitet 2010-2019 ka një rritje në regjistrimin e veprave penale nga viti 2010 në të cilin janë regjistruar gjithsej 578 vepra penale duke kaluar në epërsi në vitin 2019 me 896 vepra penale të regjistruara nga Ministria e Punëve të Brendshme. Gjithashtu një rritje të numrit të regjistruar kemi edhe për kryerësit e veprave penale i cili në vitin 2010 janë regjistruar gjithsej 713 kryerës dhe në vitin 2019 janë regjistruar 1004 kryerës të veprave penale në territorin e RMV-së.

¹⁷⁹ I. Zejneli & V. Kambov, E Drejta Penale Pjesa e Përgjithshme, fq.318 Tetove 2018

¹⁸⁰ Manual për Ligjin për Procedurën Penale OSBE, Ministria e Brendshme e Republikës së Maqedonisë, 2012 Shkup.

Në vijim nëpërmjet tabelës të publikuar nga Ministria e Punëve të Brendshme do të paraqesim gjendjen e tregtisë së paligjshme të drogës për periudhën kohore ndërmjet viteve 2010-2019 për Republikën e Maqedonisë së Veriut. Veprat penale të regjistruara në trafikimin e drogës në mënyrë të paligjshme, kryerësit e përgjithshëm të regjistruar, të dënuar për vepra penale në bazë të neneve 215 dhe 2016. Krimet e regjistruara të veprave penale nën 215 dhe 2016 në bazë të Kodit të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Gjendja e tregtisë së paligjshme e drogës në Ministrinë e Punëve të Brendshme¹⁸¹

	Viti 2010	Viti 2011	Viti 2012	Viti 2013	Viti 2014	Viti 2015	Viti 2016	Viti 2017	Viti 2018	Viti 2019
<i>Vepra penale të regjistruara në trafikimin e drogës në mënyrë të paligjshme</i>	578	596	604	555	717	611	608	552	789	896
<i>Kryerësit e përgjithshëm të regjistruar të dënuar për vepra penale në bazë të nenin 215</i>	713	719	736	668	872	718	708	629	905	1004
<i>Krime të regjistruara-v.p. neni 215</i>	494	481	468	421	577	515	488	464	673	763
<i>Kryerësit e regjistruar të v.p neni 215</i>	616	588	586	514	714	615	572	532	782	863
<i>Krime të regjistruara nga përdorimi i lëndëve narkotike neni 216</i>	84	115	136	134	140	96	120	88	116	133
<i>Kryerës të v.p të regjistruar si përdorues së lëndëve narkotike</i>	97	131	150	154	158	103	136	97	123	141

¹⁸¹<https://mvr.gov.mk/analiza/soobrakjaj/61>

5. Ministria e Bujqësisë

Në fillimet e lejimit të mbjelljes së kanabisit në Shtetet e Bashkuara të Amerikës nuk u përfillën shumë mendimet e vlefshme të një agronomi ekspert të kësaj fushe, me kalimin e kohës subjektet e licencuar për kultivim të kanabisit e vërejtën që nuk mund të udhëhiqnin komplet zvillimin e bimës së kanabisit pa praninë e një agronomi profesional¹⁸². Më pas rëndësi e madhe iu dha fushës së bujqësisë në aspektin e kultivimit dhe implikuan Ministrinë e Bujqësisë në procesin e dhënies së licencave. Ndërsa vendet evropiane¹⁸³ patën një vlerësim më të madh të pjesës së bujqësisë, gati të gjitha legjislacionet në shtetet ku është legalizuar përdorimi i kanabisit për qëllime mjeksore, detyrojnë subjektet e licencuara të punësojnë agronomi profesional të kësaj fushe me njohuri të mirëfillta mirë procesin e rritjes, gjithashtu iu japin përparsi Ministrive të Bujqësisë të kenë kompetenca të ndryshme në procesin e licencimit. Kultivimi i kanabisit është patjetër pikë së pari një aktivitet bujqësor, i cilësuar si një nga bimët me delikate, rritja e së cilës mund të kryhet në mënyra dhe forma të ndryshme, ky proces kërkon një njohje të detajuar profesionale të bimës së kanabisit, llojet e saj, kushtet e rritjes, përmbajtjen e saj, gjininë, përdorimin, frymimin e saj. Ministria e Bujqësisë është e involvuar nga fillimi i procesit të kërkimit të licencës nga ana e subjektit juridik. Subjekti juridik është i detyruar të paraqes Ministrisë së Bujqësisë analiza të mirëfillta të tokës në të cilën do të bëhet mbjellja e bimës së kanabisit, e cila pastaj konstaton vlerat ushqyese të tokës, nëse ka nevojë për përforsime të vitaminave shtesë për dheun në të cilën do të vendoset sera, këto analiza bëhen në sektore të veçanta të caktuara nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujrave, gjithashtu subjekti juridik duhet të paraqes një analizë të ujit me të cilin do të ujitet bima e kanabisit po ashtu të vërtetuar nga laborator i veçantë i akredituar nga kjo ministri në bashkëpunim me Ministrinë tjetra përkatëse. Për një njohje kaq të mirë të tokës dhe patjetër procesit të mbjelljes dhe rritjes shtetet që kanë legalizuar marihuanën ia kanë besuar patjetër agronomeve specialistë. Prandaj Ligji për Kontrollin e Lëndëve Narkotike dhe Substancave Psikotorpe në nenin 29-b parashikon si kusht që një subjekt juridik të ketë të punësuar të

¹⁸²<https://www.ncbi.nlm.nih.gov/pmc/articles/PMC5312634/>

¹⁸³https://publications.europa.eu/resource/cellar/c0703c01-0d38-11e7-8a35-01aa75ed71a1.0001.03/DOC_1

paktën një agronom me përvojë pune së paku 3 vjeçare¹⁸⁴. Ministria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujrave në bazë të këtij ligji të rregulluar me nenin 14¹⁸⁵ është e obliguar të ketë kontroll absolut mbi origjinën e farës së kanabisit, që do të thotë të vërtetojë me anë të marrjes së mostrës nga farat e ardhura që bëhet fjalë për kanabisin e klasifikuar në listat e paraqitura nga Ministria e Shëndetësisë, të vërtetojë licencën e kompanisë e cila bën qarkullimin e farës, në të kundërtën do të ishte një vepër penale blerja e një farë tjetër ose nga një kompani e palicencuar, të kenë nën mbikqyrje të gjithë procesin e qarkullimit nga kompania lëshuese deri tek arritja në kompanin porositëse. Ministria e Bujqësisë detyrohet të ketë kontroll në deklaratat e mbjelljes së farës dhe mbirjes së tyre rrënjë për rrënjë, rritjen e tyre dhe procesin zhvillimor, si dhe vjeljen dhe kalbëzimin e kërcellit. Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujrave ka kompetenca të vendos për numrin e farave që do të kultivoj subjekti juridik i licencuar në bazë të sipërfaqes së tokës që posedon¹⁸⁶.

6. Doganat e RMV-së

Autoriteteve doganore u përkasin kompetencat e konstatimit, pra detyrë e organeve doganore është konstatimi i veprës penale në forma të ndryshme me anë të mbikqyrjes dhe kontrollin e personave dhe pjesëve që posedojnë gjatë kalimit kufitar, me qëllim parandalimin e trafikimit dhe prodhimit të paligjshmën të barnave narkotike, substancave psikotrope dhe pararendësve si dhe luftimin e krimit të organizuar dhe korrupsionit doganor, në përputhshmëri me të gjitha rregullat ndërkombëtare organet¹⁸⁷. Organet doganore përfaqësohen nga drejtoria doganore me selin qendrore në Shkup¹⁸⁸. Kompetencat e drejtorisë doganore shtrihen brenda territorit të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe si të tilla janë: mbikqyrja doganore, kontrolli doganor, masa hetuese dhe kundërzbuluese me qëllim ndalimin, zbulimin dhe hetimin e kundërvajtjeve doganore dhe veprave penale, ngritjen e procedurave kundërvajtëse doganore

¹⁸⁴Ligji për Kontrollin e Barnave Narkotike dhe Substancave Psikotrope ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 103/2008, 124/10, 164/13 dhe 149/15) I ndryshuar në shkurt të vitit 2016 të publikuar në Gazetën Zyrtare të RMV numer 37. www.slvesnik.com.mk, Neni 29-b

¹⁸⁵Po aty, neni 29-b

¹⁸⁶Po aty, neni 29-b

¹⁸⁷<https://customs.gov.mk/index.php/sq/za-nas-mk-2/koi-sme-nie>

¹⁸⁸ Po aty.

dhe veprave penale të përcaktuara me ligj¹⁸⁹ etj. Duke qenë anëtare e Organizatës Botërore Doganore ,drejtoria doganore bashkëpunon me vendet tjera anëtare të kësaj organizate me qëllim shkëmbimin e informacionit të shpejtë në zbulimin dhe ndalimin e veprave penale, dhe krimeve ndërkufitare të parashikuara sipas ligjeve të veçanta ndërkombetare dhe kundërvajtjeve doganore dhe kundërvajtjeve të tjera të përcaktuara me ligj. Edhe pse në mënyrë të vazhdueshme bën përpara zhvillimi i doganave me anë të pajisjeve teknologjike për kontrollin sa më efektiv të kalimit të mallrave të ndryshme, përsëri përpjekja për import-eksportin e mallrave të paligjshme, si lëndët të ndryshme narkotike, armë, para të falsifikuara, materiale helmuese etj, është një problem i madh në dëm të ekonomisë, sigurisë si dhe shëndetit public. Qasja e juridiksioneve penale ndërkombëtare mbetet një nga problemet thelbësore të bashkëpunimit ndërkombëtar, aplikimi i Kodit Penal kombëtar mbrenda territorit të çdo shteti dhe ligjeve të veçanta doganore janë shumë më të ndërlikuara për tu kontrolluar nga mbikqyrja e përgjithshme ndërkombëtare dhe për tu zbatuar në praktikë. Kontrollat doganore kryhen nëpërmjet nëpunësve doganor në bazë të ligjeve të veçanta. Duke iu referuar Ligji për Kontrollin e Barnave Narkotike dhe Substancave Psikotrope neni 18¹⁹⁰, Administrata doganore mban shënime të veprave penale të raportuara për tregtinë e barnave narkotike, substancave psikotrope për të cilat me anë të raportit të tyre informon institucionet shtetërore të paktën një herë në vitë. Në bazë të këtyre raporteve të përpiluara nga administrata doganore në formë të ndryshme, institucionet shtetërore krijojnë statistika, informacione të detajuara për fondet e konfiskuara, pajisjet, prodhimin, pasurinë e fituar si dhe trafikimin e paligjshëm të drogave narkotike, të cilat Republika e Maqedonisë është e detyruar ti dërgojë pranë Zyrës së Kombeve të Bashkuara për Drogat dhe Krimin (UNODC)¹⁹¹.

¹⁸⁹<http://oldweb.customs.gov.mk/sq/DesktopDefault.aspx?tabindex=0&tabid=14>

¹⁹⁰Ligji për Kontrollin e Barnave Narkotike dhe Substancave Psikotrope ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 103/2008, 124/10, 164/13 dhe 149/15) I ndryshuar në shkurt të vitit 2016 të publikuar në Gazetën Zyrtare të RMV numer 37. www.slvesnik.com.mk Neni 18

¹⁹¹<https://customs.gov.mk/index.php/sq/za-nas-mk-2/koi-sme-nie>

Përfundime

Nga të gjithë studimet e bëra, duke u bazuar në raporte dhe statistika të ndryshme botërore dhe evropiane, vijmë në përfundim se Legalizimi I marihuanës për Maqedoninë e Veriut është një nga sfidat më të veçanta dhe të panjohura për të. Duke analizuar vendet e rajonit Ballkanik, që kanë një stepje me implementimin e ligjit për legalizimin e marihuanës, Maqedonia e Veriut pas një debati të gjatë në vend, në vitin 2016 përmes miratimit të Ligjit për Kontrollin e Lëndëve Narkotike dhe Substancave Psikotrope, i dha një shancë shkencës dhe qytetarëve të saj për përballjen me të në mënyre legale, për prodhimin e kanabisit që do të përpunohet për qëllime mjeksore. Pavarësisht legalizimit të marihuanës Maqedonia e Veriut në aspektin penal nuk e heq dënimin e prodhimit, fitimit dhe shpërndarjen e marihuanës në mënyrë ilegale nga nenet 215 dhe 216 të Kodit Penal. Nga kjo konstatojmë se në bazë të Ligjit mbi Kontrollin e Lëndëve Narkotike dhe Substancave psikotrope, legalizmi i marihuanës për territorin e Maqedonisë së Veriut është i lejuar vetëm për kompanitë e licencuara nga Ministritë e parapara me ligj, por mbetet në fuqi dënimi i keqpërdorimit dhe prodhimit ilegal i marihuanës nga persona fizik ose grupe kriminale i përcaktuar në nenet 215 dhe 216 të Kodit Penal.

Lufta për parandalim e krimit me lëndët narkotike është një sfidë në vete për të gjitha institucionet shtetërore. Legalizimi i marihuanës kërkon një trajtim të veçantë dhe një grup të profesionalizuar në këtë fushë për të parandaluar keqpërdorimet e prodhimit të marihuanës, e njëkohësisht aktivizon sektor të veçantë për mbikqyrjen e narkotikëve dhe kontrollimin e tyre. Duke pasur parasysh mospasjen e eksperiencës nga ana profesionale, vijmë në përfundim se administrata e Maqedonisë së Veriut ende është në një fazë përgatitjeje e sipër profesionale për krijimin e ekspertëve në këtë lëmi.

Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Drejtësisë dhe ministritë e tjera, janë të obliguara që të mbikqyrin dhe kontrollojnë produktin, sasisin dhe efektin e barnave narkotike me anë të instrumenteve të ndryshme shtetërore, ndër to me kryesorët janë: detyrimi mbi raportimin e gjendjes së prodhimit dhe evidentimi në vendndodhje nga Komisioni Ndërsektorial. Në bazë të raporteve të përpiluara nga Komisioni Ndërsektorial i

përbërë nga përfaqësues të ministrive të ndryshme, krijohen statistika dhe raprote të veçanta mbi gjendjen e prodhimit të marihuanës dhe produkteve që nxirren nga ajo, të cilat me pas publikohen për të mbajtur të informuar opinionin publik dhe Organizatën Botërore të Shëndetësisë si dhe Komisionin për Kontrollimin e Drogave dhe Substancave Narkotike, nga kjo analizë vijnë në përfundim se nevojiten grupe të specializuara të cilat do të kenë qasje direkte në mbikqyrjen e narkotikëve dhe kontrollimin e shpërndarjes së tyre.

Shpërndarja e produktit final në treg është padyshim një hap delikat i cili kërkon një qasje serioze nga farmacistët dhe sidomos mjekët specialistë të cilët janë të autorizuar me ligj të shkruajnë recetat për pacientët të cilët kanë nevojë për këto barna. Mbetja në fuqi e neneve 215 dhe 216 në Kodin Penal të Maqedonisë së Veriut tregon se lufta për luftimin e prodhimit dhe shpërndarjen e marihuanës në mënyrë ilegale, vlen edhe për dënimin e secilit individ i cili do të keqpërdor shitjen ilegale të marihuanës.

Legalizimi i marihuanës i jep një qasje tjetër bashkëpunimit ndërmjet Maqedonisë së Veriut dhe vendet e rajonit e më gjerë sidomos në pikat kufitare duke detyruar për përf forcime të reja në teknologji dhe administratë.

Maqedonia e Veriut si shtet detyrohet të përmbahet rregullave të cilat dalin nga Konventa e vetme e narkotikëve e viti 1961, Konventa për substancat psikotrope 1971, dhe protokollet e saj si dhe të gjitha konventave tjera ndërkombëtare që kanë të bëjnë me prodhimin, tregtimin e produkteve të marihuanës si dhe ndalimin e keqpërdorimit të saj.

Duke pasur parasyh të gjithë ecurinë e zhvillimit të legalizimit të marihuanës, Maqedonia e Veriut ka një komunikim detyrues më të afërt me Organizatën e Botërore të Shëndetësisë, Qendrën Evropiane të monitorimit për drogën dhe varësinë nga droga, Komisionin për Kontrollin e Drogave, Zyrën e Kanabisit Medicinal, e të gjithë organet ndërkombëtare që mbajnë nën kontroll legalizimin e marihuanës vijnë në përfundim se Maqedonia e Veriut i rrit detyrimet e saj ligjore dhe ekonomike.

Konstatohet se legalizimi i marihuanës në Maqedoninë e Veriut, shtrihet në tri aspekte dhe atë: në aspektin ekonomik, aspektin shëndetësor dhe aspektin ligjor dhe penal.

Aspekti ekonomik-Maqedonia e Veriut ka parashikuar një fitim deri në 250 milion euro nga gjithsej 56 licenca të shpërndara për subjektet juridike për prodhimin e kanabisit brenda territorit të Maqedonisë së Veriut për prodhimin dhe përpunimin e produkteve narkotike për qëllime mjekësore. Ligji parasheh një tatim prej 10 % të fitimit për subjekte juridike, ky fitim do të shtohet thesarit shtetëror. Gjithashtu subjektet juridike janë të detyruara që fitimet të cilat do të dalin nga prodhimi i marihuanës të investohen brenda territorit të Maqedonisë së Veriut në sfera të ndryshme që presin zhvillim siç janë: infrastruktura , objektet turisitke, zhvillimi i zonave malore etj. Nga kjo përfundojmë se legalizimi i marihuanës do të jetë një rritje ekonomike për Maqedoninë e Veriut duke krijuar hapjen e vendeve të reja të punës, me paga më të larta e cila do të ndikonte në uljen e numrit të papunësisë, si dhe krijimi i një standardi të ri, duke u bazuar në të ardhurat vjetore të subjekteve juridike.

Aspekti shëndetësor-Në Maqedoninë e Veriut sipas statistikave të paraqitura nga Instituti i Shëndetit Publik për Republikën e Maqedonisë së Veriut, numri i pacientëve me sëmundje malinje po rritet çdo ditë e më shumë. Shkencërisht është vërtetuar se vaji i kanabisit ndihmon në shërimin e sëmundjeve malinje të kapura në fazën e parë dhe ndihmon në kontrollimin dhe zvogëlimin e dhimbjeve në sëmundjet malinje tek pacientët në fazat më të rënda. Përveç sëmundjeve malinje shkencë ka vërtetuar terapitë të ndryshme medicinale të fituara nga kanabisi, që ndihmojnë në shërimin e një numri të madh të sëmundjeve sidomos personave me sëmundjen e epilepsisë dhe personave me HIV. Organizatat kriminale kanë përfutur një kohe të gjatë nga gjendja e këtyre pacientëve duke shitur vajin e kanabisit të pakontrolluar dhe të pa licencuar nga institucionet shëndetësore me çmime nga 800 deri në 1000 euro për 30 deri në 70 ml vaj të kanabisit. Pacientët nevojtarë të këtyre produkteve detyrohen të lidhen me rrjete kriminale të tilla dhe të përdorin terapi të palicencuara duke marrë përsipër një rrezik të lartë për shëndetin e tyre. Duke e analizuar këtë aspekt vijmë në përfundim se legalizimi i marihuanës për qëllime mjekësore, do të jepte mundësi për kurimin dhe trajtimin e një numri të madh të pacientëve të cilët kanë nevojë për terapi të tilla. Për dhënien e këtyre terapiave janë të autorizuar vetëm mjekët specialistë me obligim që të mbajnë evidence mbi ecurinë e efekteve pozitive dhe negative tek pacientët. Kontrollimi dhe licencimi bëhet nga persona adekuat nga Ministria e Shëndetësisë, Agjencioni i barnave dhe Pajisjeve

mjekësore dhe Instituti i shëndetit publik në RMV. Gjithashtu kontrolli mbi çmimin e ilaçit është një lehtësim i madh për pacientët në nevoj të këtyre ilaçeve, të cilëve një pjesë do ta mbuloj sigurimi shëndetësor. Kështu do të minimizohen kontaktet dhe prodhimi i legal i vajit të marihuanës.

Aspekti ligjor dhe penal është një ndër aspektet më të rëndësishme për të ndërmarr hapa të tilla me legalizimin e marihuanës. Me legalizimin e marihuanës për qëllime mjekësore, tentohet që të ulet numri i prodhuesve ilegal të vajit të kanabisit, i cili përfundon tek pacientët me sëmundje malinje në mënyrë të pakontrolluar dhe të pa licencuar. Në vitet e fundit, praktika gjyqësore flet për zhvillimin e "farmacive ilegale" të kontrolluara nga grupe të mëdha kriminale, legalizimi i marihuanës për qëllime mjekësore do të shkrinte këto farmaci ilegale dhe grupe kriminale. Gjithashtu, dalim në përfundim se legalizimi i marihuanës në aspektin penal ka një rëndësi të veçantë për identifikimin e personave problematike, të cilët patjetër do të tentojnë të vijnë në kontakt me produktet e marihuanës nëpër rrugë ilegale duke përdorur falsifikime të ndryshme.

Në përmbledhje të gjithë kësaj që u tha me sipër dalim në përfundim se legalizimi i marihuanës për qëllime mjekësore, ka anët e veta pozitive dhe duhet të shihet si një perparsi ligjore dhe ekonomike.

Ndërsa sa i përket legalizimit të marihuanës për qëllime mjekësore nuk duhet të harrojmë të cekim faktin se personat që kapen si shitës ambulant me gramazh të vogël janë persona të varur nga bota e krimit dhe lëndët narkotike. Trajtimi i këtyre personave në institucione të specializuara do të ishte një lehtësim në numrin e çështjeve gjyqësore.

Rekomandime

Duke pasur një qasje më të afërt të studimit të legalizimit të marihuanës në Maqedonin e Veriut do të paraqesim disa rekomandime:

1.Rekomandimi I parë, ka të bëjë nenet e vendosura në Ligjin mbi Kontrollin e Barnave Narkotike dhe Substancave psikotrope rreth shpërndarjes së marihuanës si produkt i gatshëm për përpunim.Ky ligj parashikon që kompanitë e licencuara në mënyrë të pavarur të vendosin për shitjen e prodhimit tek farmacitë e licencuara,e nga kjo shit-blerje shteti do të përfitonte 10% nga shuma e përfituar nga subjekti juridik i licencuar.Rekomandojmë që të krijohet një degë e veçantë nën Ministrinë e Shëndetësisë dhe Agjencionin e barnave dhe Pajisjeve mjekësore, e cila do të bënte blerjen e marihuanës si bimë të papërpunuar nga subjektet juridike të licencuara,nën mbrojtje të institucioneve shtetërore e më pas do të rishitej nëpër farmacitë të veçanta të licencuara për përpunim të mëtutjeshëm,me qëllim që të zvogëlonte prishjen e prodhimit,do të mënjanonte komplikacionet e kontratave mes kompanive,do të ulte rrezikun e keqpërdorimit të prodhimit nga subjekti juridik, i cili në rast se nuk do të gjejë blerës adekuat për prodhimin, ekziston rreziku që të tentoj ta shes prodhimin në rrugë ilegale.Nëse blerja do të merrej përsipër nga organet shtetërore, prodhimi i marihuanës si bime do të ishte më i sigurtë.Këtë praktike përdorin disa shtete të cilët kanë legalizuar marihuanën, e një ndër to është Italia,duke u cilësuar si një nga praktikatat më të mira për kontrollimin e masës së prodhimit final dhe selektimin e cilësisë.

2.Rekomandimi I dytë, ka të bëjë me kontrollin e pastërtisë gjyqësore të investitorëve në subjektet juridike.Ligji parasheh për personat që aplikojnë për marrjen e licencës për të ngritur një subjekt juridik nevojitet edhe vërtetimi nga gjykata që do të vërtetojë që aplikanti nuk ka qënë I dënuar më parë ose nuk është I implikuar në ndonjë çështje penale.Nga studimet e bëra një numër I madh ineinvestitorëve në subjektet juridike për prodhimin e marihuanës janë ineinvestitorë të huaj,rekomandojmë të shtohet edhe vërtetimi se në çfarë mënyre janë fituar ato të holla nga vendi ku I kanë përfituar ato të holla që do të investohen në këtë biznes,në mënyrë që të vërtetohet se kemi të bëjmë me investitor serioz dhe jo persona që dëshirojnë të

bëjnë shpëlarjen e të hollave dhe ngritjen e bizneseve të tilla, me çrast do të vinte deri tek ikriminimi kriminal i vetë shtetit të Maqedonisë së Veriut. Pra kujdesi në selektimin e investitorëve të jashtëm, dhe bashkëpunimi i thellë ndërmjet vendeve të rajonit, duke përfshirë të dhënat të rëndësishme nga sistemi i EUROPOLIT DHE INTERPOLIT

3.Rekomandimi i tretë, ka të bëjë me një çështje delikate atë, të korrupsionit të personave zyrtare, sidomos përfaqësuesve të Komsioneve që bëjnë vëzhgimin dhe kontrollin nëpër subjektet juridike të licencuara. Rekomandojmë që të krijohet një organ i veçantë nën ministrinë e punëve të brendshme në lidhje të drejtpërdrejt me prokurorinë dhe gjykatën të cilët do të kishin nën kontroll punën e këtyre zyrtarëve të autorizuar për vëzhgimin e subjekteve juridike.

4. Redomandimi i katër, lidhet me aspektin ekonomik të përfitimit nga tatimi 10% i fitimit shtetëror nga personat juridik të licencuar në momentin e shitjes së prodhimit. Rekomandojmë që këto fitime të jenë transparente dhe të shkojnë në zhvillimin e vetëdijes të qytetarëve të Maqedonisë së Veriut për efektet negative që shkaktojnë marrja e lëndëve narkotike, një pjesë e fitimit nga ky buxhet të shkojë pikerisht për krijimin e profileve dhe projekteve të ndryshme në sferën e arsimit duke u dhënë një informacion më të gjerë të rinjve rreth përdorimit të drogave, një pjesë e të hyrave nga këto fitime të shkojnë për të investuar në infrastrukturë në vendet që kanë nevojë dhe në sferat që janë me zhvillim më të dobët.

5.Rekomandimi i pestë, ka të bëjë me aspektin shëndetësor, Maqedonia e Veriut me një numër të konsiderueshëm të personave të varur nga lëndet narkotike, është në mungesë të qendrave të rehabilitimit të këtyre personave. Duke qënë një sferë shumë e afërt nga fitimet e tatimeve të legalizimi i marihuanës, rekomandojmë që me një pjesë të këtyre të hollave të ndërtohet një qender rehabilitimi dhe strehimi e cila do tju vinte në ndihmë të gjithë personave të varur nga lëndët narkotike dhe personave të cilët kanë nevojë për shërim dhe rikuperim me qëllim inkandrimin e tyre të shëndoshë në shoqëri dhe dhënien e një shance të dytë për të krijuar një jetë të re. Pasi që edhe vete logjika e dënimeve penale, është përmisimi i sjelljeve devijante të personave të përfshirë në krim dhe riintergrimi i tyre në shoqëri.

6.Rekomandimi i gjashtë, dhe i fundit ka të bëjë me debatin e hapur kohëve të fundit mbi legalizimin e marihuanës për arsye personale me një sasi të limituar. Legalizimit të marihuanës për përdorim personal me një sasi të limituar do ti shërbente aspektit penal me një përfundim të tillë-Përdoruesit e marihuanës janë persona të cilësdo moshe por më së shumti janë të prekur moshat e reja sidomos 14-28 vjec. Shitesit ambulant të marihuanës përgjithësisht janë persona të rënë në kurth të grupeve kriminale, të cilëve u ofrohet një sasi e lëndës për konsumim personal. Numri i të burgosurve për kryerjen e veprës penale posedim të marihuanës me disa gram është shumë më i lartë në krahasim me të burgosurit për kryerjen e veprës penale për trafikim të lëndëve narkotike me kilogram dhe sasi më të mëdha. Siç e theksuam janë të miturit përdoruesit më të shpeshtë të marihuanës dhe janë po ashtu të miturit të burgosurit me numër më të madh për mbajtje të marihuanës. Në aspektin penal, legalizimi i marihuanës do ti hap një hapsirë më të madhe shqyrtimit të dosjeve penale me rëndësi më të madhe duke e reduktuar numrin e dosjeve për përdorim disa gramësh të marihuanës, duke reduktuar numrin e veprave penale për përdorim të kufizuar të marihuanës gjyqtarët do të kenë më tepër kohë për përkushtimin tek lëndët penale me barre më të rëndë.

Një qasje tjetër në aspektin penal është vendosja në të njëjtat burgje të personave të kapur me disa gram marihuane, me persona që kanë kryer vepra më të rënda penale. Këtu kemi një përballje dhe infektim kriminal, ose dërgimi i të miturve në qendrat për edukim ju jep atyre mundësinë për një qasje të re në botën e krimit.

Bibliografia

I- Libra

- V.Kambov & I.Zejneli, *E drejta Penale pjesa e përgjithshme, Tetovë,(2018).*
- I.Zejneli, *Delikuenca e të miturve, Tetovë, (2018)*
- E.Sahiti & I.Zejneli, *E drejta e procedurës Penale e Republikës së Maqedonisë, Shkup, (2007).*
- S.Kodra ,*Droga dhe efektet e saj,Rinis 2000.*
- L.Sokoli, *Droga,Tiranë, (1999).*
- V.Latifi, *Kriminalistika,Prishtinë, (2014).*
- R.Halili, *Kriminologjia, Prishtinë, (2008).*
- R.Halili, *Kriminologjia, Prishtinë, (2009).*
- N.Elezi,*Mjekësi sociale, Botimi II. Tetovë (2020).*
- O.Koshevaliska & E.Maksimova , *Krimi dhe Korrupsioni i Organizuar,Shtip,(2018)*
- Q. Avziu, A.Osmani, *Droga dhe llojet e drogave,Centrum 13,(2020)*
- G.Winger, J.H.Woods,F.G.Hoffman,*Manual i Abuzimit të Drogës dhe Alkoolit,Marijuana dhe Hashishi,Oxford Unniversity Press 2004,botuar në gjuhën maqedonase në vitin (2010).*
- A.Goldstein, *VARËSIA Nga Biologjia në Politikën e Drogës,Oxford University Press 2001,botuar në gjuhën maqedone (2010).*

- V.Dekov, Dekriminalizimi I drogave si bazë për politikë humane dhe të efektshme për drogat Analizë e modelit Portugez dhe Holandez të dekriminalizimit Dokumenti për Politika Publike ,Shkup ,(2020).
- Organizata Botërore e Shëndetësisë,Tregtia dhe Shëndeti: Drejt ndërtimit të një Strategjie Kombëtare,Editor:R.Smith, Ch.Blouin, Z.Mirza, P.Beyer, N.Drager(2015).
- A.Osmani, Kodi Penal I Republikës së Maqedonisë së Veriut,(Tekst intergral,i përpunuar në gjuhën shqipe me udhëzime dhe sqarime,treguesi alfabetik) Shkup,(2015)
- Ligji për Kontrollin e Barnave Narkotike dhe Substancave Psikotrope ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 103/2008, 124/10, 164/13 dhe 149/15) ndryshuar në Shkurt të vitit 2016 publikuar në Gazetën Zyrtare të RMV numër 37.
- Ligji për kundërvajtje kundër rendit dhe paqes publike, Gazeta Zyrtare numër 66/2007 Kuvendi I Rebulikës së Maqedonisë së Veriut, me ndryshime të botuar në Gazetën Zyrtare të vitit 2015,
- Konventa për substancat psikotrope 1961 dhe Protokolli I saj në 1971.
- https://www.researchgate.net/publication/282875531_Trade_and_Public_Health

II- Raporte dhe udhëzues

- Udhëzues i ECDC DHE EMCDDA Parandalimi dhe kontrolli i sëmundjeve infektive ndërmjet njerëzve të cilët injektojnë droga, Stokholm(2011)
- Manual për Ligjin për Procedurën Penale OSBE, Ministria e Brendshme e Republikës së Maqedonisë, Shkup(2012).
- Udhëzime për Kontrollin e Substancave Narkotike dhe Psikotrope Në kontekstin e traktateve ndërkombëtare, Bror Rexed Bordi Ndërkombëtar i Kontrollit të Narkotikëve Vjenë, Austri Dr K. Edmondson Departamenti i Shëndetit Canberra, Australi Dr Inayat Khan Divizioni i Shëndetit Mendor Organizata Botërore e Shëndetit Gjenevë, Zvicër Z. Robert J. Samsom Dega e Mbrojtjes së Shëndetit Ministria e Mirëqenies, Shëndetit dhe Çështjeve Kulturore Leidschendam, Holandë Organizata Botërore e Shëndetësisë, Gjenevë,(1984).

- Prohibition Partners, Raproti për Gjermanin mbi Kanabisin dhe konsumatorin e CBD, 2020
- Cannabis sativa and Hemp J.A. Hartsel, J.Eades, B.Hickory and A. Makriyannis,Chapter 53,(2016)
- Ministria e Shëndetësisë - Strategjia nacionale për droga në Republikën e Maqedonisë (2006-2012).
- Projekti Rajonal CARPO – Raporti mbi Gjendjen e Krimin të Organizuar dhe Krimin Ekonomik në Evropën Juglindore, Strasburg, Gusht (2006)
- E.Nweke (Nigeria) Addendum,Ndjekja e zbatimit në nivel kombëtar, rajonal dhe nivelet ndërkombëtare të të gjitha angazhimeve, siç pasqyrohet në Deklaratën Ministrore e vitit 2019, për të adresuar dhe kundërvepruar problemi botëror i drogës,Vien(2020)
- Udhëzues për Vlerësimin e Kërkesave për Substancat nën Kontrollin Ndërkombëtar të Zhvilluar nga Bordi Ndërkombëtar i Kontrollit të Narkotikëve dhe Organizata Botërore e Shëndetësisë për përdorim nga Autoritetet Kombëtare Kompetente ,Vien, (2020)
- Politika thelbësore për barnat dhe ilaçet,Grupi i Koordinimit Farmaceutik,Parimet operacionale për të mire farmaceutike prokurimi,OBSH,Gjenevë,(1995)

III- Burime të tjera

- <https://www.gov.uk/>
- <https://mvr.gov.mk/analiza/soobrakjaj/61>
- <https://www.ncbi.nlm.nih.gov/pmc/articles/PMC5312634/>
- https://publications.europa.eu/resource/cellar/c0703c01-0d38-11e7-8a35-01aa75ed71a1.0001.03/DOC_1
- <https://customs.gov.mk/index.php/sq/za-nas-mk-2/koi-sme-nie>
- <http://oldweb.customs.gov.mk/sq/DesktopDefault.aspx?tabindex=0&tabid=14>
- <https://top-channel.tv/2019/11/05/top-story-sa-kushton-1-liter-vaj-kanabisi-dhe-si-dallohet-cilesia-e-tij/>
- <https://drugsinc.eu/en/encyclopedia/cbd-cannabidiol/>

- <https://www.ncbi.nlm.nih.gov/pmc/articles/PMC3736954/>
- <https://fokus.mk/maslo-od-kanabis-kako-dejstvuva-i-shto-mozhe-da-izlechi/>
- <https://www.osce.org/files/f/documents/1/2/23807.pdf>
- <https://mvr.gov.mk/page/europol>
- <https://investnorthmacedonia.gov.mk/mk/%D0%B8%D0%BD%D0%B2%D0%B5%D1%81%D1%82-%D1%84%D0%B0%D1%80%D0%BC%D0%B0%D1%86%D0%B8%D1%98%D0%B0/>
- <https://www.drugsandalcohol.ie/27071/1/TD0217210ENN.pdf>
- https://publications.europa.eu/resource/cellar/c0703c01-0d38-11e7-8a35-01aa75ed71a1.0001.03/DOC_1
- <https://english.cannabisbureau.nl/>
- <https://www.emcdda.europa.eu/system/files/publications/4135/TD0217210ENN.pdf>
- <https://apps.who.int/iris/bitstream/handle/10665/279948/9789241210225-eng.pdf>
- <https://www.emcdda.europa.eu/system/files/publications/3573/Trafficking-penalties.pdf>
- https://assets.publishing.service.gov.uk/government/uploads/system/uploads/attachment_data/file/970326/Application_and_process_guide_-_Hemp_March_2021_v1.2.pdf
- <https://straininsider.com/cannabis-growing-licence-eu/>
- <https://laegemiddelstyrelsen.dk/en/special/medicinal-cannabis/companies/pilot-programme/authorisation-to-produce-cannabis-intermediate-products/~media/7B4786439F7549C5AA470B248D1F5818.ashx>
- https://www.emcdda.europa.eu/news/2019/italy-and-sweden-court-decisions-low-thc-cannabis-products_en
- <https://cannabossom.com/all-you-need-to-know-about-import-and-export-of-cannabis/>
- <https://bedrocan.com/>
- https://www.emcdda.europa.eu/system/files/publications/10171/20185584_TD0618186ENN_PDF.pdf

- <https://www.unodc.org/documents/drug-prevention-and-treatment/nonmedical-use-prescription-drugs.pdf> https://www.unodc.org/pdf/convention_1971_en.pdf
- <https://www.uab.cat/web/newsroom/news-detail-1345668003610.html?noticiaid=1345773927768>
- <https://p.dw.com/p/3n0oK>
- <https://www.galafarm.com.mk/sq/SH%C3%8BRBIM-CBD-PRODUKTI/>
- <https://www.bnnbloomberg.ca/cannabis-canada-pot-industry-adds-8-26b-to-canada-s-gdp-1.1324939>
- <https://www.nytimes.com/2020/12/02/world/europe/cannabis-united-nations-drug-policy.html>
- <https://theeconreview.com/2020/12/18/high-economy-impacts-of-marijuana-legalization-on-the-us-economy/#:~:text=According%20to%20a%20RCG%20Economics,total%20labor%20income%20of%20%24260%2C732%2C000>
- <https://www.mjeket.al/index.php?go=drogat&id=142>
- <https://www.hemp.com/sq/what-is-hemp/>
- <https://www.unodc.org/>
- https://malmed.gov.mk/wp-content/uploads/3.0-Listi-za-imenuvanje-i-dopolnuvanje-na-listi-za-klasifikacija-opojni-drogi_Sl_Vesnik-br.87-od-2016.pdf
- <https://www.statista.com/chart/20616/key-developments-since-portugal-decriminalized-drugs/>
- https://www.emcdda.europa.eu/news/2018/low-thc-cannabis-products-being-sold-in-the-EU%E2%80%93key-legal-issues_en
- <https://www.medcannworldforum.com/the-impact-of-medical-cannabis-in-europe/>
- <https://www.ncbi.nlm.nih.gov/pmc/articles/PMC4328738/pdf/embr0016-0130.pdf>
- https://www.unodc.org/unodc/en/commissions/CND/Mandate_Functions/current-scheduling-recommendations.html
- <https://www.who.int/>

- <https://zhurnal.mk/mbikqyrja-e-kanabisit-ne-bote-si-cili-shtet-deshiron-te-behet-kryeministri-zaev/>
- https://www.emcdda.europa.eu/publications/topic-overviews/cannabis-policy/html_en
- <https://www.ncbi.nlm.nih.gov/books/NBK232965/>
- https://www.emcdda.europa.eu/system/files/publications/4541/TI_PUBPDF_TDAT17001SQN_PDFWEB_20171128162141.pdf
- https://www.emcdda.europa.eu/publications/country-overview/2013/north-macedonia/html_en
- <https://drugpolicy.org/issues/brief-history-drug-war>
- https://www.who.int/substance_abuse/publications/msbcannabis.pdf
- https://dataunodc.un.org/drugs/heroin_and_cocaine_prices_in_eu_and_usa-2017
- <https://mvr.gov.mk/granichni-premini>
- <https://www.emcdda.europa.eu/system/files/publications/13238/TD0420439ENN.pdf>
- <http://www.healthrights.mk/index.php/arhiva-na-vesti/14-vesti/576-%D0%B4%D1%80%D0%BE%D0%B3%D0%B0%D1%82%D0%B0-%D0%B2%D0%BE-%D1%80%D0%B5%D0%BF%D1%83%D0%B1%D0%BB%D0%B8%D0%BA%D0%B0-%D0%BC%D0%B0%D0%BA%D0%B5%D0%B4%D0%BE%D0%BD%D0%B8%D1%98%D0%B0.html>
- https://www.emcdda.europa.eu/system/files/publications/968/Drug%20law%20offences%20in%20the%20Western%20Balkan%20region_meeting%20report.pdf
- <https://www.emcdda.europa.eu/system/files/attachments/11716/FYROM%20Strategy%202006-12.pdf>
- https://www.emcdda.europa.eu/system/files/publications/13236/TDAT20001ENN_web.pdf
- https://www.stat.gov.mk/PrikaziSoopstenie_al.aspx?rbtxt=98
- <https://rm.coe.int/16806ef3d4>
- <https://mvr.gov.mk/analiza/kriminal/55>
- <https://apps.who.int/iris/handle/10665/330074>

- <https://www.who.int/about/who-we-are/history>
- <https://www.who.int/teams/health-product-and-policy-standards/controlled-substances/who-review-of-cannabis-and-cannabis-related-substances>
- https://cdn.who.int/media/docs/default-source/controlled-substances/unsg-letter-ecdd41-recommendations-cannabis-24jan19.pdf?sfvrsn=6070292c_2&download=true
- https://www.unodc.org/unodc/en/commissions/CND/Mandate_Functions/current-scheduling-recommendations.html
- <https://www.drugsandalcohol.ie/27071/1/TD0217210ENN.pdf>
- <https://www.fda.gov/news-events/public-health-focus/fda-and-cannabis-research-and-drug-approval-process>
- <https://www.drugabuse.gov/research/research-data-measures-resources/nida-drug-supply-program>
- <https://www.dea.gov/what-we-do>
- https://ec.europa.eu/health/newsletter/108/focus_newsletter_en.htm
- <https://www.incb.org/incb/en/psychotropics/index.html>
- <https://www.ecdc.europa.eu/en>
- https://www.incb.org/documents/Publications/AnnualReports/AR2020/Annual_Report/E_INCB_2020_1_eng.pdf